

Altin Kita ju fton në një udhëtim për vetë-zbulim që shkon përtej kufijve të botës së prekshme. Në faqet në vijim, do të eksploroni temën e përjetshme dhe të thellë të njohjes së Perëndisë.

Altini nuk ju jep receta se çfarë të besoni, por përkundrazi, me përvojën e prindit dhe mikut të shumë të rinjve, synon t'ju ofrojë mjete dhe këndvështrime për t'ju ndihmuar në kërkimin tuaj personal. Ai ju inkurajon të mendoni për pyetjet e mëdha: “Çfarë do të thotë Zoti për ju? Si mund të krijoni një marrëdhënie të shëndetshme me të? Si mund të jetë besimi një burim force, udhëzimi dhe paqeje në jetën tuaj?” Përgjatë këtij libri, do të hasni histori të ndryshme, pyetje dhe këshilla për t'ju ndihmuar të eksploroni besimin dhe përvojën tuaj.

Pastor Altini ju fton të mos hezitoni të jini kuriozë, të kërkonit përgjigje për pyetjet që keni, dhe të njiheni më tej me Zotin, dhe veten tuaj përmes Tij...

Toni Gogu

Deputet në Kuvendin e Shqipërisë

Ky libër është si një udhëtim mes faqesh, i cili do t'i ndihmojë lexuesit e rinj të shohin sesi dashuria e Perëndisë është gjithnjë aty, pavarësisht nëse është një ditë e qetë apo sfiduese.

I mbushur me shembuj konkretë dhe anekdota me kuptim, "Ai të njeh" është fryt i përvojës dhe përjetimeve reale, ndaj si i tillë, një libër me vlerë për jetën e kujt do që ecën me Zotin, apo sapo e ka njohur Atë. Blendi Salaj
Gazetar

Nëse keni pritur një udhërrëfyes jo vetëm për GenZ, por edhe breza të tjerë, tashmë e keni në duar. Këtu gjenden përgjigje për disa pyetje të mëdha të jetës tënde, shoqëruar me hapa të rrëfyer thjesht dhe me vërtetësi, që do të të shoqërojnë në udhëtimin tënd, veçanërisht atë shpirtëror. Shijojeni dhe vëroni në veprim me zell këshillat e tij.

Eljona Boçe Elmazi

Drejtoreshë e World Vision Albania

Libër që duhet lexuar më shumë se një herë. Ky libër, duket sikur është shkruar për të na kujtuar gjëra që ndoshta i dimë po kemi nevojë herë pas here t'i kujtojmë.

Të gjithë biem dakord (nëse e kemi pranuar Jezusin) që Ai na njeh, që Ai na do. Po ne? A e njohim ne veten? E mbajmë mend kush ishim dhe çfarë aspironim kur me zemrën plot thamë: “Po, unë e pranoj Krishtin si Shpëtimtarin tim.” Më bëri të mendoj: Cilët jemi ne si komunitet? A jam unë e krishtera që kam dëshirë të jem? E duke hetuar veten, zbulova më shumë për Zotin... aty, në mua.

Në përjetimin tim, do e quaja “Libri i 4 lutjeve të fuqishme”. Nuk mbaj mend sa kohë kisha pa u lutur me zemrën e hapur dhe aq dorëzuar.

Françeska Hysi

Aktore

Shumë herë, kur lexon një libër, ti po dëgjon një person. "Ai të njeh" - Është një libër që të bën të eksplorosh më shumë në marrëdhënien e mrekullueshme që mund të përjetosh me

Perëndinë. Autori ka prekur disa tema shumë të veçanta, të cilat të ndihmojnë të përjetosh bukurinë e kësaj marrëdhënieje dhe të kërkosësh akoma më shumë të afroresh me Të. Është një libër që mëson se kur kuptojmë natyrën e vërtetë njerëzore, na bën të dashurohemi më shumë me Perëndinë për mënyrën që Ai na ka krijuar.

Ergest Biti

Kryetar i Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë

“Ai të njeh” është një libër fantastik për të drejtuar çdo njeri në gjenezën e gjithçkaje, që është vetë Perëndia. Pastor Altini i bën shumë të qartë çdo lexuesi që dashuria e Perëndisë është pa kushte, dhe jo vetëm kaq, por Perëndia kërkon të ketë një marrëdhënie personale me ty. Këtë gjë Perëndia e kërkon sepse Ai të njeh dhe Ai është i vetmi i cili mund të mbush çdo boshllëk të jetës tënde. Lexuesi nxitet të ketë një marrëdhënie personale me Perëndinë, gjë e cila është jetike për të gjithë ne.

Alesio Sema

Sekretar i Përgjithshëm, Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë

Libri “Ai Te Njeh” është një GPS shpirtëror i vyer për çdo person që dëshiron të mbërrijë në destinacionin për të cilën është krijuar. Zëri i Perëndisë, që të fton dhe të shoqëron në një udhëtim jetëndryshues, dëgjohet qartë përmes fjalëve të thjeshta, bindëse dhe inkurajuese që burojnë nga zemra e autorit Altin Kita. Ky libër duhet lexuar pavarësisht nëse ke qenë besimtar për shumë vite, apo je besimtar i ri, apo nuk

ke besuar ende. Mirënjohës Zotit për ngritjen e udhëheqësve shërbëtorë si Altin Kita në vendin tonë!

Zefjan Nikolla

Drejtor i Forumit Shqiptar të Udhëheqësisë

Në këtë libër miku im Altin Kita përpiqet të shpjegojë që kultura e qiellit është e rëndësishme në formimin e një grupi ose komuniteti njerëzish. Ne jemi ata që themi që jemi, vlerat, modelet, mesazhet dhe metodat që sjellim në kohët që po jetojmë. Jam kurioz të di se si secili prej nesh do e gjejë veten e tij në këtë libër.

Erjon Sylari

Pastor, Kisha Fjala e Jetës, Lushnje

E shijova duke lexuar dhe më dha një ndjesi freskie.
I lutem Zotit që të jetë i frytshëm për lavdinë e Tij.

Juljan Muhameti

Drejtues, Kisha Ungjillore Vlorë

Imagjino në një kohë sfide në jetë, të bie në dorë ky libër dhe të thotë: Ai të njeh ty! Dhe barra e rëndë sikur të largohet nga supet. Mua leximi i këtij libri më erdhi si bekim dhe kuptova që, edhe pse jam besimtarë prej vitesh, për Perëndinë kemi gjithmonë gjëra për të mësuar.

Teuta Dhimarko

Shkrimtare

*Ai të
vjel!*

UDHËTIM PËR TË GJETUR VERSIONIN ORIGINAL
QË PERËNDIA KA PËR TY.

ALTIN KITA



Ai të njeh

Copyright © 2023 Altin Kita

Autori: Altin Kita

Redaktorë: Albert Hysa, Anxhela Nikolli

Kopertina: Gleni Sina

Përgatiti për shtyp: Asim Hamza

Shtypur në shtypshkronjën “Vision Printing shpk”

Tirazhi: 1000 kopje

ISBN 978-9928-374-44-8

Të gjitha citimet biblike, nëse nuk thuhet ndryshe, janë marrë nga

Bibla ABS 2002, përdorur me leje nga Albanian Bible Society (A.B.S.)

Të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të vendoset në ndonjë sistem ose të transmetohet nëpërmjet çdo forme apo mënyre elektronike, mekanike, fotokopjimi, inçizimi apo në ndonjë mënyrë tjetër pa marrë më parë leje me shkrim nga botuesi.

FIKS PËR TY

Për çdo person që është GenZ: Ti je pjesë e një brezi shumë të veçantë. Ky brez është kaq ndryshe; jeni kaq të zotë, me kaq shumë aftësi lidershipi, me kaq shumë pasion për jetën. Jeni brezi që e do të bukurën. Jeni brezi më unik që ka patur ndonjëherë kjo botë.

Megjithatë, ti ende ndjen se ka diçka që të mungon. Ti ende po kërkon. Uroj që ky libër të jetë si një udhëtim për të gjetur versionin tënd origjinal, ashtu siç të kishte në mendje Perëndia kur të krijoi. A je gati për t'u nisur?

Mirënjohje

Kot nuk thotë populli: gur, gur bëhet mur. Një falenderim i veçantë për çdo mik të çmuar që ka vendosur një “gur” në këtë libër me nxitjet dhe ndihmën që më keni dhënë.

Ada, nxitjet, diskutimet tona të gjata dhe inkurajimet e tua të pakursyera kanë qenë motivim për ta çuar këtë libër deri në fund.

Marti, kur pashë si të shkëlqyen sytë kur lexove Ditën 1 të librit dhe idetë e reja që më dhe e dija që ky libër do prekte shumë jetë.

Rubi, kur ti më pyesje gjithë kohën “si po ecën me librin?” ishte si të mbushesha me energji nga dashuria jote për të lëvizur para.

Pa ju të tre ky libër do kishte mbetur një ëndërr në sirtar. Ju dua shumë!

Mirënjohës për ty Ueda, Ina, Teuta, Arbjona, Sose, Pavlo, Zefi, Nika, Rimi, Daniel, Beta, Vali, Endrit, Roni dhe shumë të tjerë që nuk jeni kursyer me kohën tuaj, idetë dhe ndihmën tuaj.

Faleminderit familja ICF Tirana, që më inkurajoni dhe më mbështesni gjithë kohës.

Dhe më i rëndësishmi, faleminderit Perëndi për privilegjin që më ke besuar, thirrjen dhe qëllimin Tënd për jetën time!

UNË TË NJOH!

Të njoh para se të kishe lindur.
Të enda në barkun e nënës.
Të krijova në mënyrë të mrekullueshme.
T'i kam numëruar të gjitha fijet e flokëve të kokës. I di
të gjitha ditët e jetës sate.

Të njoh personalisht.
E njoh natyrën tënde.
Ta njoh mendjen.
Ta shikoj dhe ta njoh zemrën.
Ta kuptoj nga larg mendimin.
Di çdo gjë të fshehtë.
E di çfarë nevojash ke.
E di çfarë do të thuash. I
shikoj gjërat që bën.

Të kam bir/bijë.
Nuk të rrëmben kush nga dora Ime.
Unë jam me ty.
Unë të njoh dhe të dua shumë!

-- *Perëndia*

AI TË NJEH

Udhëtim për të gjetur versionin origjinal që Perëndia ka për mua.

Pjesa 1: Kurioziteti; kush kërkon, gjen

1. E gjitha rreth teje

A rrotullohet bota rreth meje?

2. Dëshmitar i heshtur por që flet

Krijimi dëshmon se ka Perëndi.

3. Njeriu është kaq i veçantë

U krijua pak më i ulët se Perëndia.

4. Ai më njeh

Çfarë di një Perëndi i gjithëdijshëm për mua?

5. Katër të vërteta

Si ta bëj personale dashurinë pa kushte të Perëndisë?

6. Si fillon besimi

Katër hapa sesi dikush beson.

Pjesa 2: Gastronomia, ushqime të veçanta

7. Biblën: Duaje, mësoje, dëgjoje dhe jetoje

Çfarë kanë Shkrimet e Shenjta për ne sot?

8. Lutja; pse të lutem

Si të bisedoj me Perëndinë?

9. Koha personale me Perëndinë

Sikur pi kafe me Të çdo ditë.

10. Fryma e Shenjtë

Ai që rri me mua gjithë kohën.

11. Ku do të ulemi

Nevoja për komunitetin e duhur; kisha.

12. Dua je Perëndinë

*Me gjithë shpirt, me gjithë forcë, me gjithë mendje,
me gjithë zemër.*

Pjesa 3: Kultura, cilat vlera e formojnë atë

13. Të vërtetë

Jemi Siç Themë.

14. Relevantë

Ecim Me Hapin e Kohës.

15. Ekselentë

Japim Më Të Mirën Për Perëndinë.

16. Mikpritës

Krijojmë Atmosferë Të Dashur; Welcome Home!

17. Të kënaqur

Gëzimi Në Zotin Është Forca Ime.

18. Bujarë

Ai Na Bekon Që Të Jemi Bekim.

Pjesa 4: Një hap më tej

19. Ndaj Lajmin e Mirë me dikë

Këtë Mund Ta Praktikosh Vetëm Në Tokë.

20. E Gjeta

Dua të ta them edhe ty.

21. Puna është adhurim

A thua të jetë e vërtetë?

22. Mendja

Kjo arenë e madhe.

23. Shërbesa

Dua të bëj diçka.

24. Dyshimi dhe Besimi

Kam shumë dyshime, a është normale?

25. Bonus - Ti je i Jashtëzakonshëm

Kë përdor Perëndia për të ndikuar dhe ndryshuar botën?

Mbyllja

Indeksi i vargjeve biblike

Si fillim...

A ke dëshirë që të nisim një udhëtim? Por jo thjesht drejt jugut, në det apo në mal, por për të eksploruar diçka shumë të veçantë. Udhëtim jo për të vëzhguar bukuritë natyrore, por për të vëzhguar brenda teje dhe për të bërë lidhjen me Krijuesin tënd dhe veten tënde.

Mendohet të vijnë dhe ikin mbi tetë milionë turistë në Shqipëri këtë vit, pothuajse sa trefishi i popullsisë sonë. Turistët duan të përjetojnë të paktën tri gjëra në udhëtimin e tyre: *Attractions*, gjëra interesante që nuk i kishin dëgjuar ose nuk i kishin parë më parë, *Kultura* të reja, si jeton një komunitet i ri, dhe Gastronomi, gatimet tradicionale, dhe pastaj të kthehen në shtëpitë e tyre, në jetët e tyre normale; por nëse përjetimi ka qenë i bukur dhe i fortë, do të ngelet tek ata.

Ky libër do të jetë i ndarë në katër pjesë që ngjajnë me këto katër gjëra: Kurioziteti, Kultura, Gastronomia/Ushqimi dhe Një hap më tej.

Uroj që kështu të vijë ky libër tek ti. Si një *guidë*, por jo për të parë natyrën, lumenj, dete e male, por për të parë brenda teje dhe për të zbuluar një gjë: *A Më Njeh Perëndia?* Nëse PO, si e ndikon kjo gjë jetën time? A e përmirëson atë, a e fuqizon që të sjellë ndryshim, që të sjellë risi, gjëra që vetëm ti mund t'i bësh? Le të jetë ndihmë për të bërë diçka ndryshe me jetën tënde!

Po sikur të lexosh një kapitull në ditë? Duhet rreth tre deri në katër javë për të stabilizuar diçka të re në jetën tonë. Aq

është edhe ky libër, dhe kapitujt janë të shkurtër; mund t'i mbarosh për pesë deri dhjetë minuta dhe në fund ka diçka për të menduar. Kalo të njëjtën kohë, pesë deri dhjetë minuta, për të menduar në lidhje me pyetjet që janë në fund të çdo kapitulli. Dhe si zbatim personal, zgjidh njëren prej tyre për t'u thelluar pak më shumë. Në fund të çdo dite, do të gjesh idenë sesi do të jetë kapitulli i radhës, për të dhënë një shije si do të jetë dita tjetër.


Citimet, thëniet dhe vargjet që janë përdorur kanë një numër dhe në fund të librit, tek “Indeksi i vargjeve biblike”, janë referencat. Do të ketë vargje dhe histori nga Bibla, histori nga jeta ime personale, histori të miqve që kam takuar në jetë dhe citime nga njerëz të njohur.

Dua Të Të Paralajmëroj: Nëse e lexon këtë libër dhe e mendon për ta zbatuar përshtetësisht, kjo gjë mund ta ndryshojë totalisht jetën tënde. Një gjë e ngjashme më ndodhi mua para 30 vitesh. E kam fjalën për ndryshim për mirë. Jeta ime u mbush me shpresë atë verë të vitit 1993, me energji të re dhe me gëzim, sepse kuptova se Ai më njeh; Perëndia më njeh mua dhe dëshiron që jeta ime të jetë e plotë, Ai dëshiron që jeta ime ta ketë këtë update/përditësim të plotë.

Dhe për shkak se e kam përjetuar vetë, të sugjeroj ta çosh deri në fund librin, dhe kur të ndodhë edhe tek ti ky ndryshim, mos ndalo aty, por jepi një libër si ky diku që e do shumë.

Si thua, a e fillojmë udhëtimin?

Rrugë të mbarë dhe shijojë çdo pjesë të tij!



**“E ardhmja
u përket
kuriozëve.”**

- ANONIM

Pjesa I

Kurioziteti; kush kërkon, gjen

A je kurioz për ta njohur pak më shumë Perëndinë? A ke interes të dish më shumë për Të, ekzistencën e Tij dhe më shumë për kuptimin e jetës? Nëse po, kjo ndodh sepse Perëndia e ka vënë atë gjë brenda teje tashmë.

Ai do që ti ta zbulosh! Ai ka vënë përjetësinë në zemrën tënde, prandaj thellë-thellë ne duam, e dëshirojmë që ta njohim Atë.

Nga ana tjetër, shumë po mundohen ta zëvendësojnë Perëndinë me diçka tjetër ose ta mbushin boshllëkun me gjëra të tjera:

- Me ide të reja filozofike, ku qendra e botës është njeriu.
- Me gjëra; “sa më shumë të kem, nuk do të ndiej mungesa, boshllëqe.”
- Me dëfrime; “sa herë që ndiej ndonjë lloj boshllëku, shkoj në një party, shfrenohem pas diçkaje dhe harroj mendjen pas tyre.”
- Natyra dhe bukuritë e saj, udhëtime, përjetime nëpër botë.
- Duke bërë për një kauzë dhe duke i kujtuar vetes: *S’jam njeri i keq, i ndihmova dy familje në nevojë sot.*
- Duke u dhënë totalisht pas artit, studimit, muzikës, dhe këto, në fakt, të japin njëfarë plotësie dhe ngopjeje të përkohshme.
- Fokusin te vetja: “Do të bëhem dikush, do të arrij këtë apo atë”; te trupi fizik, tek gjërat negative që kanë thënë prindërit, shokët: “Do t’i bind që nuk jam ashtu, por jam shumë i zoti.”

- Pas një hobi, pasioni personal, dëshire, synimi të lënë pas dore që nga fëmijëria.
- Joga ose ushtrime të ndryshme medituese, për t'u lidhur ngushtë me veten e brendshme.
- Përfshirja nëpër organizata për të drejtat dhe përkrahjet e komuniteteve pa shumë zë dhe pa shume fuqi për t'ia dalë vetëm.
-

E sigurt që mund të ketë qindra e mijëra përpjekje të tilla për ta mbushur boshllëkun, me të cilin jemi krijuar. Dhe në fakt të japin njëfarë kënaqësie, konfidence, njëfarë ngopjeje.

Por atë boshllëk që kemi e mbush vetëm Perëndia; Ai e ka vënë përjetësinë brenda nesh. Sepse u krijuam nga Ai dhe na krijoi për vete; derisa të vijmë në këtë pikë, do të jemi duke u endur.

Eja t'ia fillojmë kërkimit sepse Ai vetë ka thënë:
Kush Më Kërkon, Më Gjen!



**“Gjithmonë
kam bërë atë
që kam dashur
dhe gjithmonë
kam qenë kjo
që jam sot.”**

– BILLIE EILISH

DITA 1
E GJITHA RRETH TEJE
A rrotullohet bota rreth meje?

A e ke lexuar diku këtë thënie? Është motoja e QTU-së, një qendre tregtare në Tiranë. Është një vend ku njerëzit shkojnë jo vetëm për të blerë, por edhe për t'u argëtuar, për t'u çlodhur, për t'u takuar me dikë, për të kaluar kohën e lirë. Dhe të mirëpret me këtë moto: E gjitha rreth teje! Dhe jo vetëm aty; edhe pse e pashkruar, duket sikur e gjithë bota, në forma të ndryshme, të fton për ta jetuar jetën sikur ajo sillet e gjitha rreth teje dhe se ashtu duhet të jetë.

Prandaj duam, që kudo ku jemi të mbarojmë punë ne për vete fillimisht. Mund t'i jap gaz makinës dhe t'ia pres rrugën dikujt sepse unë kam diçka të rëndësishme për të bërë. Mund të shtyj dikë te stacioni i autobusit, sepse unë jam vonë për në punë. Mund ta marr pjesën më të madhe dhe më të mirë të ushqimit në tavolinë, sepse unë po lodhem më shumë. Mund të harxhoj shumë për ditëlindjen time, sepse unë e meritoj. Kur shkoj në një party, dua që të gjithë t'i kenë sytë tek unë, prandaj do të sigurohem që të tërheq mjaftueshëm vëmendje për t'u thënë atyre: Të gjithë sytë tek unë!

Secili nga ne ka filtrat e vet sesi e shikon një gjë, një ngjarje, një situatë, të gjithë jetën. Janë filtra që i kemi fituar nga përvojat e kaluara, nga kushtet në të cilat jemi rritur, nga familja ku jemi rritur, shkollimi që kemi marrë, tipi i personit që jemi, rrethi shoqëror me të cilin rrimë, gjërat që besojmë se janë të vërteta, seti i vlerave që mendojmë si më të rëndësishme, gjërat që besojmë në lidhje me Perëndinë ose nuk besojmë fare. E vërteta është se asnjëri nga ne nuk e shikon botën me sytë e duhur, sepse

sytë e secilit kanë një palë syze me filtra, dhe shpesh jo një filtër, por një set filtrash. Por askush s’e pranon se mund të jetë kështu. Mund të mendojmë se jemi më mendje hapur, dhe mund të jesh më mendjehapur se një tjetër. Mund të jesh më bujar ose më i gjindshëm ndaj dikujt sesa disa të tjerë. Por, a mund të jesh totalisht i lirë nga gjërat që beson, mendimet që ke formuar tashmë ose botëkuptimet që ke? Kur dikush të thotë vendose veten në vendin tim, ti mund të përpiqesh, mund të tregohesh i ndjeshëm, por kurrë nuk mund ta vendosësh veten në vendin e tij/saj 100% sepse pikëpamjet e tij/saj janë ndryshe nga të tuat. Kjo nuk do të thotë se je person i keq; thjesht duhet të jesh i vetëdijshëm për ta kuptuar këtë gjë dhe të japësh maksimumin tënd. E gjitha rreth teje! Duket sikur kësaj motoje është e pamundur t’i shpëtosh. Por nëse arrij çdo gjë dhe çdo gjë është rreth meje, a do e gjej atë që po kërkoj, a do të jem plotësisht i kënaqur? Po nëse ka më shumë gëzim kur jep nga jeta jote për dikë, kur bën diçka për dikë? Dhe, a mund të ndryshojë kjo gjë? Nëse po, si? Ja disa hapa të thjeshtë:

1. Mendo. Kur je vetëm, medito herë pas here. Ndoshta nuk ke shumë kohë të lirë dhe nuk ke asnjë moment për të medituar, por ato pak momente kur je në kafene vetëm, kur je në autobus për të shkuar diku, në makinë apo rrugës për në punë, për në shtëpi. Mendo, “ndoshta nuk jam unë qendra e botës?” Nëse është kështu, atëherë çfarë është, cila është arsyeja pse jam këtu? A ka diçka më të madhe se kjo? 2. Pa filtra. Si në mediat sociale, filtrat mund ta zbukurojnë një foto, por edhe mund ta tjetërsojnë nga origjinali. Po nëse do e shikoja veten pa filtra fare, çfarë do të kishte aty? Çfarë do të zbuloja? A mund të jem këtu në tokë për një gjë më të madhe sesa vetëm vetja ime? A ka ndonjë arsye më të madhe jeta ime? Cili është modeli im fillestar, ai model që ka patur në mendje Krijuesi kur më solli në këtë tokë?

3. Përmirësohu. Nuk ka pse të jetë e gjitha rreth teje. Bota është më e madhe se ti. Përmirësoje këtë të menduar. Dhe hapi i parë i përmirësimit është kur e fillon nga fillimi. Pse jam këtu, a ka ndonjë arsye pse ekzistoj? Nëse ka Zot, Krijues, Hyjni, përse më krijoi, pse më bëri kështu siç jam? A më bëri vetëm për veten time apo kishte diçka më shumë në mendje? 4. Ji kurioz. Në fakt, ti je i tillë, përderisa po e lexon këtë libër, ti je kurioz dhe të nxis ta lexosh deri në fund dhe të zbulosh gjëra të bukura që ndoshta s'i kishe menduar kurrë më parë. Ji kurioz për Krijuesin. Nëse ka një të tillë, a më njeh Ai mua, a më shikon, a e di Ai ku jam tani, a e di sesi ndihem, çfarë sfidash kam, çfarë ëndrrash kam, çfarë dëshirash kam, çfarë frikërash kam? Sepse ka Krijues, është dikush që të njeh, të do, të ka krijuar Ai vetë dhe e di pse-në. Të nxis ta çosh deri në fund këtë libër dhe ta zbulojmë bashkë kush është Ai që të njeh dhe më e rëndësishmja, kush je ti për Të!

Për T'u Menduar

- A mund t'i dallosh, cilat filtra të ndikojnë më shumë?
- Cila nga këto të katërta ishte më e lehta për t'u bërë?
- Cila nga këto ishte më e vështira?
- A mendon se ka një Krijues, Modelues, Arkitet kjo botë?
A beson se Ai të njeh ty?

Vazhdon tek dita tjetër: Sepse në Të u krijuan të gjitha... të gjitha gjërat janë krijuar me anë të Tij dhe në lidhje me Të.¹

**“Para se të kishin
lindur malet dhe
para se Ti të kishe
formuar tokën dhe
botën, madje nga
mot dhe përjetë
Ti je Perëndia.”**

– PSALMET 90:2

DITA 2

DËSHMITAR I HESHTUR POR QË FLET!

Krijimi dëshmon se ka Perëndi.

Nëse ke bindje se nuk mund të ketë Zot, Krijues, Hyjni, do të doja të të ngacmoja vetëm me një mendim të vogël, diçka që e thotë një gjë e madhe, e flet krijimi pa thënë asnjë fjalë.

Ai nuk flet me gojë, por ama e shpall me të madhe që ka një Krijues, ka një Modelues. Imagjinoje kështu: nëse toka do t'i afrohej vetëm pak më shumë diellit, çdo gjë do të digjej nga temperaturat e larta dhe do të ishte si një nga planetet e tjera, pa jetë. Nëse do t'i largohej pak më tej diellit, çdo gjë do të kthehej në akull dhe toka do të ishte si një Antarktidë e madhe. Por jo, ajo është saktësisht aty ku duhet të jetë dhe ofron kushtet që njeriu të jetojë në të.

Nuk ka Zot dhe ta them me siguri se ashtu është. Kështu po përpiqesha të bindja gjyshen në fillim të Majit 1986. Isha 11 vjeç, në klasën e pestë, në vitet kur Shqipëria mburrej se ishte vendi i vetëm ateist në botë, siç është Koreja e Veriut sot. Dhe për detyrë shtëpie nga mësuesi kujdestar kishim për të bindur gjyshërit, për t'u shkullur bindjet prapanike që kishin rreth Zotit.

Ishte pasdite, e shtunë, nuk kishim detyra dhe të gjithë bashkë si familje po mbillnim patate te bahçja. E kam shumë të freskët atë mbrëmje, së pari sepse kënaqeshim shumë kur bënim diçka të gjithë bashkë si familje, dhe ja ku ishim: ne 6 kalamanjtë, mami dhe gjyshja. Dhe në mes gjithë kësaj gjëje të bukur, gjyshja thotë një urim, pasi i mbollëm patatet: I bëftë Zoti bruz! që kishte kuptimin, “Zoti i bëftë me shumë kokrra këto fara patateje që mbollëm sonte!” M’u ndez llampa mua, m’u kujtua detyra e

shtëpisë: Gjyshe, mësuesi më ka thënë se nuk ka Zot; te Zoti besojnë ata që nuk duan të punojnë, që përtojnë të punojnë. Ajo qetësia e gjyshes ma tronditi idenë e mësuesit. Sepse ajo e filloi me krijimin. Po mirë, ta zëmë se nuk ka Zot. Si do të mbijnë këto patatet që mbollëm, si do të rriten, si lind dielli, si zhvishen pemët dhe çdo gjë në vjeshtë dhe vishen përsëri tani në pranverë? Këto ishin vetëm disa nga pyetjet. E thënë shkurt, më bëri shumë të mendueshëm dhe atë natë u mbollën dy palë fara: farat e patates në bahçe dhe fara që mund të ketë një Krijues. Farat e para dhanë fryte pas 3 muajsh, kurse fara e dytë dha fryt pas 7 vitesh, në Qershor 1993, kur zgjodha të besoja se ka Perëndi.

Krijimi është fillimi, baza e jetës dhe e provave se Perëndia ekziston. Ai me të e filloi: Në fillim Perëndia krijoi qiejt dhe tokën.¹ Dhe pastaj, hap pas hapi gjen gjithë detajet e krijimit: toka, qielli, drita, yjësia, ujërat, bimësia, krijesat... dhe krijimi mbyllet në fund me njeriun.

Çfarë na flet krijimi për Krijuesin:

1. Ai është ndryshe nga ne. Ne dhe çdo gjë që shihet u krijua nga Ai dhe ne jemi krijesat e Tij. Ai vetë ishte aty që para krijimit, Ai nuk ka as fillim as fund. Dhe njëkohësisht,

Ai e di fundin e historisë. Ai që e krijoi çdo gjë dhe çdo sistem që ka kjo botë, që ky univers të funksionojë dhe të ekzistojë, është dikushi që i ka gjërat në kontroll.

2. Ai e do të bukurën. Ka vende në tokë ku duhet të udhëtosh me orë për të parë një mal, një lumë, një luginë, një ujëvarë, det ose liqen. Në Shqipëri është ndryshe, ose të paktën në Tiranë. Për 30-40 minuta je në det, për 30-40 minuta je në mal, afër një lumi, liqeni, ujëvare. Dhe kur shikon vetëm këtë copëz të

botës, Shqipërinë, dhe mahnitesh sesa bukuri natyrore ka, po e gjithë bota, sa ka?! Krijuesi e do të bukurën, rregullin, sistemet. Ai ka vendosur ditën, natën, stinët, vitet... Sa të sakta i ka bërë gjërat, sa të bukura dhe të qëndrueshme, me sisteme që mund të studiohen, të shikohen me detaje! Imagjino nëse vetëm graviteti do të ndryshonte herë pas here, çfarë kaosi do të ishte! Imagjino nëse çdo gjë do të ishte me një ngrirë ose me një shije ose me një lloj lartësie ose çdo gjë e sheshtë! Perëndia e do të bukurën, larminë, sistemet, ritmet.

3. Por, njeriun e krijoi me nge. Kurora e krijimit ishte njeriu.

Perëndia bëri gati të gjitha gjërat, pastaj vendosi njeriun, të cilin e formoi me duart e veta. Kur bëri pjesën tjetër të krijimit, Ai foli dhe gjërat erdhën në ekzistencë. Foli, U bëftë kjo... u bëftë ajo... le të mbijë gjelbërimi, bimët, pemët... le të ketë ndriçues në qiell... të mbushen ujërat me gjallesa, të fluturojnë zogjtë...² Por për njeriun tha: Le ta krijojmë njeriun sipas imazhit Tonë...³, e formoi nga pluhuri i tokës, i hukati në vrimat e hundës frymën e jetës.⁴ Dhe gruan e krijoi nga brinja e Adamit, pasi e kishte vënë në gjumë. Përsëri edhe gruan e krijoi me kujdes dhe me nge.⁵ 4. Krijimi thërret me të madhe: “Made by God!” Ashtu

si çdo pikturë, çdo prodhim ka shënimin specifik, bërë nga filan artist, bërë nga filan fabrikë, nga filan biznes ose Made in Albania, nëse krijimi do kishte një vulë prodhimi do të lexonte: “Prodhuar nga Perëndia, Made by God!” Kjo është thënia ime e preferuar për krijimin: Që nga krijimi i botës, cilësitë e padukshme të Perëndisë, fuqia e Tij e përjetshme dhe natyra e Tij hyjnore kuptohen dhe duken qartë prej gjërave që ka bërë.⁶ Krijimi shpall, flet, thërret, i bën të dukshme cilësitë, fuqinë dhe natyrën e Perëndisë. A e beson ti këtë gjë?

Për T'u Menduar

- Cilin vend preferon për t'u çlodhur: malin, detin, apo të dy?
- Cila nga këto katër pika është më e veçanta për ty?
- A beson se ka një Krijues, një Modelues, një Arkitekt kjo botë? ____ Po ____ Jo

Vazhdon tek dita tjetër: Megjithatë Ti e bërë (njeriun) pak më të ulët se Perëndia dhe e kurorëzove me lavdi dhe me nder. ⁷



**“Ti je
kryevepra
e Tij... ”**

– BIBLA

DITA 3

NJERIU ËSHTË KAQ I VEÇANTË

U krijua pak më i ulët se Perëndia.

Si shpjegohet që fëmijët kanë aftësinë për të mësuar gjuhën shqipe që kur janë të vegjël? Në moshën një vjeç e pak thonë fjalët e para, ma, ba, mami, babi. Kur janë dy vjeç thonë dy fjalë, mami hajde, babi ik, dua ujë... dhe kur janë tre vjeç thonë tre fjalë, e kështu me radhë derisa katër vjeç e lart mund të bisedosh me ta. Por nuk është vetëm gjuha shqipe; nëse prindërit do të shkonin në Gjermani apo diku tjetër ndërsa fëmijët janë në moshë të vogël, fëmijët do të shkonin në kopsht tek ai shtet i ri dhe shumë shpejt ata do ta mësonin edhe gjuhën e re.

Shiko, fëmija mëson një nga gjuhët më të vështira, siç është shqipja dhe e flet atë para se të ecë, para se të dijë si të ushqehet, para se të dijë të bëjë ndonjë gjë tjetër, para se të ketë filluar punë ose të dijë të fitojë para. Përderisa mësoi gjuhën nga hiçi, a mund të mësojë njeriu gjëra të tjera nga hiçi?

Kur Zoti krijoi njerëzit e parë, Ai i vendosi në kopshtin e Edenit, në kopshtin e përsosur dhe u tha atyre: “Kultivojeni kopshtin.” Ta kultivosh do të thotë ta përmirësosh, ta bësh më

të mirë. Si mund të kultivohet diçka që është e përsosur, si mund të përmirësohet kur është super çdo gjë? Sepse njeriu, ti, je krijuar nga Krijuesi dhe je bërë në imazhin e Tij dhe ke brenda teje ADN-në e Krijuesit.¹ Ai krijon; ti mund të krijosh dhe mund ta imagjinosh sesi mund të jetë gjëja e re.

Çfarë e bën njeriun kaq unik? Ka njerëz që janë të paparë që të vegjël. Janë shahistë, pianistë apo me aftësi të tjera, janë të zotë që në moshë të vogël. Ka disa që janë të paparë në matematikë dhe me shifra që kur janë në shkollën fillore. Ka disa që e dinë çfarë duan të arrijnë dhe të bëjnë në jetë që në vegjëlinë e tyre. Shumë nga ne nuk janë të tillë. Ti mund të jesh krahësuar me kushërinjtë, me shokët e klasës, me komshinjtë, me vëllain ose me motrën; ndoshta të kanë thënë: Po pse nuk je edhe ti si ata?

Për disa persona është sfidë e madhe ta dinë cili është roli i tyre në këtë tokë. Një gjë është e çuditshme: Pse asnjë nga shpendët, kafshët, ujqorët nuk e ka këtë problem? Ata e dinë cili është funksioni i tyre. Peshqit nuk çohen një ditë dhe thonë: do të dal një xhiro nga blloku sot, ose zogjtë të thonë: do të shikoj ndonjë tutorial në YouTube sot sesi bëhet foleja. Meqenëse atyre u mungon imagjinata dhe krijueshmëria, bëjnë të njëjtat gjëra gjithë kohën në bazë të instikteve specifike.

Ne si njerëz harxhojmë vite për të kuptuar veten, jetën dhe imagjinojmë: si mund të ishte jeta ndryshe, si mund të arrijmë këtë ose atë gjë.

Pse jemi kaq të veçantë ne? Sepse jemi krijesa më e lartë pas Perëndisë. Shkrimi e thotë kështu: Ti e bërë njeriun pak më të ulët se vetja.²

Para se Perëndia të krijonte gjërat që krijoi, Ai i imagjinoi dhe pastaj i vuri sipas radhës dhe akoma ekzistojnë dhe funksionojnë aty ku i ka vënë Ai. Ne kemi imagjinatë gjithashtu. Disa herë është gjë e mirë, disa herë imagjinata është e dëmshme. Disa herë imagjinata na bllokton dhe nuk na lë të ecim përpara sepse mbushemi me frikë dhe pasiguri dhe nuk na lejon të bëjmë diçka të re. Disa herë jemi të pangopur me atë që jemi ose kemi arritur

sepse imagjinata na thotë: Mund të ketë më shumë; po sikur të ketë më shumë se kaq? Gjallesat e tjera nuk mund të imagjinojnë një të ardhme më të mirë, por njeriu mundet. Ariu do të lindë arinj dhe do të bëjnë të njëjtat gjëra në të gjithë brezat e tyre. Pulat do të jenë pula, që ngrihen në mëngjes, hanë ushqim, pinë ujë, bëjnë vezë dhe një ditë përfundojnë në tepsinë me pilaf ose përsesh. Ne nuk jemi të destinuar për të jetuar jetë të vogla.

Në këto kohë jetojmë në një botë plot me ide, ëndrra, vizione, mendime të ndryshme dhe njerëzit flasin për gjëra që akoma nuk ekzistojnë. Ne krijojmë dhe imagjinojmë të ardhmen. Të ligjtë çohen dhe krijojnë, sajojnë plane si të abuzojnë me sistemin, si të abuzojnë ndaj njëri-tjetrit. Ne jemi përgjegjës për të imagjinuar dhe për të krijuar një të ardhme më të bukur, një të ardhme ndryshe, që e ndikon për mirë jetën e një tjetri.

Kur isha fëmijë, babi e kishte punën të atillë që më shumë ishte larg shtëpisë sesa në shtëpi. Mami ishte “ustai” i shtëpisë në fshat. Gjithmonë më mahniste mënyra se si i krijonte dhe bënte gjërat nga hiçi. Po si e bëri, si e lidhi, si e nxorri aq mirë? Bënte gardhe, porta, e dinte ku ishte toka e mirë dhe hapte tokë të re, bahçe të re. Kishte ide të reja gjithë kohën. Shprehja

e saj ishte: Nëse e ka bërë njeriu, edhe unë mund ta bëj. Ne ishim si dy shokë; ku shkonte ajo, më merrte mbrapa dhe më mësonte diçka të re. Kjo më bëri të guxoja edhe më vonë për ta parë veten me këto sy: mund të bëj gjëra të reja, projekte të reja, nisma të reja. Arrita të provoja dhe filloja gjëra të reja; edhe pse shumë prej tyre dështuan, përsëri nuk ndalova.

Një mik nga Zvicra, ndërsa po ecja me të nëpër rrugët e Tiranës para nëntë vitesh, më tha: Mësoji të rinjtë të mos ankohen, ‘s’kemi këtë, s’kemi atë.’ Nëse diçka mungon, mund të jetë

mundësia e tyre për ta krijuar. Nuk ka diskutim “a do të krijojmë diçka apo jo”, sepse njeriu gjithë kohën po krijon diçka; pyetja është çfarë do të krijojmë? Nëse do t’ia fillosh sefte, nga fillimi, sepse s’po di nga t’ia fillosh, po sikur ta fillosh së pari duke e pranuar se je krijuar në mënyrë të mrekullueshme nga një Arkitekt i paparë? Ai ka vënë tek ti ADN-në e Tij. Po sikur ta fillosh duke e falenderuar Atë së pari, që të ka bërë kaq unik dhe ta kërkosh arsyen, pse-në, tek Ai? Duke e pyetur: Çfarë kishe në mendje, o Perëndi, kur më krijove mua, cili është roli im në këtë tokë? Vetëm të shkoj në shkollë, të filloj një punë, të kem një familje, disa fëmijë, t’i rris, të dal në pension dhe pastaj të vdes? A ka më shumë se kaq?

Për T’u Menduar

- A të mahnitin fëmijët me pyetjet, kuriozitetin, aftësinë e tyre për t’i kapur shpejt gjërat?
- A e kishe dëgjuar më parë se në radhën e krijimit, ti je më lart se çdo gjë tjetër e krijuar, je vetëm një nivel poshtë Perëndisë? Si të bën të ndihesh kjo gjë?
- A e dije nga e kemi marrë ADN-në e krijimit, nga vjen aftësia jonë për të imagjinuar, ëndërruar, për të sjellë risi? Si të bën kjo gjë të ndihesh?
- A e di përse të ka vënë, sjellë, Perëndia në tokë, cila është arsyeja? Nëse nuk e di, mos e ndalo leximin e këtij libri, do e zbulojmë bashkë, hap pas hapi.

Vazhdon tek dita tjetër: Ai i ka numëruar të gjitha fjetet e flokëve...³

**“Unë do të
lavdëroj, sepse
jam krijuar në
mënyrë të mrekulluar;
veprat e Tua janë
të mrekullueshme,
dhe unë e di shumë
mirë këtë gjë.”**

– PSALMET 139:14

DITA 4

AI MË NJEH

Çfarë di një Perëndi i gjithëdijshëm për mua?

Janë disa fjalë latine që kam dëshirë t'i përdor herë pas here sepse kanë kuptim të bollshëm, fjalët si: Omnipotent, Omnishent, Omnipresent. Omni ka kuptimin të gjitha, kurse potent = i fuqishëm, present = i pranishëm, shent = i dijshtëm.

Ajo që ka lidhje me dijen e Perëndisë është fjala: Omnishent, i Gjithëdijshëm.

Perëndia është Omnishent, Ai di çdo gjë. Ai nuk zbulon gjëra të reja dhe habitet, ueee si nuk e dija këtë gjë? Njëri e tha bukur: A e ke vënë re, se Perëndia vëren çdo gjë?! Duket si lojë fjalësh, por e ka thelbin brenda. Dhe për shkak se është i gjithëdijshëm, Ai nuk harron asgjë dhe askënd, që nga fillimi e në vazhdim. Vetëm të shikosh disa nga vargjet e Biblës, do të mahnitesh sesa shumë di Ai për ne. Disa nga këto gjëra që do të radhis më poshtë, edhe të tjerët mund t'i dinë në lidhje me ty, por ka shumë gjëra që i di vetëm Ai.

Dua që të mendosh sesa shumë di Ai për ty, sesa siguri duhet

të të japë kjo gjë që të bëhesh me i vetëdijshëm se Ai di çdo gjë në lidhje me ty, Ai të njeh në detaje, Ai të do dhe kujdeset për ty. Le ta shohim bashkë. Sa më njeh Ai mua?

Së pari, Ai njeh ...

Fillimet. Në gjithëdijen e Tij, Ai e ka parë ngjizjen dhe lindjen e secilit prej nesh. Madje edhe para se të lindje ti, Ai të njihte. Davidi e thotë bukur te Psalmet: Ai të ka endur në barkun e nënës. Ai të ka krijuar në mënyrë të mrekullueshme. Ai i di ditët e jetës sate. ¹ Ai e dinte ditëlindjen time para se të lindja. Flokët. Ai i ka numëruar të gjitha fijet e flokëve. Nuk mendoj se mund të ketë ndonjë person tjetër që e di sesa fije floku ke ti. Nëse e kërkon në Google, do të të japë një numër të përafërt, por jo të saktë. Shkrimi thotë: Ai kujdeset për zogjtë, për harabelat, dhe asnjëri prej tyre nuk bie në tokë pa dashjen e Tij; pastaj vazhdon: madje të gjitha fijet e flokëve të kokës suaj janë të numëruara. ² Që i bie, Ai di gjërat më të vogla, detajet më të vogla të jetës sime. Disa ia kanë lehtësuar punën Perëndisë sepse nuk kanë shumë flokë, por Ai e di edhe numrin e fijeve të mbetura të flokëve tek ai person (shaka).

Ta di emrin. Perëndia i thotë Moisiut: Të njoh personalisht, të njoh me emër. ³ Kjo tregon sesi Perëndia nuk i shikon njerëzit si turma. Po ja, më duket se janë nja tre milionë shqiptarë në Shqipëri dhe ca milionë shqiptarë nëpër botë. Jo, jo, Ai e njeh me emër secilin.

Njeh thellësinë tënde. Kjo është e paparë, Ai njeh zemrën tonë, e njeh cep më cep atë dhe përsëri na do shumë. E sigurt që ka parë gjërat e mira dhe të këqija, të bukurat dhe të shëmtuarat dhe përsëri na do shumë. Perëndia e shikon

kur zemra jonë mbushet me mëkat dhe ligësi dhe sesi ato na mbajnë larg Tij, gjithashtu e shikon kur kemi dëshirë të sinqertë për ta kërkuar Atë. Ai na e njeh zemrën. ⁴

Njeh mendimet e tua. Nuk ka ide, mendim, koncept që mund të na ketë kaluar në mendje që Perëndia të mos e dijë ose të mos e ketë parë. Madje te Psalmet thuhet: Ai e kupton nga larg mendimin tim. Dhe jo vetëm që i njeh, por kupton edhe arsyen pse ajo gjë na kaloi në mendje ose përse ajo gjë po na rri akoma në mendje. Me shumë gjasa, ka disa mendime që ti uron të mos i dijë dhe të mos i marrë vesh asnjëri. Ose imagjino sikur të kishim një ekran në kokë si kapele dhe të dilnin të shkruara të gjitha mendimet që kemi në kokë. Është e sigurt se për disa mendime do të na vinte turp po t'i merrte vesh dikush tjetër. Por Perëndia i di tashmë të gjitha ato. Dhe e di që mendja jonë është si një fushëbetejë mendimesh. ⁵

Shqetësimet e mia. Përderisa Perëndia i njeh mendimet e mia, Ai e di se cilat nga ato janë kthyer në shqetësime. Dhe na nxit të mos shqetësohemi, por të rrimë të qetë duke e ditur se Ai është në dijeni të nevojave tona dhe se do të kujdeset për ne sepse Ai që kujdeset për lulet e fushës që sot janë, nesër s'janë, si nuk do të kujdeset për ne? Ai i njeh shqetësimet tona dhe do, dëshiron të kujdeset për ne. Pjetri, një nga apostujt e Jezusit, tha: Hidhi, lëri shqetësimet para Tij sepse Ai do të kujdeset për ty. ⁶

Ai e di çfarë them dhe çfarë bëj. Në gjithëdijen e Tij, Ai di çdo fjalë që them unë. Sepse kanë filluar të formulohen në mendje njëherë, pastaj janë shprehur me fjalë dhe pastaj disa kthehen në veprime. Ai e di çfarë do të bëj ose nuk do të bëj. Madje te libri i Predikuesit, mbreti Solomon tha: Perëndia do të gjykojë çdo vepër (çdo gjë që bëj). Po mirë, si do t'i gjykojë Ai nëse nuk i di, nëse nuk i ka parë? Por Ai shikon çdo gjë që bëjmë para të tjerëve, shikon edhe ato që

bëjmë kur jemi vetëm.⁷ Njeh rrugët e mia. Ai e di çfarë rruge do të marr dhe pret që ne të marrim rrugën që e nderon Atë. Madje te një psalm thuhet: Edhe kur të ecësh në luginat e errëta të jetës, Ai është aty me ty. Ne bëjmë plane dhe duket sikur vetëm ne i dimë, por është Ai që na drejton hapat. Dhe Ai e di para kohe se cila rrugë të çon në jetë dhe cila të çon në vdekje.⁸

Njeh dobësitë e mia. Perëndia e di si jemi krijuar, cilët prindër na sollën në jetë, cilat janë pikat tona të forta, cilat janë pikat e dobëta. Dhe Ai i thotë Palit njëherë: Hiri im të mjafton sepse do të të ndihmojë në dobësitë e tua. Kur e di cilat janë pikat e tua të dobëta për atë gjë, mbështetu te Perëndia, kërkoji ndihmë Atij.⁹

Ditët e mia. Është një psalm i Moisu që thotë: Na mëso të numërojmë ditët tona. Pse ia kërkoj Ai këtë gjë Perëndisë? Sepse asnjëri nuk e di sesa vite ka akoma për të jetuar, sesa ditë i kanë mbetur. Një krahasim për ditët tona thotë: janë si një avull, si diçka e përkohshme. Ne që jemi akoma gjallë na duket sikur do të jetojmë përjetë në këtë tokë. Por ama kur kujtojmë dikë të afërm që ka vdekur, na duket sikur nuk ka jetuar fare, sikur e kemi patur për shumë pak kohë. Dhe Perëndia e di ditën e largimit tonë nga kjo botë. Për ne është surprizë por jo për Të; në gjithëdijen e Tij, Ai e ka parë tashmë ditën kur do të ikim nga kjo tokë. Ditët tona janë në duart e Tij tashmë.¹⁰

Kur mbarova shkollën e mesme dhe nuk fitova shkollën

e lartë, u dëshpërova shumë. Sepse për mua shkolla e lartë ishte një mënyrë për të ikur nga fshati. Aty më dukej jeta pa perspektivë, pa të ardhme. Por në gjithëdijen e Perëndisë, unë ndenja në fshat fiks dhjetë vite pas shkollës së mesme. Ato dhjetë vite aty më përgatitën për gjërat që do të bëja në Tiranë, ishin përvoja që më duheshin për

të bërë atë që kishte në plan Perëndia për më vonë. Kjo më bëri që t'i shijoja vitet në fshat dhe çdo gjë që bëja duke e ditur se Perëndia, në gjithëdijen e Tij, e di, e di ku jam, e di ku do të jem, e di çfarë po bëj dhe do të bëj, e di çfarë është më e mira për mua.

Perëndia njeh këto edhe shumë e shumë detaje të tjera për ty dhe për mua. Uroj që duke e ditur këtë gjë do të nxitesh për t'iu afruar më shumë Perëndisë dhe do të mbështetesh më shumë tek Ai.

Ai të njeh, Ai njeh çdo gjë në lidhje me ty dhe ka në plan më të mirën për ty. Ai të njeh më mirë, më thellë, më në detaje se çdo njeri tjetër në këtë botë, më mirë se ç'njeh ti veten tënde. Prandaj lëshohu tek Ai, si fëmija në krahët e atit të tij, dhe mbështetu në ato krahë që janë plot dashuri dhe kujdes për ty.

Për T'u Menduar

- A i kishe dëgjuar më parë ato fjalët latine që përshkruajnë një cilësi të Perëndisë?
- Si ndihesh, cila është gjëja e parë që të vjen në mendje kur e kupton se Perëndia është Omnishent, i gjithëdijshëm?
- Nga ato më lart, cila të duket më e veçanta dhe cila më e vështira, prej faktit se Perëndia i di të gjitha, njeh çdo gjë që ke ti?
- A e ndjen nevojën për të qenë më i lidhur me Të? ____ Po ____ Akoma jo ____ Jo

Vazhdon tek dita tjetër: Perëndia e deshi aq shumë botën, sa dha Birin e Tij të vetëmlindur, që kushdo që beson në Të, të mos humbasë, por të ketë jetën e përjetshme.¹¹

**“Të gjithë ata
që e besuan
dhe e pranuan,
Ai i bëri bij
të Tij...”**

– BIBLA

DITA 5

KATËR TË VËRTETA

Si ta bëj personale dashurinë pa kushte të Perëndisë?

Uroj që kurioziteti yt po rritet ose është rritur tashmë në lidhje me Perëndinë. Në ditën pesë, dua të ndaj me ty Lajmin e Mirë. Lajmi i Mirë është shumë i thjeshtë dhe i fuqishëm. I thjeshtë – dua ta sjell me anë të katër të vërtetave; i fuqishëm, sepse kur bie dakord me këto të katërta, të ndryshohet jeta komplet. Kjo ndodh sepse vjen në pikën që kupton dashurinë pa kushte të Perëndisë dhe e fton Jezusin në jetën tënde, dhe në atë moment jeta jote rilindet, fillon një jetë komplet të re, fringo të re.

Një shprehje që e përmend shpesh është: Pranoje Jezusin në jetën tënde, lejoje Jezusin të vijë në jetën tënde, kërkoji Jezusit të vijë në jetën tënde. Por si e fton dikush Jezusin në jetën e tij/saj?

Çfarë do të thotë kjo? Do të thotë t'i besosh Atij në çdo gjë të jetës, të mirat e saj dhe të këqijat e saj. Të mos besosh tek vetja për të këqijat që ke bërë – do t'i rregulloj vetë, do të bëj ca të mira që të rregulloj të këqijat – jo, jo, t'ia lësh Atij t'i marrë dhe të të japë jetën e re. Ti beson se Ai do të të falë dhe Ai e bën, të jep një zemër të re, të pastër, jetë të re, fillim të ri.

Po cilat janë KATËR të vërtetat e para të besimit?

Të besosh se...

1. Perëndia të do pa kushte. Një nga vargjet e dashurisë së Perëndisë, i cili quhet ndryshe thelbi i Biblës, thotë kështu: Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e Tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në Të, të mos humbasë, por të ketë jetë të

përrjetshme. ¹ A e beson se Perëndia të do shumë ty? Dhe jo vetëm që të do, por ka një plan për jetën tënde: Jezusi tha: Unë kam ardhur që të kesh jetë e ta kesh me bollëk. ² Po mirë, pse shumica e njerëzve nuk po e përjetojnë këtë dashuri, nuk po e jetojnë këtë jetë me bollëk? Sepse...

2. Mëkati e ndau njeriun nga Perëndia. Çdo njeri është mëkatar: Sepse të gjithë mëkatuan dhe u privuan (u ndanë) nga lavdia e Perëndisë. ³ Njeriu u krijua që të kishte miqësi, marrëdhënie, të ishte i lidhur me Perëndinë, por për shkak të egoizmit të tij, ai zgjodhi të ndiqte rrugën e vet, i pavarur, dhe miqësia me Perëndinë u prish, u ndanë nga njëri-tjetri. Këtë mënyrë jete pa Perëndinë, që tregon indiferencë dhe rebelim ndaj Tij, Bibla e quan mëkat, i ndarë nga Perëndia: Sepse paga e mëkatit është vdekja (ndarje shpirtërore nga Perëndia). ⁴ Perëndia është i Shenjtë dhe njeriu për shkak të mëkatit u nda nga Ai dhe u krijua një hendek, një humnerë e madhe mes tyre. Por Perëndia, që është i dashur, nuk ndenji pa bërë diçka.

3. Perëndia solli Jezusin që të vdiste, të paguante për ne. Ai vdiq që të mos vdisnim ne: Por Perëndia e tregon dashurinë e Tij ndaj nesh në atë që, kur ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne.

⁵ Ai u ngjall nga të vdekurit: Krishti vdiq për mëkatet tona, sipas

Shkrimeve, se u varros dhe u ringjall të tretën ditë sipas Shkrimeve... dhe iu shfaq Pjetrit dhe pastaj të dymbëdhjetëve. Pastaj iu shfaq një herë të vetme më shumë se pesëqind vëllezërve...⁶

Ai është rruga e vetme për te Perëndia: Jezusi u tha: Unë jam rruga, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet Meje.⁷

Çfarë ndodhi? Perëndia e ribashkoi njeriun me Vetën me anë të kryqit, Jezusi vdiq dhe pagoi dënimin tonë që të bashkohemi me Perëndinë, që të kthehemi në shtëpi tek Ati ynë. E fundit është shumë e rëndësishme...

4. E pranoj Jezusin si Zot dhe Shpëtimtar. Çfarë ndodh kur e pranojmë Jezus Krishtin: por të gjithë atyre që e pranuan, Ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë, atyre që besojnë në emrin e Tij.⁸ Jezusin e pranojmë përmes besimit, besojmë atë që ka bërë për ne dhe e pranojmë këtë gjë me zgjedhje të lirë, me vullnet të lirë. Ju në fakt, jeni të shpëtuar me anë të hirit, nëpërmjet besimit, dhe kjo nuk vjen nga ju, po është dhurata e Perëndisë, jo nga veprat, që të mos mburret askush.⁹

Kur pranon Jezusin, ti fillon një jetë të re me Të dhe Ai vendos Frymën e Shenjtë në ty.

Si e pranojmë? Jezus Krishtin e pranojmë me një ftesë personale dhe me zgjedhjen tonë të lirë. Ai thotë: Unë qëndroj te dera dhe trokas; nëse dikush dëgjon zërin Tim dhe hap derën, do të hyj tek ai...¹⁰

Nëse mezi e ke pritur këtë rast, dua të të nxis që të lutesh tani dhe të vendosësh për t'i besuar Jezusit që sot. Si bëhet kjo?

Lutu, thuaje këtë lutje me zemër aty ku je, tani. Ai i lexon mendimet, Ai po të dëgjon, Ai e di ku je, Ai të njeh, Ai po të shikon tani. Lutja e shpëtimit:

O Perëndi, me aq sa di dhe kuptoj, unë zgjedh të besoj Ty sot. Besoj se Ti më ke krijuar dhe më do kështu siç jam. Unë zgjedh t'i besoj Jezusit si Shpëtimtari im, që do të më pastrojë nga çdo mëkat, dhe si Zoti im, për të më drejtuar jetën nga sot e tutje. E rrëfej se kam jetuar për veten time, një jetë egoiste dhe pa qëllim; merre zemrën time, pastroje, mbretëro në mua që sot. Më ndihmo të bëhem ashtu si Ti dëshiron që të jem. Në emrin Jezus lutem, Amen!

A e the këtë lutje me dëshirë dhe zgjedhjen tënde të lirë?

_____ PO _____ JO

Nëse e ke bërë këtë lutje, mirë se erdhe në familjen e Perëndisë; ti je bir, ti je bijë e Tij tashmë. Gjithë qielli feston për ty, sepse u shtove në familjen e Tij.

Unë, familja ime dhe gjithë familja e besimit ICF Tirana jemi gati të festojmë me ty për këtë vendim që more sot dhe duam shumë të të mbështesim ty në këtë udhëtim të ri.

Nëse ke dëshirë ta ndash me ne këtë super lajm, bëje duke skanuar këtë QR code:



Për T'u Menduar

- Nëse do të gjeje 2-3 fjalë të thjeshta, si do ta përshkruaje dashurinë e Perëndisë?
- Në një ditë të zakonshme, sa mëkate të vogla mund të bëjë një njeri? Një mendim jo të mirë, një fjalë jo të mirë, një veprim jo të mirë? Nëse bëjmë vetëm tre mëkate të vogla në ditë, hajde bëjmë pak matematikë, sa del shumëzimi: tre mëkate në ditë, herë 365 ditë të vitit, herë 70-80 vite jetë? Dalin shumë apo jo? Si mund të pastrohet njeriu nga kaq shumë mëkate?
- Jezusi e tha në vetën e parë, numri njëjës: Unë jam rruga, Unë jam jeta, Unë jam e vërteta? Çfarë mendon për këto deklarata që tha Ai?
- A e the lutjen e shpëtimit, a e pranove dashurinë e Perëndisë, faljen e Tij? A e ftove Jezusin në jetën tënde?

Vazhdon tek dita tjetër: ...i ra ndër këmbë dhe i tha: Zot, largohu prej meje, sepse jam njeri mëkatar. ¹¹



**“Gënjeshtat
më të mëdha
të kësaj bote janë
frikërat tona.”**

– RUDYARD KIPLING

DITA 6

SI FILLON BESIMI?

Katër hapa sesi dikush beson.

Nëse akoma nuk ke zgjedhur të besosh te dashuria e Perëndisë dhe ta zgjedhësh me dëshirë Jezusin si Zot dhe Shpëtimtar, dua të ndaj me ty si ndodh kjo gjë, si fillon besimi tek një person. Si model, dua të shikojmë sesi i ndodhi Simon Pjetrit, i cili ishte peshkatar dhe aty e takoi Jezusin, ndërsa po peshkonte. Nga jeta e tij do të mësojmë si fillon besimi dhe si mund ta ftosh Jezusin në varkën tënde, në jetën tënde, nëse akoma s'e ke bërë.

Ndodh me katër hapa. Për Simon Pjetrin, këto hapa ndodhën brenda një dite, në fakt. Ai ishte shumë impulsiv. Shumicës mund t'i duhet më shumë kohë sesa atij. Le t'i shikojmë katër hapat e besimit te Jezusi. Ndërkohë që i lexon, mendo se në cilin nga këto katër hapa je ti. Hapi i parë ose faza e parë: ti thjesht ke njëfarë interesi.

1. Interesohesh – Simon Pjetri e lejoi Jezusin që të shkonte me të për peshkim. Ja si thuhet: Atëherë hyri në një nga ato barka, në atë që ishte e Simonit (Pjetrit), dhe iu lut që të largohej pak nga bregu. U ul dhe mësonte turmat nga barka. Dhe kur mbaroi së foluri, i tha Simonit (Pjetrit): 'Shko në të thella, dhe hidhni rrjetat tuaja për të zënë peshk.'¹

Kur Jezusi erdhi te varka e tij, Ai po bënte atë që po bënte edhe Pjetri – ti zë peshq, po vij edhe unë për peshk me ty. Këtë bën Jezusi, Ai lidhet me ty, aty ku je ti, në nivelin ku je ti. Dikush të flet ty për Jezusin aty ku je. Dhe gjëja e parë është që ti ke interes, ke kureshtje për Biblën, për Jezusin, për Perëndinë. Në fillim

s'kishe as dëshirë, as mendime në lidhje me Perëndinë, por tani ke njëfarë interesi, dëshire. Duket si interes intelektual – vetëm dua të di disa detaje më shumë. Pastaj shkon pak më thellë sepse ke parë diçka ndryshe tek një shok/shoqe që të shtoi kureshtjen – Çfarë ka ai/ajo që nuk e kam unë; më duket beson te Jezusi, por çfarë do të thotë të besosh te Jezusi? Fillon të shtohet kureshtja.

Simon Pjetri në këtë pikë akoma nuk ka besuar, ai thjesht po tregon interes. Fakti që ti po e lexon këtë libër, tregon se ke interes. Njëri më tha: Unë nuk vij në kishë për të dëgjuar për Jezusin, vij sepse kam interes për një gocë. Po mirë, – i thashë, – nëse është kështu, pse të intereson ajo goca që të bën ty të vish në kishë për të; çfarë ka ajo ndryshe që s'e ka një gocë tjetër? Pra, hapi i parë për t'i besuar Jezusit është, ti ke interes. Cili është hapi tjetër? Bibla e quan zbulesë; Perëndia të zbulohet. Ndodhi me Simon Pjetrin kur ai kapi shumë peshq.

1. Ke zbulesa – Pjetri kapi shumë peshq. Dhe tani ndodh diçka e veçantë: në fillim kishte interes, tani Jezusi po i tërheq vëmendjen. Simoni (Pjetri), duke u përgjigjur, i tha: 'Mësues, u munduam gjithë natën dhe nuk zumë asgjë; por, për fjalën Tënde, do ta hedh rrjetën.' Dhe, si bënë kështu, zunë një sasi aq të madhe peshku, sa po shqyhej rrjeta. Atëherë u bënë shenjë shokëve të tyre që ishin në barkën tjetër, që të vinin e t'i ndihmonin. Dhe ata erdhën dhe i mbushën të dy barkat aq sa gati po fundoseshin.²

Ishte momenti kur Pjetri u habit, zbuloi diçka të re, “si e bëri Jezusi këtë?” Kjo ndodh në forma të ndryshme. Perëndia bën diçka të veçantë për ty, diçka të mirë, diçka e re ndodh në jetën

tënde. Ose po kalon një sfidë të madhe dhe kur gjërat rregullohen, duket qartë se duhet të jetë diçka, duhet të ketë diçka këtu, duhet të ketë qenë dora e Perëndisë që kjo gjë ndodhi. Disa herë zbulesa është dramatike, si në rastin e Saulit. Ai po ecte rrugës për Damask, duke përndjekur të krishterët e parë dhe Jezusi iu shfaq në formën e një drite të fortë. Ai ra nga kali dhe Jezusi i foli: Saul, Saul pse po më përndjek? Nga ajo ditë ai u bë ndjekës i Jezusit, nga terrorist u bë një nga ndjekësit më të fortë të Tij. Ose kur shikon ndryshim të madh te dikush, një person që ndryshoi 100%. Si u bë kaq i mirë ai, pse e fali atë tjetrin dhe nuk mori hak, nuk i mbajti inat. Si vendosi ai/ajo ta bënte një gjë të tillë, si arriti të hidhte një hap aq të madh besimi? Perëndia përdor momente të ndryshme për persona të ndryshëm dhe krijon zbulesa. Si fillim, të tërheq vëmendjen dhe kur krijohet zbulesa, ti thua: Ueee duhet të ketë diçka këtu, ngjan si dora e Perëndisë në këtë gjë, se nuk e shpjegoj dot ndryshe!

Pastaj vijmë në hapin e tretë, që është hapi më i keqkuptuar sepse disa kur arrijnë në këtë hap mendojnë: “Unë nuk jam njeri që beson në Zot, nuk është për mua kjo gjë; unë nuk jam i mirë, ta dish ti çfarë kam bërë unë!”

2. Je i frikësuar – Simon Pjetri i kërkoi Jezusit që të largohej prej tij. Kam frikë, ndiej frikë, dua t’i shmangem kësaj gjëje, se ç’kam një parandjenjë, një paretat, një si merak, një si frikë. Ja si tha ai: Simon Pjetri, kur pa këtë, i ra ndër këmbë Jezusit dhe i tha: ‘Zot, largohu prej meje, sepse jam njeri mëkatar.’ Në të vërtetë Pjetri dhe të gjithë ata që ishin me të, habiteshin për shkak të sasisë së peshkut që kishin zënë.³

Pjetri e kuptoi kështu: Ky është Biri i Perëndisë, ky është i Shenjtë, kurse unë... Por jeta ime është copë-copë mor' v'lla, kështu që ik, largohu nga unë, ne s'kemi lidhje bashkë, Ti je shumë lart për mua, unë jam këtu në fund.

Nëse edhe ti ke patur të njëjtën ndjesi, nuk je vetëm, madje është ndjesi normale njerëzore sepse Ai është Perëndia dhe ne jemi njerëz. Frika ishte ndjesia e parë që kishin njerëzit kur takonin, përjetonin praninë e Perëndisë. Moisiu fshehu fytyrën e tij sepse kishte frikë të shikonte Perëndinë.⁴

Reagimi i parë ishte frika kur ai ishte te shkurrja që po digjej. Nëse ti ndjen frikë ose merak kur vjen muhabeti te Perëndia, është normale; ti e kupton se Ai është i madh dhe është i Shenjtë, kurse ti vetë je njeri me 100 të meta dhe dobësi. Të vetmit që vijnë te Perëndia dhe s'kanë frikë janë fëmijët; ata vijnë me çiltërsi te Perëndia. Por, sa më shumë rritesh, fillon adoleshenca, fillojnë prapësitë, etj etj. Dhe e kupton se çiltërsia ia ka mbath' vrapit, egoizimi është bërë me 'E' të madhe dhe kur bie muhabeti dhe ballafaqohesh me gjëra që kanë lidhje me Perëndinë, të zë frika, ke parehati dhe do t'i shmangesh, madje dyshon: Si ka mundësi, ore, a ka mundësi që të më dojë Perëndia mua?

E di si i tha Jezusi Pjetrit kur ai pati frikë? Atëherë Jezusi i tha Simonit: 'Mos ki frikë; tani e tutje ti do të jesh peshkatar njerëzish të gjallë.'⁵ Sepse nuk ka rëndësi kush je ti, por kush është Perëndia. Perëndia dëshiron që të vijë sa më afër teje. Ai të thotë: "Unë e di kush je, e di çfarë ke bërë; dua të vij në varkën tënde." Ashtu siç i tha Pjetrit, "ti do të bëhesh peshkatar njerëzish". Jezusi po i thoshte: Unë kam një qëllim të ri për ty. Perëndia ka një qëllim të ri për ty gjithashtu. Perëndia të thotë: Unë do të bëj diçka të re me jetën tënde, diçka që ty nuk ta merr

mendja fare. Nuk thotë: Tani u njohe me Mua, rri aty tashti. Jo, thotë: Mirë se erdhe në fazën e re të jetës. Kjo mendësi të ndihmon ta kalosh momentin e frikës – Mos ki frikë, Unë kam një qëllim për ty dhe për jetën tënde; të dua siç je dhe bashkë do të lëvizim përpara. Tani vijmë tek hapi personal, ti vetë zgjedh të besosh.


3. Ti beson – Për Simon Pjetrin ky ishte momenti kur vendosi të ndiqte Jezusin. Pastaj ata, si i nxorrën në breg barkat, lanë çdo gjë dhe e ndiqnin.⁶ Ky është ai momenti që ndryshon çdo gjë; është sikur të jesh në udhëkryq, është si propozimi për martesë. Kur një djalë propozon për martesë, vajza është në udhëkryq. Nëse thotë ‘Po’, jeta e saj hyn në një fazë të re. Nëse thotë ‘Jo’, jeta vazhdon aty ku ishte, por mund të humbë një person të çmuar. Kur i thua ‘Po’ atij djalit, ti hyn në një fazë të re jete, njihesh me familjen e tij, pastaj fejesa, martesë, familja e re, fëmijët... . E njëjta gjë është me Jezusin. Ai të thotë: “Më Ndiq Mua!” Dhe je në udhëkryq: çfarë do të bësh, do të thuash ‘Po’ apo do të thuash ‘Jo’. Zgjedhja është për të hyrë në një udhëtim që shkon drejt përjetësisë; nëse e pranon dhe thua ‘Po’, pastrohet e shkuara, merr kuptim e sotmja dhe sigurohet e ardhmja me Perëndinë.

Për T’u Menduar

- A ke besuar më parë? Nëse po, a ngjajnë këto hapa me mënyrën sesi besove ti?
- Nëse nuk ke besuar akoma, tek cili hap je sot?
- Cili është hapi më i lehtë sipas mendimit tënd?

- Cili hap të duket më i vështiri?
- Nëse akoma nuk ke besuar, por ke dëshirë t'i besosh Jezusit sot, kthehu te fundi i ditës 5 dhe aty mund të bësh lutjen e shpëtimit, ku ti e fton Atë të vijë në jetën tënde.

Vazhdon tek dita tjetër: Tani që u bërë bir/bijë, ti u rilinde, po fillon një jetë të re, fillove udhëtimin tënd me Zotin. Në pjesën e dytë do të shikojmë gastronominë, ushqimin që të fuqizon për këtë udhëtim.



**“Ushqimi Im është
të bëj vullnetin
e Atit Tim.”**

– JEZUSI

Pjesa 2

Gastronomia, ushqime të veçanta

Ka turistë që i dinë vendet ku ka ushqim të mirë, i dinë më mirë se shumica që jetojnë në Tiranë. Pse? Sepse është pjesë e përjetimit të tyre në udhëtimin që po bëjnë. Dhe e shijojnë shumë pothuajse çdo ushqim të traditës tonë.

Çdo njeri ka nevojë të ushqehet që të ketë rritje dhe shëndet të mirë. Ushqimi fizik është i dukshëm: perime, fruta, mish, ujë, bukë ... dhe të tjerat. Ushqimi fizik kalon nga goja në stomak, tretet në trup dhe një pjesë del jashtë.

Ushqimi frymëror nuk shikohet me sy, por është po aq i nevojshëm për shpirtin. Ky ushqim vjen nga Fjala e Perëndisë, koha në lutje, fuqizimi nga Fryma e Shenjtë, koha që kalojmë në komunitetin e krishterë. Ky lloj ushqimi hyn brenda nesh dhe tretet në shpirtin tonë; ne marrim atë që na duhet për atë ditë. Disa gjëra që dëgjojmë dhe përjetojmë dalin, largohen nga ne, nuk na bëjnë punë në stadin ku jemi.

Jezusi tha: Ushqimi Im është të bëj vullnetin e Atit Tim. Kjo do të thotë se edhe për ne, ushqimi frymëror që marrim është për të na drejtuar të kuptojmë vullnetin e Atit dhe ta zbatojmë atë në jetën e përditshme.

Trupi fizik ka nevojë për tri vakte; disa hanë më pak, disa më shumë dhe më shpesh, por ama është i nevojshëm çdo ditë. Edhe ana frymërore e çdo njeriu ka nevojë të ushqehet rregullisht çdo ditë me elementët e tij.

Prandaj dua të të nxis që ta gjesht menunë e ushqimit për të ushqyer shpirtin dhe të ngopesh çdo ditë me të.

Le ta eksplorojmë këtë menu. Çfarë na duhet që të jemi të shëndetshëm në shpirt? Dhe nuk të duhen lugë e pirunjt për të shijuar një vakt të mirë nga ana frymërore.

Të gjithë kemi mundësinë të hamë dhe do ishte mundësi e humbur nëse ushqehemi keqas kur ushqimet janë aty dhe janë në dispozicionin tonë!

**“Nëse nuk e njohim
Fjalën e Perëndisë, do
të jemi gjithmonë në
padije për vullnetin e
Perëndisë.”**

– BILLY GRAHAM

DITA 7

BIBLËN: DUAJE, MËSOJE, DËGJOJE DHE JETOJE

Çfarë kanë Shkrimet e Shenjta për ne sot?

Bibla është libër i Shenjtë! Nuk para e përdor shpesh këtë fjalë, por mënyra sesi trajtohet Bibla, si lihet pas dore, më shtyu për të përdorur termin Bibla e Shenjtë. Në fakt, ajo është e Shenjtë. Ja një detaj i vogël: fjala ‘Bibël’ do të thotë ‘libër’; edhe pse ajo ka 66 libra brenda, ajo quhet Libri, si një i tërë. Hagios Byblos – Libri i Shenjtë. ‘I shenjtë’ do të thotë ‘i ndarë më vete nga Perëndia për t’u trajtuar me kujdes’. Kjo është e vërteta; ajo u shkrua për të na përcjellë, për të na treguar dashurinë që Perëndia ka për ne. Por, edhe qëndrimi ynë ndaj Biblës ka shumë rëndësi. Dua të shohim bashkë katër gjëra në lidhje me Biblën:

1. Duaje Fjalën e Perëndisë. Duaje me dashuri të madhe.

E ke parasysh kur do dikë shumë dhe bëhesh copash për të, je gati të pëleshesh nëse dikush flet keq për atë person, je gati të kacafytesh. Kur të përmend dikush emrin e mamit ose dikujt që e do shumë, a të ngrihen qimet përjetë, a të trazohet diçka në stomak? Me shumë gjasa, po. Pyetje: A trazohesh kur dikush tallet me Biblën, kur i keqpërdor fjalët e saj dhe hedh baltë mbi të? Apo s’ta ndjen fare?

Duaje Biblën me pasion, që kur dikush të flasë keq për të, të të trazojë ngaqë e do shumë dhe je plot me të. Pse? Sepse ja si thuhet: I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndrejtje dhe për edukim me drejtësi, që njeriu i Perëndisë të jetë i përkryer, tërësisht i pajisur për çdo vepër të mirë.

Është i frymëzuar nga Perëndia, ka një autor edhe pse e shkruan 40 persona të ndryshëm. Është i dobishëm për çdo gjë që i duhet njeriut

të Perëndisë, që të duhet ty... për jetën, punën, familjen, shkollën; çdo gjë e ke aty. Është Fjala e Perëndisë; duaje fort, dashuroje fort, janë fjalët e Krijuesit tënd, Atij që të dha formë. Te Bibla gjen përgjigjet e pyetjeve të jetës, gjen parime, gjen premtime jete.

Le të kemi qëndrimin që u tha Pali besimtarëve të parë në Selanik të Greqisë: Prandaj edhe ne e falënderojmë pa pushim Perëndinë, se kur ju keni marrë nga ne fjalën e Perëndisë, e pritët atë jo si fjalë njerëzish, por, sikurse është me të vërtetë, si fjalë Perëndie, që vepron ndër ju që besoni.² ‘E pritët’ ka kuptimin ‘kur pret, kur mirëpret dikë në shtëpi’. Kështu e pritën, e mirëpritën Selanikasit Fjalën e Perëndisë, si nga Perëndia. Dhe kur ti e di që është nga Perëndia – çfarë thotë pjesa e fundit – e beson dhe e lejon të veprojë, të të ndryshojë ty.

Dua shumë që ta shikosh Biblën si letër dashurie nga Perëndia. Unë dhe Ada, gruaja ime, akoma i kemi letrat tona të dashurisë edhe pse kemi 20 vite të martuar dhe 23 vite të dashuruar. I lexojmë herë pas here, shpesh qeshim, sa naivë kemi qenë, dhe kënaqemi sa shumë e donim njëri-tjetrin që në fillim. Bibla është letër dashurie, Ai të do pa kushte, të do me naivitet, (të do sepse të do, nuk të do sepse ke bërë apo s’ke bërë diçka) të do me çiltërsi, të do marrëzisht, sa dha Birin e Tij. E ku ka dashuri më të madhe se kjo?!

Duaje Biblën, duaje fort, bazojë jetën në gjërat që thotë. Çmoje si thesar, si diçka shumë të shtrenjtë. E dyta, jo vetëm ta duash por ...

2. Mëso nga Fjala e Perëndisë. Si mund të mësosh nga

Fjala e Perëndisë? Lexoje Fjalën e Perëndisë, çdo ditë lexoje.

Jezusi tha: Është shkruar: ‘Njeriu nuk rron vetëm me bukë, por me çdo fjalë që del nga goja e Perëndisë.’³ Leximi i Biblës ndodh kur unë e krijoj vetë kohën për ta lexuar. Sepse do të ketë shumë gjëra

që do ta marrin vëmendjen dhe kohën. Kur është koha më e mirë për ty për t'u ulur dhe lexuar Biblën? Në mëngjes herët, në pushimin e drekës, pasdite, në darkë, atëherë kur e ke më mbarë ti? Ja të bëjmë disa llogari.

A e di se Bibla ka 1.189 kapituj, 31.173 vargje, 773.746 fjalë. Po i radhis këto sepse ti mund ta lexosh të gjithë Biblën dy herë në muaj. Duhet rreth 56-60 orë për ta lexuar të gjithë Biblën dhe mesatarisht koha që shumica e të rinjve kalojnë në media sociale është 4 a më shumë orë në ditë; i bie të paktën 120 orë në muaj. Nëse do të konvertohej në kohë leximi, i bie që mund ta lexosh 2 herë në muaj. Nuk po e them që të ndihesh keq për kohën që kalon në social media, por dua të të nxis. Nëse nuk e ke lexuar Biblën asnjëherë nga fillimi deri në fund, po sikur ta lexosh të paktën një herë nga fillimi deri në fund? Dhe mund ta gjes kohën; thjesht përgjysmo kohën që kalon në media sociale për një muaj.

Pasi e lexon Biblën, mbylle dhe lutu shkurt: Ati im, Perëndia im, çfarë po më flet sot me këto vargje, kapituj...?

3. Dëgjoje Fjalën e Perëndisë. Tek aplikacioni YouVersion mund ta dëgjosh Biblën në një version në shqip dhe në shumë versione në anglisht. Kur vjen çdo të diel në kishë, e dëgjon aty. Nëse s'ke mundësi të shkosh në kishë, e gjen në YouTube dhe platforma të tjera. Ja çfarë tha Jezusi për dëgjimin dhe praktikimin e Biblës: Prandaj, ai që i dëgjon këto fjalë të Mia dhe i vë në praktikë, mund të krahasohet prej Meje me një njeri të zgjuar, që e ka ndërtuar shtëpinë e tij mbi shkëmb.⁴

Të gjithë njerëzit kalojnë furtuna në jetë. Por ama furtunat kanë efekte të ndryshme tek çdo person dhe të gjithë e përjetojnë ndryshe, sepse ka shumë rëndësi themeli ku e kanë ndërtuar jetën. Këto kohë

në lajme flitej për një furtunë që ka ndodhur në Alaskë dhe në video shikoje sesi lumi po merrte shtëpitë që ishin ndërtuar buzë tij dhe që kishin themele të cekëta.

Si je ti kur kalon furtuna, a hutohesh, a tronditesh, a të merr lumi? Apo qëndron i/e fortë? A dëshiron që të qëndrosh i fortë? Ndërtoje shtëpinë, jetën tënde mbi shkëmb, mbi parimet e Biblës.

4. Jetoje Fjalën e Perëndisë. Tek letra e Palit drejtuar Efesianëve kapitulli 6, ka përshkrime për armatimin e Perëndisë. Aty Fjala e Perëndisë përshkruhet si një shpatë.

Aty ke përshkrime për mburojën, parzmoren, përkrenaren, brezin, këpucët ... shiko të gjitha këto armatime janë për t'u mbrojtur. Vetëm njëra është për të sulmuar, Fjala e Perëndisë, shpata e Tij. Ja si e përshkroi Davidi këtë gjë: Si mundet një i ri të bëjë rrugën e tij të pastër? Duke e ruajtur me fjalën Tënde. Të kam kërkuar me gjithë zemër; mos më lër të devijoj nga urdhërimet e Tua. E kam ruajtur fjalën Tënde në zemrën time, që të mos mëkatoj kundër Teje.⁵ Ka vetëm një mënyrë për të jetuar një jetë të pastër, për të ecuar në një rrugë të pastër: duke jetuar sipas Fjalës së Perëndisë. Kaq e thjeshtë, kaq e qartë është.

Ne vitin 1993 erdhi një misionar nga Boise, Idaho, ShBA, dhe jetoj në fshatin tim 4 vite. Unë e kisha komshi. Bashkë me dy nga motrat e mia ishim pjesë e kishës që filloi te shtëpia e tij. Një nga gjërat që ai kishte shumë qejf ishte mësimi i vargjeve përmendësh.

Dukej e lodhshme në ato kohë. Ne mendonim: Sa mirë që s'kemi shkollë, se do ishim duke mësuar përmendësh poezitë e Naimit; tani ti po na kërkon ti të mësojmë vargje përmendësh! Por nuk është se ankoheshim me zë dhe të bindur i mësonim vargjet. Me kalimin e

kohës, Fjala e Perëndisë ruhej në zemrat tona. Ndodhi që misionari duhej të largohej, në mars 1997, por Fjala e Perëndisë mbeti në zemrat tona, për të na ruajtur dhe për të na përgatitur për gjërat që do të vinin më vonë.

Sot mësimi i vargjeve përmendësh duket sikur është vetëm për fëmijët. Në fakt është për të gjithë, që të gjithë të thonë një ditë: E kam ruajtur fjalën Tënde në zemrën time që të mos mëkatoj kundër Teje.

Sa mirënjohës i jam Perëndisë që e kemi në gjuhën tonë shqipe Fjalën e Tij. A do ta falenderojmë Perëndinë për Fjalën e Tij që tani?!

At, faleminderit që e kemi fjalën Tënde në Shqip. Sa e sa vende në botë nuk e kanë Biblën ose nuk u lejohet ta lexojnë atë. Faleminderit për lirinë që na ke dhënë në këtë vend. Na ndihmo ta përdorim këtë liri për ta njohur më mirë dhe për t'u thelluar më shumë në fjalën Tënde dhe për ta ndërtuar jetën tonë në bazë të saj. Në emrin Jezus lutemi, amen!

Nëse ke dëshirë që të kesh një Bibël dhe akoma nuk e ke, na shkruaj në media sociale të ICF Tirana (Facebook ose Instagram) dhe dikush do të ta gjejë shumë shpejt, ose më shkruaj mua. Për ty që je në Tiranë e ke kollaj, kalo vetë në ICF Tirana për ta marrë.

Dhe nëse ke dëshirë që ta kesh në telefon Biblën që ta lexosh në çdo kohë, shkarkoje aplikacionin nga QR këtu poshtë.



Për T'u Menduar

- A ke një Bibël, libër prej letre në shtëpi? Nëse jo, a ke dëshirë ta kesh? Më shkruaj që të ta dhuroj një të tillë.
- Cila nga këto të katërta ishte diçka e re për ty?
- A do të përkushtohesh për ta lexuar Biblën të paktën një herë nga fillimi deri në fund? ____ Po ____ Akoma Jo

Vazhdon tek dita tjetër: Perëndia e mbyll magazinën e Tij, kur ne mbyllim gojën tonë. - Charles Spurgeon

**“Këto katër gjëra
nuk duhen harruar
kurrë: Perëndia
i dëgjon lutjet,
Perëndia ia vë veshin
lutjes, Perëndia i
përgjigjet lutjes dhe
Perëndia vepron me
anë të lutjeve.”**

– E.M. BOUNDS

DITA 8

LUTJA; PSE TË LUTEM?

Si të bisedoj me Perëndinë?

Cili është qëllimi i lutjes? Së pari, mos harro se lutja është ideja e Perëndisë. Nëse Ai nuk donte të dëgjonte nga ti, nuk do të kërkonte që të luteshe. Perëndia do që të dëgjojë nga ti sepse Ai të do dhe e ka e mendjen tek çdo detaj i jetës sate. Nuk ka gjë të vogël ose gjë të madhe që nuk duhet biseduar me Të.

Tek tre kapituj të ungjillit sipas Gjonit, kapitujt 14, 15, 16, Jezusi po u jep udhëzimet e fundit dishepujve të Tij para se të vdesë në kryq; është nata e fundit me ta. Te kjo bisedë e fundit, Ai u thotë disa herë pse ka rëndësi lutja. Ja t'i shikojmë disa arsye pse është e rëndësishme lutja. Jezusi u thotë së pari...

1. Lutja është shenjë varësie. Lutja është mundësia jonë për të treguar sesa të lidhur jemi me Perëndinë dhe sa të varur jemi tek Ai, duke i thënë: Perëndi unë kam nevojë për Ty, unë po mbështetem tek Ti për të marrë përgjigje për këtë gjë që kam.

A e di cila është pengesa e parë që s'të lë të lutesh? Krenaria. Pse të lutem kur unë mund ta bëj vetë, pse të varem te Perëndia, kur mund të varem te fuqitë dhe aftësitë e mia? Që nga koha e Adamit dhe Evës e deri më sot, njeriu i ka mbivlerësuar shumë aftësitë e tij dhe e ka rralluar varësinë te Perëndia. Nuk më duhet ndihmë sepse ia dal vetëm. Me të vërtetë? Po si po duket, a po ia del mirë? Në mendje po, në realitet është tjetër muhabet.

Të lutesh, do të thotë të lësh krenarinë. E di kur lutja bëhet thelbësore në jetën tënde? Dikush ka thënë: Kur hasim fundin,

atëherë fillojmë të gjejmë fillimin me Perëndinë. Kur lëshojmë krenarinë, fillojmë të kapim Perëndinë.

Niveli i varësisë të Perëndia tregohet nga niveli i lutjes që bën ndaj Tij. Sa më pak lutesh, aq më shumë tregon se po varesh te vetja, te krenaria jote. Ja disa vargje në lidhje me varësinë të Perëndia: Unë jam hardhia, ju jeni shermendet; kush qëndron në Mua dhe Unë në të, jep shumë fryt, sepse pa Mua nuk mund të bëni asgjë. Në qoftë se ndokush nuk qëndron në Mua, hidhet jashtë si shermendi dhe thahet; pastaj i mbledhin, i hedhin në zjarr dhe digjen. Në qoftë se qëndroni në Mua dhe fjalët e Mia qëndrojnë në ju, kërkon çfarë të doni dhe do t'ju bëhet.¹ Kush qëndron... kush rri i lidhur me Mua... Pjesa e fundit është shumë e fuqishme: kërkon çfarë të doni është sikur të na japë dikush një kartë bankomati, por pa PIN ose me PIN që s'e harron, me katër njësha, dhe pa limit tërheqje, shko merr sa të duash. Ky është premtim shumë i madh apo jo? Por ama ka lidhje me varësinë që ti ke me Të. Për sa kohë qëndron i lidhur me Të, si dega me hardhinë, kërkon në emrin Jezus çfarë të duash. Cila është arsyeja e dytë pse duhet të lutemi?

2. Lutja është shenjë e komunikimit të mirë. Shiko, shumica e problemeve në jetë, në familje, në çift, në lidhje, në punë, vijnë sepse nuk ka komunikim të mirë ose mungesë komunikimi. Kjo sjell probleme, sjell hamendësime, sjell dyshime, krijon tensione. Nuk do të arrish ta kuptosh dikë, nëse nuk flet mjaftueshëm me të. E njëjtja gjë; nga do e kuptosh cili është qëllimi i Perëndisë për jetën tënde nëse nuk komunikon, nëse nuk flet me të? Është jetësore të flasësh dhe të dëgjosh nga Perëndia. Dhe shiko, ti nuk e di sesi të komunikosh me dikë, kur s'e di në çfarë niveli është marrëdhënia jote me të. Prandaj del pyetja: si është marrëdhënia, si është lidhja jote me Perëndinë, në çfarë niveli?

Ja ta shikojmë sesa bukur e përshkruan Jezusi marrëdhënien tonë me Të: Unë nuk ju quaj më shërbëtorë, sepse shërbëtori nuk e di ç'bën i zoti; por Unë ju kam quajtur miq, sepse ju bëra të njihni të gjitha gjëra që kam dëgjuar nga Ati Im. Nuk më keni zgjedhur ju Mua, por Unë ju kam zgjedhur juve; dhe ju caktova të shkoni dhe të jepni fryt, dhe fryti juaj të jetë i qëndrueshëm, që, çfarëdo gjë që t'i kërkonit Atit në emrin Tim, Ai t'ju japë.² A e pe sa bukur? Jezusi thotë: “Arsyeja pse ti mund të më kërkosësh çdo gjë Mua, është se ne jemi shokë bashkë, jemi miq bashkë.” Perëndia që krijoi gjithë universin thotë: “Unë të quaj shok, mik.” Dhe kjo është super sepse kur ti shkon të takosh dikë në një zyrë, do të duhet të kalosh disa persona derisa të shkosh te drejtori, nëse arrin të shkosh. Kurse Perëndia thotë: “Në marrëdhënien tonë nuk ka burokraci; hajde tek Unë direkt.” E ke parasysh kur ke një miqësi të tillë me dikë. Ti i thua dikujt: Bjeri telefonit tim në çdo kohë, sepse ty të kam shok, të kam mik. Më thuaj në çdo kohë çfarë halli ke. Dhe kur ke një lidhje të tillë me dikë, ti nuk flet

me të vetëm kur ke hall, por edhe kur ke gëzim; të bëhet pjesë e jetës tënde. Shumëzoje këtë marrëdhënie me miliona herë dhe e tillë është shoqëria jote me Jezusin. Më quaj shok, mik, - thotë Ai. - Fol me mua si me një shok të ngushtë, si me një mik për kokë, ma thuaj troç ku e ke hallin. Kjo është lutja.

Çfarë privilegji! Cila është arsyeja e tretë, pse të lutem?

3. Lutja është shenjë përgjërimi (kur kërkon pa ndalim).

Përgjërimi është fjalë në Bibël. Mos u shqetësoni për asgjë, por, në çdo gjë, ia parashtroni kërkesat tuaja Perëndisë me anë lutjesh dhe përgjërimesh, me falenderim.³ Dhe e di çfarë rezultati sjell? Dhe paqja e Perëndisë, që ia tejkalon çdo zgjuarsie, do të ruajë zemrat tuaja dhe mendjet tuaja në Krishtin Jezus.⁴ Kur kërkon me

përgjërim, e kërkon disa herë atë gjë; rezultati është mendje e paqtë, mendje e qetë. Kush nuk e do këtë? Ja çfarë thotë Jezusi: Atë ditë ju nuk do të më bëni më asnjë pyetje. Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them se çdo gjë që t'i kërkonit Atit në emrin Tim, Ai do t'ju japë. Deri tani ju s'keni kërkuar asgjë në emrin Tim; kërkonit dhe do të merrni, që gëzimi juaj të jetë i plotë. ⁵ E kape fundin e vargut? Jezusi do që të kesh gëzim, jetë të gëzuar, një marrëdhënie të gëzuar me Atin. Kërkoji Atij në emrin Tim, - thotë Jezusi. – Dhe do të jesh i gëzuar, sepse do të kërkoesh, dhe kur ti kërkon, Unë do të përgjigjem. Çfarë premtimi!

Në fakt, lutja është metoda që ka zgjedhur Perëndia për të plotësuar nevojat tona. Madje Bibla thotë se ka gjëra që Perëndia do t'i bëjë për ne, vetëm nëse lutemi. Ka njerëz që thonë: Po pse të lutem, Perëndia është i gjithëdijshëm, e di çfarë nevojash kam unë. Madje Ai e di se çfarë më duhet mua, para se ta marr vesh unë vetë, Ai është i gjithëdijshëm. Prandaj, Perëndia më jep gjërat që më duhen, atëherë kur më duhen, s'kam nevojë t'i kërkoj. Por nuk funksionon kështu. Ai do të të japë disa gjëra në jetën tënde vetëm nëse i kërkon: ...ju nuk keni sepse nuk i kërkonit (Perëndisë). ⁶

Shumë herë thuhet në Bibël që të kërkojmë në lutje: Kërkonit dhe do t'ju jepet, lypni dhe do të merrni, trokisni dhe do t'ju hapen dyert, kërkonit në emrin Tim. Ky është kuptimi i përgjërimit. Perëndia e mbyll magazinën e Tij, kur ne mbyllim gojën tonë. -Charles Spurgeon

Ti nuk ke sepse nuk ke kërkuar; Perëndia ta lë topin ty, kërko dhe do të marrësh. Nëse nuk kërkon, nuk do të marrësh. Çfarë të mungon në jetë? Mos ka lidhje me këtë, që nuk po i kërkon Perëndisë? Shko tek Ai dhe thuaji: Perëndi, bëj këtë për mua, më ndihmo këtu, krijo këtë mundësi, më siguro, më jep... Po ky vargu: Ai kënaq dëshirën

e atyre që kanë frikë prej Tij, dëgjon britmën dhe i shpëton? ⁷ Shikoje çfarë thotë vargu: jo vetëm nevojat, por edhe dëshirat e tyre. Nëse e ke frikë, e nderon Zotin, i beson me gjithë zemër dhe e di çfarë është gjëja e duhur, dëshira e duhur që e nderon Atë, kërkoje dhe Ai do ta plotësojë.

Ja çfarë krahasimi bëri Jezusi për Atin. A ka midis jush ndonjë njeri që, po t'i kërkojë i biri bukë, t'i japë një gur? Ose po t'i kërkojë një peshk, t'i japë një gjarpër? Në qoftë se ju, që jeni të këqij, dini t'u jepni dhurata të mira bijve tuaj, aq më tepër Ati juaj, që është në qiej, do t'u japë gjëra të mira atyre që ia kërkojnë. ⁸ I tillë është Perëndia ynë; Ai i plotëson kërkesat, nevojat, dëshirat kur ia kërkojmë Atij. Cila është arsyeja e katërt pse duhet të lutemi?

4. Lutja është shenjë bashkëpunimi. Ndoshta kjo është e çuditshme për dikë, ndoshta po e dëgjon për herë të parë.

Por Perëndia ka zgjedhur të bashkëpunojë me ne, që të bëhet vullneti i Tij në tokë. Dhe këtë e bën nëpërmjet lutjeve tona. Ndoshta një nga vargjet më gjigante në Bibël është ky: Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them: kush beson në Mua do të bëjë edhe ai veprat që bëj Unë; madje do të bëjë edhe më të mëdha se këto, sepse Unë po shkoj tek Ati. ⁹

Prit pak; nëse ka vargje që e kam patur të vështirë t'i besoj nga Bibla, ky është një nga ato. Sepse mua s'më duket sikur po bëj gjëra më të mëdha sesa ka bërë Jezusi, nuk e di për ty. Si mund të ndodhë kjo njëherë? Pa lexuar vargjet pasuese nuk arrin ta kuptosh dot: Dhe çfarëdo të kërkonin në emrin Tim, do ta bëj, që Ati të përlehtëhet në Birin. Në qoftë se do të kërkonin diçka në emrin Tim, unë do ta bëj.

¹⁰ Kjo është përgjigja! Si mund të bëjmë më shumë sesa bëri Jezusi? Kur Jezusi erdhi në tokë, me dëshirën e Tij, Ai e kufizoi veten në një trup fizik njerëzor dhe kështu Ai mund të bënte një gjë, një

mrekulli, pastaj një tjetër, pastaj një tjetër. Madje, me dëshirë e kufizoi veten vetëm në kombin e Izraelit. Jezusi nuk bëri mrekulli në Shqipëri, Kinë, Itali, Turqi. Por kur ne lutemi, kur ne lutemi dhe veprojmë bashkë, ne që jemi trupi i Krishtit – kisha është trupi i Krishtit kudo në botë – dhe bëjmë gjëra kudo që jemi në emrin e Tij dhe lutemi në emrin e Tij, atëherë shuumë gjëra ndodhin njëkohësisht kudo nëpër botë; që i bie, ndodhin shumë më shumë gjëra kudo në botën e Tij.

Perëndia thotë: “Pjesa jote është të kërkosh, pjesa Ime është të veproj. Nëse ti lutesh Unë do ta bëj; kjo është pjesa e bashkëpunimit.” Gjëja më e rëndësishme për ty, puna më e rëndësishme, është të lutesh, të bisedosh me Perëndinë. A e kupton sesa e rëndësishme është lutja? Jeta, martesja, familja, puna, shkolla, çdo gjë jotja do të marrë shpresë të re kur ti lutesh. Çfarë të mungon në jetë? Pse nuk ia ke kërkuar në lutje Perëndisë?

Për T’u Mënduar

- Në një ditë normale, sa herë mund të thuash ‘o Zot’?
- Martin Luteri ka thënë: “Lutja është si oksigjen për shpirtin.” A bie dakord edhe ti?
- Cila nga këto katër pika ishte e re për ty; cilën e dije?
- A do të lutesh në këtë sekondë për diçka që po të mundon dhe po përpiqesh vetë, pa ndihmën e Perëndisë? Çfarë është? Thuaja Atij që tani?

Vazhdon tek dita tjetër: Gjej kënaqësinë tënde në Zotin dhe Ai do të plotësojë dëshirat e zemrës sate.¹¹



**“Koha personale me
Perëndinë nuk është
çështje kohe, por
çështje zemre; nëse
ke dëshirë të kalosh
kohë me Perëndinë
do ia gjesh anën.”**

– CHARLES SPURGEON

DITA 9

KOHJA PERSONALE ME PERËNDINË

Sikur pi kafe me Të çdo ditë.

Koha personale me Perëndinë është kohë e përditshme për të bërë dialog me Perëndinë. Kur lexon Biblën, Ai të flet ty. Kur lutesh, ti flet me Të. Koha jote me Perëndinë duhet të jetë përparësia sepse ne jemi krijuar që të kemi marrëdhënie, miqësi, të bisedojmë, të komunikojmë me Perëndinë. Jezusi vdiq për të na e mundësuar këtë miqësi. Adami dhe Eva mëkatuan dhe u prish miqësia e njeriut me Perëndinë. Vetëm pasi Jezusi pagoi për mëkatën, u bë e mundur të rregullohej miqësia jonë me Të.

Madje Jezusi vetë, kur ishte në Tokë, kalonte kohë me Atin. Por Ai tërhiqej në vende të vetmuara dhe lutej.¹ Kur lexon Biblën, shikon se të gjithë ata që Zoti i ka përdorur fuqishëm bisedonin me Perëndinë rregullisht: Abrahami, Moisiu, Jozueu, Davidi, Danieli, Pali... kjo i bëri ata të fortë për gjërat që u kërkonte Perëndia. Është nevojë e përditshme për ne sepse; Njeriu nuk jeton vetëm me bukë, por me çdo fjalë që del nga goja e Perëndisë.² Nëse nuk ushqehesh fizikisht, do të dobësohesh; kështu ndodh dhe kur nuk kalon kohën personale me Zotin. Përse duhet koha e përditshme me Perëndinë?

1. Për t'i dhënë përkushtimin tim Perëndisë. Shko para Perëndisë, dhe jo për të marrë prej Tij, por thuaj sa e do, falenderoj dhe adhuroj Atë. Si thotë ky vargu: I jepni Zotit lavdinë që i përket emrit të Tij; adhurojeni Zotin në shkëlqimin e shenjtërisë së Tij.³ Kur ti vjen para Perëndisë në mëngjes, në drekë apo pasdite, kurdo që të vish, tregoji përkushtimin tënd Atij. Tregoji sesa shumë e do. Perëndia e meriton përkushtimin

tënd, sepse vetëm Ai është i denjë. ⁴ Nuk ka njeri në botë që është i denjë për përkushtimin tonë veç Perëndisë. Perëndia jo vetëm që është i denjë, por Ai e dëshiron përkushtimin tonë, Ai kërkon adhures. ⁵ Është si dy të dashuruar të cilët e dinë se janë të dashuruar, por herë pas here kanë dëshirë ta dëgjojnë nga goja e njëri-tjetrit. Perëndia i di mendimet e tua; e di se ti e do, por Ai dëshiron ta dëgjojë nga goja jote herë pas here.

2. Për të marrë drejtim prej Perëndisë. Kur shkon tek Perëndia në kohën tënde personale, pasi i ke thënë që e do, fillo ta pyesësh Perëndinë çfarë ka Ai për jetën time? Në cilin drejtim duhet të vazhdoj? Çfarë qëllimesh duhet të arrij? Reflekto për jetën tënde dhe kërkoj drejtim Atij, siç tha mbreti David: O Zot, më trego rrugët e Tua, më mëso shtigjet e Tua. Më udhëhiq ... ⁶

3. Për të gjetur kënaqësi tek Perëndia. Ka gëzim në praninë e Perëndisë. Nëse po përjeton pak gëzim në jetën tënde, ndalo dhe pyete veten: Sa kohë po kaloj me Perëndinë, a po kaloj kohë me Perëndinë? Gjej kënaqësinë tënde në Zotin dhe Ai do të plotësojë dëshirat e zemrës sate, ⁷ ...ka shumë gëzim në praninë Tënde. ⁸

4. Për t'u bërë më shumë si Jezusi. Qëllimi i Perëndisë për jetën tonë ka qenë gjithmonë për të na bërë si Biri i Tij. Kjo

është arsyeja pse të gjitha gjërat që vijnë në jetën tonë, Ai i përdor dhe i bën të bashkëveprojnë për qëllimin dhe për lavdinë e Tij. Kështu që, sa herë shkon dhe kalon kohë me Perëndinë, po bëhesh më shumë si Ai dhe do të ndryshosh në ngjashmëri me Të. Pse? Sepse ne ngjajmë me ata që kalojmë kohë. Nëse ti do të bëhesh si Krishti, rri me Të. Ata, kur e panë çiltërsinë e Pjetrit

dhe të Gjtonit... u mrekulluan dhe i njihnin që kishin qenë me Jezusin!⁹ Disa hapa praktikë:

a. Cakto një kohë. Kur është koha më e mirë për të bërë kohën e qetë? Koha më e mirë është kur jam më mirë. Jepi Perëndisë pjesën më të mirë të ditës, jo mbeturinat e saj. Zgjidh një kohë kur ti je më në formë dhe jepja atë kohë Perëndisë.

b. Sa duhet të zgjasë kjo kohë? Unë do të sugjeroja që të fillosh me 15 minuta në ditë, një çerek ore. Dita ka 96 çereke ore; një nga ato kalaje si kohë personale me Perëndinë.

c. Cakto një vend të veçantë, ku të jesh vetëm. Pastaj Jezusi doli dhe shkoi si zakonisht në Malin e Ullinjve për t'u lutur.¹⁰ Kjo do të thotë se e kishte zakon. Ishte një vend i zakonshëm, një vend i veçantë. Ku është për ty një vend i tillë? Te dhoma e ndenjes, te dhoma jote, te ballkoni, te kafeneja e lagjes... Gjej një vend që është i veçantë për ty; në fakt do të bëhet edhe më i veçantë sa më shumë kohë të kalosh aty me Perëndinë.

d. Çfarë të duhet? Një Bibël, një bllok/fletë dhe një gjë për të shkruar; kaq.

e. Një plan i thjeshtë për 15 minutat me Perëndinë. Pesë minutat e para, lexo Biblën. Pesë minutat e dyta, mendo,

medito, çfarë të foli Perëndia sot. Pesë minutat e fundit, luto, bisedo me Perëndinë në lidhje me atë që të foli dhe për ditën që ke përpara.


Po nëse humbas ndonjë ditë? Po s'ka gjë; fakti që të iku një ditë pa kaluar kohë me Perëndinë nuk do të thotë se gjithë dita nuk

ka vlerë, sepse ne jetojmë me anë të hirit. A ke lënë ndonjëherë një vakt pa ngrënë? Me shumë gjasa po. Çfarë bërë kur harrove? Hëngre pak më shumë vaktin tjetër. Nëse të ikën një ditë pa kohën e qetë, mos hiq dorë. Mirë, e harrova, më iku, por nesër do të kaloj 20 minuta. Të duhen 3-4 javë për t'u familjarizuar me një zakon të ri. Pastaj të duhen edhe 4 javë të tjera derisa të bëhet një zakon i përditshëm. Shumica e njerëzve nuk e kanë kaluar dot këtë sfidë prej 8 javësh. Prandaj, nuk janë të qëndrueshëm në këtë zakon. A do që ti të jesh ndryshe, siç është ky premtimi: Le të mos lodhemi duke bërë të mirën; sepse, po të mos lodhemi, do të korrim në kohën e vet.¹¹

Është privilegj që mund të bisedojmë me Krijuesin tonë në këtë mënyrë dhe kjo u mundësua me anë të vdekjes së Jezusit. Vendose si gjë të rëndësishme dhe përkushtohu, qepju pas dhe do ta shikosh përfitimin në jetën tënde dhe do ta shijosh shumë.

Për T'u Menduar

- A ke kaluar kohë personale me Perëndinë më parë? ____ Po
____ Jo
- Cila është pjesa më e lehtë kur kalon kohë me Perëndinë: leximi i Biblës, meditimi, lutja apo të treja janë të lehta?
- A ka patur momente kur ty nuk të bëhej të kaloje kohë me Perëndinë, por përsëri nuk hoqe dorë? Nëse po, çfarë të shtyu?
- Nëse s'ke kaluar kohë personale me Perëndinë më parë, a do të fillosh që sot, që tani, të kalosh 15 minuta kohë më Të?



**“Fryma e Shenjtë
dëshiron të na
ndihmojë të
mendojmë siç
mendon Perëndia,
të ndjejmë siç
ndjen Ai dhe të
dëshirojmë gjërat
që dëshiron Ai.”**

– ROBERT MORRIS

DITA 10

FRYMA E SHENJTË

Ai që rri me mua gjithë kohën.

Kur zgjodhe t'i besosh Jezusit si Zoti dhe Shpëtimtari yt, Ai premtoi: “Nuk do të të lë vetëm.” Në këtë udhëtim që ke nisur me Perëndinë, nuk je vetëm. Ke një shok, një ngushëllues, një mësues, një fuqizues, një udhëzues dhe shumë veti të tjera që ka Ai. A e di kush është? Është Perëndia Frymë e Shenjtë!

Jezusi vetë na premtoi një jetë të plotë dhe kjo vjen nga një marrëdhënie e ngushtë me Perëndinë. Perëndia është tre në një: Perëndia Atë, Perëndia Bir, Perëndia Frymë e Shenjtë. Dhe këtë marrëdhënie, miqësi të ngushtë dhe këtë jetë të plotë na e jep Fryma e Shenjtë që banon në ne, që në momentin kur zgjodhëm me vullnetin tonë të lirë t'i besojmë Jezusit si Zot dhe Shpëtimtar.

Disa e trajtojnë Fymën e Shenjtë si diçka të bukur për ta patur, si dekorim. Kur unë dhe Ada u martuam, e filluam jetën martesore me vështirësi, si shumica e çifteve të reja, sepse nuk kishim mundësi të blinim të gjitha gjërat që na duheshin tek shtëpia e re. Por ama, edhe pse nuk kishim shumë, i blemë disa gjëra për dukje. Një mbulesë të bukur tavoline, që vihej për t'u dukur bukur tavolina, por kur hanim, e hiqnim dhe vendosnim një mbulesë të thjeshtë. Blemë gjithashtu nja 2-3 sete gotash që nuk i përdornim, por ishin te bufeja për zbukurim, si dhe një mbulesë krevati që vihej për t'u dukur bukur, por jo për t'u mbuluar me të natën.

Fryma e Shenjtë nuk është “një gjë e bukur” për të zbukuruar jetën tonë; është shumë më shumë se kaq. Por çfarë bën Ai për

ne? Jezusi, kur e premttoi, bëri dhe përshkrimin sesi do të ishte dhe çfarë do të bënte për ne Fryma e Shenjtë. Ai do të jetë: 1. Ngushëllues. E ke parasysh kur takon një person të ri, sa e lehtëson punën kur ta prezanton dikush më përpara? Jezusi këtë bëri; e prezantoi Ai vetë kush është Fryma e Shenjtë. Ai tha: Unë do t'i lutem Atit dhe Ai do t'ju japë një Ngushëllues tjetër, që do të qëndrojë përgjithmonë me ju. ¹ Ai do të jetë me ty, Ai do të të ngushëllojë, do të të ndihmojë. Si do të na ngushëllojë, ndihmojë? Dy nga shumë gjërat që bën i shpreh ky varg: Ngushëlluesi, Fryma e Shenjtë, që Ati do ta dërgojë në emrin Tim, do t'ju mësojë çdo gjë dhe do t'ju kujtojë të gjitha këto që ju thashë. ² Do t'ju mësojë – kjo është e bukur, sepse Perëndia është ekspert në çdo lloj lënde apo teme – do t'ju kujtojë gjërat që ju ka thënë tashmë Jezusi. Ai do të më ndihmojë kur s'di çfarë të them. Do të më ndihmojë të flas kur duhet dhe të më ndihmojë ta mbyll gojën atëherë kur nuk duhet të flas.

2. Bindës. Ja si tha Jezusi për Frymën e Shenjtë: Dhe kur të ketë ardhur, Ai do ta bindë botën për mëkat, për drejtësi dhe për gjykim. ³ Fryma e bind dikë që ka mëkatuar, nuk është puna jonë. Fryma e Shenjtë e afron dikë tek Perëndia duke krijuar tek ai nevojën për Perëndinë, që ta kuptojë se ka nevojë për Shpëtimtarin. Ishte fund qershori 1993, në një kodër 20-25 minuta më këmbë larg shtëpisë në fshat, kur Fryma e Shenjtë më bindi se kam nevojë që Perëndia të më ndryshojë, të më shpëtojë dhe të zgjedh t'i besoj Atij. Kjo nuk ka kuptimin të na poshtërojë ose të na rëndojë që të ndihemi mizerje, apo të na akuzojë. Akuzimi është puna e djallit; ai i akuzon të krishterët sepse do që të ndihemi të pavlerë para Perëndisë duke na kujtuar të gjitha rastet kur ia kemi fut kot. Fryma e Shenjtë na bën me dije se pa Jezusin jemi të humbur, kemi nevojë për Të, si dhe na drejton

drejt shpëtimit. 3. Miku yt. Dhe për shkak se është miku, shoku yt i mirë, Ai sjell shumë përfitime që na i vë në dispozicion.

Fuqi: Ju do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju... ⁴ Që i bie se nuk kemi pse të luftojmë, të përpiqemi me forcat tona, sepse Fryma e Shenjtë na fuqizon. Fjala ‘fuqi’ në gjuhën origjinale është ‘dynamis’, nga vjen fjala ‘dinamit’. S’kemi pse të jetojmë jetë të vogla sikur fuqia e Perëndisë në jetën tonë është si kapsolle 10-lekëshe, kur në fakt është dinamit.

Dashuri: Ai derdh dashuri brenda nesh: Por shpresa nuk turpëron, sepse dashuria e Perëndisë është derdhur në zemrat tona me anë të Frymës së Shenjtë që na është dhënë. ⁵ Prandaj, pasi dikush ka zgjedhur t’i besojë Jezusit, Fryma e Shenjtë që është në të e mbush me dashuri dhe ky person ka dashuri edhe për njerëz që nuk i duronte dot deri dje.

Fryte: Madje nëntë fryte: Por fryti i Frymës është: dashuria, gëzimi, paqja, durimi, mirëdashja, mirësia, besimi, zemërbutësia, vetëkontrolli. ⁶ Sa më shumë i kërkon dhe sa më shumë varesh nga Fryma e Shenjtë, aq më shumë dhe aq më shpesh do t’i prodhojë në ty këto fryte që do jenë të shijshme sa herë që të duhen. Dhunti: Frytet e Frymës janë dhunti, janë dhuratë, por Ai na jep edhe plot dhunti të tjera, aftësi për t’i shërbyer dikujt, për të bërë diçka ndaj dikujt në emrin e Tij, dhunti, aftësi që nuk i kishim më parë.

4. Ai na flet. Na flet me anë të Biblës; ti je duke lexuar dhe një nga vargjet duket personal dhe më i qartë. Mund të jetë një varg inkurajimi, udhëzimi, korrigjimi, konfirmimi ose varg që mund t’ia thuash dikujt, për dikë tjetër. Me anë të përshtypjes,

ndjen se duhet t'i thuash dikujt diçka. Nuk është diçka që e kishe menduar, por të erdhi në sekondë dhe është diçka për ta motivuar, inkurajuar, dashur, nxitur dikë. Ose për të bërë diçka në moment, për të ndihmuar dikë. Një herë po pija kafe me dikë që po kalonte një sfidë dhe i thashë: Do të lutem që Zoti të sigurojë për atë që të duhet. Por ndjeva brenda vetes: Mos u lut, bëj diçka, ti e ke atë që i duhet atij. E dëgjova zërin e Frymës dhe u bëra unë përgjigja e lutjes duke e ndihmuar.

5. Ai është Perëndi. Fryma e Shenjtë gjithmonë përlëvdon Jezusin dhe përcjell atë që do të thotë Ai: Ai do të më përlëvdojë, sepse do të marrë prej Meje dhe do t'jua kumtojë.⁷ Duket sikur kjo është një nga gjërat që Fryma e Shenjtë bën: përlëvdon, përmend, kujton dhe tregon gjërat që ka bërë Jezusi dhe pushtetin që ka Ai tani. Por s'duhet harruar se Ai është pjesë e Trinisë: Ai është Perëndia Frymë e Shenjtë. Kudo nëpër Bibël e gjen Trininë, Ati, Biri, Fryma, tre në një. I gjen të tre duke i bërë gjërat bashkë që nga krijimi. Fryma e Shenjtë nuk është thjesht ajo gjëja që të shtyn, ose thjesht fuqi; Ai është Perëndi, një nga të tre në Trini. Dhe kur bën diçka ndaj Frymës së Shenjtë ia ke bërë Jezusit, ia ke bërë Atit Perëndi. Një herë, te Veprat e Apostujve, kapitulli 5, një çift gënjeu për një veprim të tyre dhe Pjetri i tha: Anania, pse Satani ta mbushi zemrën që të gënjesh Frymën e Shenjtë... ti nuk ke gënjyer njerëzit, por Perëndinë!⁸ Janë bashkë, nuk janë të ndarë; nëse ke gënjyer Frymën e Shenjtë, është njëlloj sikur të gënjesh Atin dhe Birin.

Ai na lidh me Atin dhe Birin. Fryma e Shenjtë do që të na ndihmojë të mendojmë siç mendon Perëndia, të ndiejmë siç ndjen Ai dhe të dëshirojmë gjërat që do Ai. Kur mbaron festimi i ICF Tirana nëse e ke vënë re, për ty që je pjesë ose kur të na

vish për vizitë, do ta dëgjosh shpesh të njëjtën shprehje, sepse mbyllet me një pyetje të tillë: Çfarë po të thotë Fryma e Shenjtë ty sot? Dua t'i fokusoj pyetjet me këtë gjë në mendje.

Për T'u Menduar

- Nëse ke zgjedhur t'i besosh Jezusit tashmë, Fryma e Shenjtë banon në ty. Prandaj jam shumë kurioz, çfarë po të thotë Ai sot?
- A ke dëgjuar më parë për Frymën e Shenjtë __ Po __ Jo
- Cila nga këto të katërta ishte totalisht e panjohur për ty? Cilën e dije tashmë?
- A dëshiron që të varesh, të qëndrosh i lidhur ngushtë me Frymën e Shenjtë çdo ditë, që të jetosh jetën e plotë që ka premtuar Jezusi? _____

Vazhdon tek dita tjetër: A e di se në Dhjatën e Re togfjalëshi 'njëri-tjetrin' përmendet 59 herë. Ta duam, inkurajojmë, ndihmojmë, falim, nderojmë, çmojmë, pranojmë, ndërtojmë, shërbejmë, mbajmë barrët e njeri tjetrit...

**“Perëndia
zakonisht vepron
me anë të njerëzve
më shumë sesa me
anë të mrekullive
sepse Ai do që
të varemi dhe të
lidhemi sa më fort
me njëri-tjetrin.”**

– RICK WARREN

DITA 11

KU DO TË ULEMI?

Nevoja për komunitetin e duhur, kisha.

Ku do të ulemi? Kjo është një nga shprehjet më të përdorura në Shqipëri. Ku do të ulemi për kafe? Sepse jemi komunitet që kalojmë shumë kohë me njëri-tjetrin. Në shumicën e rasteve, sapo mbaron shkolla ose puna, pijmë kafe me shoqërinë njëherë dhe pastaj shkojmë në shtëpi. Kjo është shumë e veçantë dhe kaq e nevojshme; të rrish me njerëzit e duhur, të kalosh kohë me njerëzit e duhur, të ndash gëzimet dhe sfidat me ta.

Në komunitetin e krishterë shihen si familje e madhe të gjithë personat që kanë zgjedhur Krishtin; në atë moment ti bëhesh bir/bijë i/e Perëndisë. Ja si thuhet: ...duke na paracaktuar për birësim për veten e Tij me anë të Jezus Krishtit, sipas pëlqimit të vullnetit të Vet.¹

E gjithë Bibla tregon se Perëndia ka qenë dhe është duke ndërtuar një familje që nuk do të ekzistojë vetëm këtu mbi këtë tokë, por do të jetë e përjetshme, sepse jemi krijuar për të qenë të përjetshëm. Dhe na nxit për këtë gjë: ...duajeni vëllazërinë!² Ose e thënë ndryshe: Duajeni familjen tuaj

frymërore! Perëndia kërkon nga ne që të mësojmë ta duam njëri-tjetrin, të mësojmë si të jemi pjesë e kësaj familjeje. Ai që do Perëndinë, të dojë edhe vëllanë e tij.³

Si bëhet kjo? Bibla na jep udhëzime të qarta si kristali: Po t'i shkruaj këto gjëra që ... të dish sesi duhet të sillesh në familjen e Perëndisë, që është kisha e Perëndisë së gjallë.⁴ Janë fjalët

‘familje’ dhe ‘kishë’. I bie që kisha në të vërtetë është familje. Nuk është ndërtesë, as fondacion as organizatë; është familje të cilës i përket. Le të shohim katër nivele të bashkësisë ose vëllazërisë në familjen e Perëndisë.

1. Niveli i parë i bashkësisë, vëllazërisë: Anëtarësia. Pra, fillimisht ti vendos të bëhesh anëtar, pjesëtar i familjes së Perëndisë! Ju pra, nuk jeni më të huaj, as bujtës, por bashkëqytetarë të shenjtoreve dhe pjesëtarë të familjes së Perëndisë.⁵ Jeni pjesëtarë të një familjeje. Jeta e krishterë nuk është vetëm besim, por edhe përkatësi. Jeta e krishterë mund të jetohet e plotë kur je brenda familjes së Perëndisë, jo më vete.

Është njësoj sikur një futbollist të thotë: Unë jam futbollist dhe e kam shumë qejf futbollin, por nuk kam qejf të jem pjesë e ndonjë skuadre futbolli.

Një i krishterë që nuk është pjesë e një kishë është si i pastrehë, si jetim, pa familje, sepse qëllimi i Perëndisë është të jesh pjesë e një familje. Kështu edhe ne, megjithëse jemi shumë, jemi një trup në Krishtin dhe të gjithë jemi gjymtyrë të njëri-tjetrit.⁶

Jezusi e quan Kishën, trupin e Tij. Imagjino t’i thuash një vajze: Të kam fiksuar ... por trupin s’e paske gjë! Me shumë mundësi do të hash ndonjë syve. Jezusi e do kishën. Bibla na thotë se Kisha është nusja e Krishtit. Imagjinoni dikë që thotë: Jezus, Ti je shumë i mirë, por nusen Tënde nuk e shoh dot me sy! Cilin prej të martuarve do t’i pëlqente kjo?

Në fakt ekziston një simbol i përkatësisë së një personi në familjen e Perëndisë. Është pagëzimi. Pagëzimi është simboli që tregon se një person i përket familjes së Perëndisë. Është mënyra

publike për të shpallur: Unë besoj te Jezu Krishti si Zot dhe Shpëtimtar; s'kam turp që jam pjesë e familjes, komunitetit të krishterë, madje jam shumë i gëzuar për këtë gjë. Ashtu si unaza është simbol përkushtimi ndaj bashkëshortit ose bashkëshortes, ashtu edhe pagëzimi është një simbol i qartë i përkushtimit ndaj Jezus Krishtit dhe familjes së Tij.

Pra, niveli i parë i përkushtimi tënd është zgjedhja për të qenë pjesë e një familjeje besimi.

2. Niveli i dytë i bashkësisë: Të mësojmë të ndajmë. Por të gjithë ata që besonin rrinin bashkë dhe ndanin çdo gjë me njëri-tjetrin.⁷

Dy gjëra: rrinin bashkë dhe ndanin çdo gjë. Dy theksime të rëndësishme! Nuk mund të forcohet miqësia pa ndenjur bashkë dhe pa ndarë gjërat me dikë tjetër. Kush ka fëmijë e di se një nga gjërat e para që i mësojmë fëmijës është t'i ndajë gjërat me fëmijët e tjerë. Pikërisht këtë gjë kërkon edhe Perëndia nga ne: Të mësojmë të ndajmë gjërat me të tjerët. E mësuam kur ishim të vegjël; të mos harrojmë ta praktikojmë kur të rritemi. Por çfarë duhet të ndajmë? Tri gjëra:

a. Ndajmë përvojat tona. Hekuri mpreh hekurin, kështu njeriu mpreh fytyrën e shokut të tij.⁸ Tani, ne mësojmë nga gabimet dhe përvojat tona, por është shumë më mirë nëse mësojmë nga përvojat dhe gabimet e të tjerëve. Jeta është e shkurtër për të mësuar çdo gjë nga gabimet tona. Si është fjala e urtë shqiptare: Kush mësoi pa pësuar?! Le ta ndryshojmë këtë fjalë të urtë: Të mësojmë nga njëri-tjetri pa pësuar, sepse i kursejmë vetes ca dhimbje koke të panevojshme.

b. Ndajmë shtëpitë tona. Jini mikpritës njëri për tjetrin...⁹

Hapim shtëpitë për njëri-tjetrin. Diçka shumë interesante: A e dini se gjatë 300 viteve të para të historisë së kishës nuk ka patur godina? Të gjitha grumbullimet e kishës bëheshin nëpër shtëpi; në shumë pak raste takoheshin në një vend të veçantë që nuk ishte shtëpia e dikujt. Deri në vitin 300 nuk kishte ndërtesa kishash. T'ju them dhe një fakt tjetër? Ajo ka qenë periudha me rritjen më të shpejtë në historinë e kishës.

Prandaj është kaq e rëndësishme që të mbliidhemi së bashku në grupet e vogla, mundësisht në shtëpitë tona, por edhe në kafene. Dhe të nxis: nëse do të jesh pjesë e ngushtë e kishës ungjillore ICF Tirana, fillo një grup të vogël, drejto një grup të vogël tek shtëpia jote ose ji pjesë e një grupi të vogël. Sepse bashkësia, vëllazëria e vërtetë kështu është: ndajmë shtëpitë bashkë, ndajmë jetët bashkë. Cila është jetra?

c. Ndajmë hallet dhe gëzimet. Mbani barrët e njëri-tjetrit dhe kështu do të përmbushni ligjin e Krishtit.¹⁰ Dikush ka thënë: Kur ndan gëzimin me dikë, dyfishohet. Kur ndan dhimbjen me dikë, përgjysmohet. Bibla e thotë kështu: Gëzohuni me ata që gëzohen, dhe qani me ata që qajnë.¹¹ Në fakt, kjo është ajo që duhet të ndodhë në grupet e vogla. Do të ketë raste kur do të qeshim, do të ketë raste kur do mbajmë barrët e njëri-tjetrit bashkë, varet çfarë po kalon secili prej nesh. Familja për këtë është: të festojmë bashkë dhe t'i qëndrojmë njërit-tjetrit afër kur është nevoja.

3. Niveli i tretë i bashkësisë: Bashkëpunimi. Marrëdhënie:

kjo fjalë i ka të dyja veprimet – 'marr': kisha është për të marrë; 'dhënie': kisha është për të dhënë kontributin tënd. Perëndia

dëshiron që të bëjë gjëra nëpërmjet jetës tënde, të veprojë nëpërmjet teje në jetët e të tjerëve.

Si në çdo familje, ka përfitime, por ka dhe përgjegjësi që duhen ndarë mes anëtarëve të saj. Secili ka pjesën e tij. A e di se në Dhjatën e Re përmendet 59 herë togfjalëshi njëri-tjetrin? T'i shërbejmë njëri-tjetrit. Ta duam njëri-tjetrin. Të lutemi për njëri-tjetrin, e kështu me rradhë. Ja si e thotë Bibla: Ne, pra, jemi bashkëpunëtorë të Perëndisë...¹² Kur marrim pjesë bashkë, ne bashkëpunojmë me njëri-tjetrin në familjen e Perëndisë, jemi pjesë e planit të Perëndisë për këtë qytet. Por për të qenë pjesë, duhet të gjesh vendin tënd. Bibla na thotë se secili nga ne ka vendin e tij. Prej të cilit gjithë trupi, i lidhur mirë dhe i bashkuar, me anë të kontributit që jep çdo gjymtyrë dhe sipas forcës së çdo pjese të veçantë, shkakton rritjen e trupit, për ndërtimin e vetes së tij në dashuri.¹³ Ne bashkë jemi pjesë e trupit të Krishtit. Duke bërë diçka së bashku, do të mund të realizojmë planin e Tij për këtë vend. Duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin do të arrijmë shumë më tepër sesa mund të arrijë secili prej nesh i vetëm.

Nënë Tereza e kaloi gjithë jetën e saj duke u shërbyer njerëzve të varfër në Kalkutë, Indi. E pyetën njëherë: Si arrin të përballosh gjithë këto sëmundje dhe vdekje ditë pas dite? Përgjigjja e saj ishte: Në fytyrën e çdo personi që prek, ushqej, mjekoj apo fashoj, imagjinoj fytyrën e Jezusit dhe është sikur po e bëj për Të. Ky është sekreti, kjo i jepte fuqi asaj, siç tha Jezusi vetë: Sa herë ia keni bërë këtë ndonjërit prej këtyre vëllezërve të Mi më të vegjël, këtë ma bëtë Mua.¹⁴ Kur secili bën diçka, ajo që bëjmë bashkë sjell pastaj atë që do Perëndia në këtë qytet.

4. Niveli i katërt i bashkësisë: Familja. T'i duash besimtarët si anëtarë të familjes. Të jesh totalisht i përkushtuar ndaj tyre. Bibla thotë: Duani njëri-tjetrin me dashuri vëllazërore...¹⁵ Fjala origjinale në greqishten e vjetër për bashkësinë është 'koinonia'. Kuptimi i saj është 'të përkushtohemi ndaj njëri-tjetrit ashtu siç jemi përkushtuar ndaj Krishtit. Ky është niveli më i thellë i bashkësisë me njëri-tjetrin. Të kesh një lidhje të tillë, si marrëdhënia familjare. Nga kjo e kemi njohur dashurinë: Ai e dha jetën e Vet për ne; dhe ne duhet ta japim jetën tonë për vëllezërit.¹⁶ Ky është niveli më i thellë i bashkësisë: sakrifica për njëri-tjetrin. Këtë lloj dashurie tregoi Jezusi për ty kur vdiq në kryq.

Ky është thelbi i jetës sonë: të duam Perëndinë dhe të mësojmë të duam njëri-tjetrin. Nëse na shpëton nga duart kjo gjë, na ikën nga duart qëllimi i jetës sonë. Prej kësaj do t'ju njohin të gjithë që jeni dishepujt e Mi, nëse keni dashuri për njëri-tjetrin.¹⁷ Prej kësaj do na njohë gjithë Tirona, gjithë Shqipëria dhe shqiptaria, gjithë bota, nëse e kemi xhan njëri-tjetrin, nëse e duam shumë njëri-tjetrin. Kjo është shenja dalluese. Fare pak kohë pasi Jezusi tha këtë gjë, të krishterët e parë në Romë filluan të persekutohen dhe madje i hodhën para luanëve në Koloseun e famshëm. Në këtë periudhë një nga historianët e asaj kohe shkruante për të krishterët: I shoh dhe më bën shumë përshtypje sesa shumë e duan njëri-tjetrin këta të krishterët. Po sikur të njihemi në Tiranë, në Shqipëri dhe në shqiptari, për dashurinë që kemi për njëri-tjetrin? Sepse njerëzit janë duke kërkuar për një familje të tillë, janë duke kërkuar këtë lloj dashurie të singërtë që vjen nga lart, nga Ati Perëndi!

Për T'u Menduar

- Në një javë normale, sa ditë nuk shkon në shtëpi direkt nga puna, shkolla pa pirë një kafe me një shok/shoqe?
- A e dije se Bibla ka 59 urdhërime me ‘njëri tjetrin’? Çfarë mendove kur e pe këtë gjë?
- Cila nga ato të katërta ishte e re për ty? Cilën do të fillosh ta praktikosh që sot?
- Cila ishte më e vështira?
- A je pjesë e një kishe lokale? Nëse jo, a ke dëshirë ta vizitosh kishën ICF Tirana këtë të diel?

Për të krijuar një ide kush jemi, shiko njëherë disa foto te Instagrami i ICF-së:



Vazhdon tek dita tjetër: Jezusi i bëri një përmbledhje gjithë

Biblës. Duaje Zotin, Perëndinë... Ky është urdhërimi i parë dhe më i madhi.¹⁸

**“Masa matëse se
sa duhet ta duam
Perëndinë është kur
e duam Atë
pa masë.”**

**– BERNARD CLAIRVAUX
(SHEK.11)**

DITA 12

DUAJE PERËNDINË

Dhe dua je me gjithë shpirt, forcë, mendje, zemër.

Ndërsa mbyllet pjesa e dytë, gastronomia, ushqimi, në fund kemi ëmbëlsirën; si ta dua dhe ta adhuroj Perëndinë, si t'i jap kënaqësi Atij? Shpesh flasim sesa na do Perëndia ne; le të shikojmë si ta duam ne Atë: Ti (Perëndi) i krijove të gjitha gjërat dhe nëpërmjet vullnetit Tënd (për kënaqësinë Tënde) ekzistojnë dhe u krijuan. ¹

Sa bukur e thotë vargu: ne u krijuam dhe ekzistojmë për vullnetin e Tij, për t'i sjell kënaqësi Perëndisë. Perëndia të krijoi për kënaqësinë e Tij. Kur ti linde, kur dole nga barku i nënës sate, Perëndia ishte aty, në dhomën e maternitetit, duke buzëqeshur, sepse erdhe ti në jetë, krijimi i Tij. Ai të solli në jetë për një arsye, me një plan, një qëllim, një shkak.

Një ditë kur Jezusi po ecte rrugës, një djalë e pyeti, Zot, cili është urdhërimi më i madh në gjithë Biblën? Jezusi i bëri një përmbledhje të gjithë Biblës. Dua je Zotin, Perëndinë... Ky është urdhërimi i parë dhe më i madhi. ² Perëndia thotë: “Unë të njoh dhe të dua. Tani pres që ti të më njohësh dhe të më duash

Mua.” Kjo përmblihet me një fjalë: ‘adhurim’, që do të thotë ‘ta njoh dhe ta dua Perëndinë’.

1. Adhurim është reagimi im ndaj dashurisë së Perëndisë. Së pari, Ai pati dashuri, dhembshuri ndaj meje; pastaj pritet që edhe unë ta dua. Perëndia e mori iniciativën i pari. Gjithmonë Ai e merr iniciativën i pari; Ai e bëri lëvizjen e parë kur të krijoi ty, pastaj kur të shpëtoi, kur të dha faljen, kur të bekoi, kur të mbron. Dhe për

shkak të gjithë këtyre gjërave që Ai ka bërë dhe bën, Ai pret që ti ta adhuroj. A e do Ai këtë gjë sepse nuk e ka?

Çfarë nuk ka Perëndia? Ai krijoi botën, të krijoi ty. Ai bëri qiejt dhe galaktikat; çfarë mund t'i japësh një Perëndie të tillë që ka gjithçka? Jepi dashurinë tënde; Ai nuk e ka nëse nuk ia jep. Si t'ia japim? Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë mendjen tënde e me gjithë forcën tënde!³ Quhet ndryshe 'Urdhërimi i parë dhe më i madhi'.

Perëndia do që ta duam në tre mënyra: Me mendjen tonë: do të thotë, ta dish me bindje të plotë në kokën tënde se e do Atë. Ta duam me pasion: me gjithë zemër, me gjithë shpirt. "Më duaj me pasion, - thotë Perëndia, - sepse edhe Unë të dua ty me pasion." Ta duam praktikisht: me gjithë forcën tonë, me të gjitha aftësitë tona. Perëndia na i ka dhënë këto: mendjen, shpirtin, zemrën, forcën. Adhurim ndodh kur ne i marrim këto gjëra që na i ka dhënë Perëndia dhe ia kthejmë, ia japim përsëri Atij. 2. Adhurim është ta përqendroj vëmendjen te Perëndia.

Ta përqendrosh mendjen, vëmendjen, logjikën te Perëndia, sepse Ai do që ta adhurosh me mendjen tënde. Perëndia do vëmendjen tënde sepse Ai e ka vëmendjen te ti. Ti më ke hetuar, o Zot, dhe më njeh. Ti e di kur ulem dhe kur ngrihem, Ti e kupton nga larg mendimin tim. Ti e shqyrton me kujdes ecjen time dhe pushimin tim (çdo gjë) dhe i njeh thellë të gjitha rrugët e mia.⁴ Ai shikon me kujdes çdo gjë që bëj dhe kudo që shkoj. Perëndia është i fokusuar tek ti gjithë kohën, nuk t'i ndan sytë asnjë sekondë. E di pse? Sepse Ai të do. Ai të krijoi që të të japë kaq shumë vëmendje.

Por për ne disa herë është e vështirë. Për ne është më e lehtë ta largojmë vëmendjen nga diçka sesa të qëndrojmë të fokusuar. Nuk jemi si kamerat e smartfonëve të fundit, që kur i drejton te një

objekt, fokusohen vetë automatikisht. Ne na duhet ta zgjedhim vetë manualisht, a do të rrimë ose jo të fokusuar te diçka ose te dikush. Po si ta bëjmë këtë gjë? Së pari, duke vendosur që do të kalosh kohë me Perëndinë çdo ditë. Çdo ditë, 15 minuta ose më shumë. Nuk ka rëndësi kur e kalon këtë kohë duke lexuar Biblën dhe duke u lutur. Mund të jetë në mëngjes, drekë, pasdite, darkë. Është një kohë, që ti e zgjedh qëllimisht, për ta ndalur vrullin e ditës ose trafikun në kokën tënde të 100 gjërave që të vijnë në mendje të lexosh Biblën dhe të bisedosh me Perëndinë. Ti e zgjedh vetë, qëllimisht të ndalosh dhe të përqendrohesh te Perëndia.

Sa më shumë dhe sa më shpesh fokusohesh te Perëndia, aq më shumë do të përfitojë jeta jote. Mendjes që pushon te Ti, Ti i ruan një paqe të përsosur, sepse kjo ka besim te Ti (është e fokusuar tek Ti). ⁵ Kur e fokuson vëmendjen te vetja, do të fillosh të shqetësohesh, të kesh pasiguri, ankth, faj, frikë, zhgënjim. Por kur fokusohesh te Perëndia, fillon të kesh më shumë mirënjohje, shpresë, qetësi, vetëbesim dhe dashuri. Adhurim është, kur e nis ditën duke e fokusuar vëmendjen te Perëndia.

3. Adhurim është kur unë ia shpreh pëlqimin tim Perëndisë. Kjo ndodh kur ti e do Perëndinë me gjithë zemër dhe me gjithë shpirt. Ndoshta për disa kjo mund të jetë e vështirë sepse mund të jesh rritur në një familje ku nuk thuheshin shumë fjalë afruese. S'të kanë shprehur pëlqimin që kishin ndaj teje; as ti tani nuk e ke këtë zakon, s'di të thuash fjalë të tilla. Por filloje dhe mësohu gradualisht me këtë gjë, për ta shprehur pëlqimin, dashurinë tënde ndaj Perëndisë. Kur i ke thënë për herë të parë “të dua” një personi? Ka mundësi që je frikësuar për vdekje. Unë kisha aq emocione t'ia thoja asaj gocës që e doja, sa që ia shkrova në një letër dhe ika. Pastaj kisha turp kur do e takoja të nesërmen. Kur ka qenë për ty hera e parë që i ke thënë dikujt të dua? Si ndiheshe, a ishe nervoz, a të përzihej, të djersitnin

duart, të ishte bërë stomaku sa një dardhë? A e di pse ndodh gjithë kjo furtunë emocionale? Sepse nuk e di si do të reagojë ajo/ai. Do ta pranojë dashurinë tënde apo do të marrë për keq muhabeti? Por e bukura është se Perëndia e ka hequr tensionin, Ai ta ka thënë i pari që të do. Perëndia e ka shprehur dashurinë e Tij ndaj teje në shuumë mënyra, kështu që nuk ke pse të sikletosesh. Thuaja: Perëndi, edhe unë të dua! Ne e duam Atë, sepse Ai na deshi i pari. ⁶ A i ke thënë: “Perëndi, edhe Unë Të Dua?” Perëndia do që ta dëgjojë nga ti; nëse nuk e ke bërë, thuaja tani: Perëndi, Edhe Unë Të Dua. Perëndia nuk e do dashurinë tënde si punë për t’u bërë. Ai do miqësi, marrëdhënie pasionante me ty. Ai thotë: Unë dëshiroj që të më duash aq shumë sa ç’të dua Unë ty, sepse Unë të kam krijuar, Unë të kam bërë. Filloje duke thënë ‘faleminderit’; falenderoje për gjërat që ke. Faleminderit, o Zot, për këtë ditë, për këtë diell, për familjen, për punën, shkollën, lidhjen, për të fejuarën, gruan, burrin, kalamajtë, për shtëpinë, për këtë e atë. Gjej gjëra rreth e qark teje për t’i thënë ‘faleminderit’ Perëndisë. Ky është fillim i lehtë për të shprehur mirënjohje dhe dashuri ndaj Krijuesit, Perëndisë tënd.


Nëse çdo njeri do ta kuptonte sesa shumë e do Perëndia dhe sesa shumë kujdeset Ai për çdo detaj të jetës së tij/saj, s’do të pushonte një sekondë së falenderuari. Adhurim është kur e shpreh me fjalë dashurinë që ke ndaj Perëndisë; ne e duam Atë sepse Ai na deshi i pari. 4. Adhurim është kur përdor aftësitë e mia për Perëndinë. Kjo është ta duash Perëndinë me gjithë forcën tënde. Kur martohesh e kupton që dashuria nuk është vetëm fjalë të bukura, kupton që dashuria ka dhe anë praktike. Ka ca punë shtëpie që duhen bërë. Ka ca gjëra që duhen rregulluar në shtëpi. Ka ca blerje për t’u bërë. Ka ca përgjegjësi që s’u bën dot bisht, ka fëmijë që duan përkujdesje. Çiftet e martuara e tregojnë dashurinë edhe duke ndihmuar me gjëra praktike që duhen bërë për familjen. Kush mund t’ia hedhë gruas

vetëm me fjalë të bukura kur ka shumë gjëra për t'u bërë? Nëse burri thotë: Të dua shumë zemër, por nuk bëj dot asnjë punë, nuk laj dot asnjë enë, nuk hedh dot qesen e mbeturinave, nuk i marr dot kalamajtë nga kopshti, lodhem të shkoj te marketi. A po shkon edhe në punë vetëm ti dhe unë të rri në shtëpi? Çfarë do të thotë gruaja? Lëri llafet e bukura dhe ma trego me vepra sa më do. E njëjta gjë vlen edhe për adhurimin. Ne adhurojmë kur bëjmë gjëra praktike në emër të Perëndisë. Çdo gjë që të bëni, ta bëni me dëshirë të mirë, si për Zotin dhe jo për njerëzit. ⁷ Nëse do të zbatonim vetëm këtë varg siç thotë, do të ndodhnin gjëra të papame kudo. Çdo gjë që bën, bëje si për Zotin dhe jo për njerëzit. Ky është adhurimi nga ana praktike: çdo gjë bëje për lavdinë e Perëndisë, sikur ke Perëndinë që të shikon dhe po e bën për Të. Kjo është ta ftosh Perëndinë në çdo zonë të jetës sate. Në jetë nuk ka rëndësi çfarë pune bën, por për kë po e bën! Bëje çdo gjë si për Perëndinë. Dhe me këtë lloj qëndrimi, puna jote, çdo gjë që ti bën kthehet në adhurim. Ky lloj qëndrimi do t'i kthejë edhe situatat më të rëndomta në një kuptim të ri, si adhurim ndaj Perëndisë. Dhe gradualisht, e gjithë jeta jote kthehet në një stil jete në adhurim për Perëndinë. Çdo njeri adhuron diçka. Ti je formuar për të adhuruar Perëndinë. Ai e ka vënë këtë dëshirë brenda teje. Ti nuk rri dot pa adhuruar diçka ose dikë. Nëse njeriu nuk po adhuron Perëndinë, më beso, do e zëvendësojë me dikë ose diçka tjetër shumë shpejt. Po ti, kë po adhuron? A e di si kuptohet? Është ajo gjëja që po i jep më shumë vëmendje, më shumë pëlqim dhe pas të cilës po punon më shumë. Tundimi më i madh në jetë do të jetë gjithmonë nxitja për të adhuruar diçka tjetër, përveç Perëndisë. Ti je krijuar për kënaqësinë e Perëndisë, u bërë për ta njohur dhe për ta dashur Atë, kështu që të nxis ta vësh Atë Nr.1 të jetës sate, para çdo gjëje tjetër. Prandaj përpiqemi t'i pëlqejmë Atij... ⁸ Nuk ka qëllim më të mirë dhe më të lartë sesa ky: t'i pëlqesh, t'i sjellësh kënaqësi Perëndisë.

Për T'u Menduar

- Çfarë moshe ke qenë kur ke dashuruar për herë të parë? Si ia shprehe dashurinë?
- A të vjen natyrshëm t'ia shprehësh dashurinë Perëndisë dhe t'i thuash 'të dua', 'faleminderit', 'Ti je Ky dhe Ky për mua'?
- Cila nga këto të katërta ishte e re për ty? Cila ishte më e vështira?
- A do të fillosh që sot ta praktikosh adhurimin, t'i sjellësh kënaqësi Perëndisë?

Vazhdon tek dita tjetër: Fjala 'kulturë' në origjinë është fjalë latine dhe ka kuptimin 'të kujdesesh për tokën, ta kultivosh'. Sot nënkuptohet më gjerë: të kujdesesh dhe të kultivosh më shumë elemente.



**“Kultura e ha
për mëngjes
strategjinë.”**

– PETER DRUCKER

Pjesa 3

Kultura, Çfarë Vlerëson Ajo?

Çdo komb, çdo komunitet, çdo familje, çdo person ka kulturën e vet: ka disa gjëra specifike që i vlerëson më shumë, ka mënyrën e vet sesi i bën gjërat. Gjërat që zgjedh si më të rëndësishme për t'i praktikuar dhe të tjera për të mos u dhënë shumë rëndësi. Me origjinë është fjalë latine; në fakt ka edhe kuptimin të kujdesesh për tokën, ta kultivosh. Sot nënkuptohet më gjerë, të kujdesesh dhe të kultivosh disa elementë të veçantë.

Kultura shqiptare ka një miks elementësh: Gjuha (dhe është një nga më të vjetrat në botë), ana artistike (në kohët e lashta shprehej me enët prej balte, gdhendjet...), gatimet (ngjan me kuzhinën mesdhetare që ka shumë perime, fruta, mish, peshk dhe vaj ulliri), letrare (edhe pse është gjuhë e shkruar vonë, ka patur krijimet e veta), muzikore (duket sikur çdo krahinë ka këngët dhe instrumentet e veta), politike (sot jemi republikë parlamentare me peshën më të madhe të drejtimit të kryeministri) dhe sociale (që përfshin të jetuarit, veshjen, besimin) që ishte pagan në fillim, pastaj në shek. I erdhi krishtërimi, por ndryshoi sërish pas shek. XV nga pushtimi osman dhe sot jemi një nga vendet me lirinë dhe tolerancën më të lartë fetare.

Pushtimet e njëpasnjëshme dhe globalizimi kanë sjellë njëfarë zbehjeje të kulturës tipike shqiptare.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për komunitetin e krishterë. Edhe ai ka një set vlerash, një lloj kulture unike sesi i bën gjërat sesi jeton secili prej të krishterëve. Meqë njerëzit janë të ndryshëm, mendojnë ndryshe, jetojnë ndryshe. Në fakt, edhe të krishterët, ngaqë janë

njerëz, mendojnë ndryshe dhe sillen ndryshe duke vlerësuar disa gjëra dhe duke mos u dhënë aq rëndësi disa të tjerave. Por, së pari, të gjithë kemi Krishtin në qendër të jetës sonë.

Komuniteti i krishterë që mban logon e ICF-së ka një ADN, një set vlerash ndryshe, një lloj kulture unike që pasqyrohet me gjashtë vlera. Këto vlera dua t'i shpjegoj duke i lidhur me historinë e Mbretëreshës së Shebës. Kur ajo dëgjoi për tempullin që kishte ndërtuar mbreti Solomon në Izrael, që ishte tempulli i Perëndisë, ajo u mahnit; ajo donte të shkonte vetë, donte të dinte çfarë vlerash, çfarë kulture, çfarë ADN-je kishin ata që e kishin bërë çdo gjë kaq të veçantë.

Ajo mori rrugën, shkoi vetë dhe e pa me nge çdo gjë te tempulli i Perëndisë, shtëpinë e Solomonit dhe çdo gjë që bënin ata dhe si i bënin gjërat; kjo histori gjendet te libri i parë i Mbretërve, kapitulli 10.

Le të shikojmë gjërat që dalloj ajo ndryshe dhe si mund t'i marrim këto vlera dhe t'i zbatojmë ne vetë në jetën e përditshme, si mund t'i praktikojmë të gjithë si komunitet.

Janë gjashtë vlera specifike; le t'i shikojmë njëra pas tjetrës.

**“... dhe gjithë
merakun tuaj
hidheni mbi Të,
sepse Ai
merakoset për ju.”**

**– LETRA E PARË
E PJETRIT 5:7**

DITA 13

TË VËRTETË

Jemi Siç Them.

Njerëzit duan të dëgjojnë, të shohin dhe të dallojnë vërtetësinë tënde përpara se të besojnë atë që ke për të thënë. Ja çfarë përjetimi pati Mbretëresha e Shebës kur takoi mbretin Solomon: Kur mbretëresha e Shebës dëgjoi të flitet për diturinë e Salomonit për shkak të emrit të Zotit, erdhi ta vërë në provë me anë pyetjesh të vështira. ¹ Ajo erdhi nga ana e anës – mendohet se ishte nga Etiopia – dhe udhëtoi mbi katër mijë kilometra për të takuar mbretin Solomon që jetonte në Jeruzalem. Dhe gjithë ajo rrugë e gjatë ishte për të testuar, për të vënë në provë, a ishin të vërteta gjërat që ajo kishte dëgjuar në lidhje me të?

E njëjta gjë vlen për çdo person që pohon se është ndjekës i Krishtit, e njëjta gjë për çdo komunitet të krishterë. Njerëzit duan të dinë sa i vërtetë je ti, sa e vërtetë është kjo që ti beson?

Kur dikush vjen në festimet e ICF-së, është pjesë e një grupi të vogël gjatë javës që përbëhet nga disa ndjekës të Krishtit ose në një ngjarje ose festë diku, pyetja e parë që i vjen në mendje shumicës është: “Sa i besueshëm është ky person? Ajo që po dëgjoj, gjërat që po thonë ose besojnë këta njerëz, sa të vërteta janë? Apo edhe këta janë si shumica e atyre që njoh: bëj si them unë por mos bëj si bëj unë? Madje ka njerëz që mendojnë se në përgjithësi njerëzit që shkojnë në kishë janë hipokritë, nuk janë të sinqertë, nuk janë të vërtetë.

Jezusi ishte i ashpër me fetarët e kohës së Tij dhe u thoshte atyre: Ju jeni hipokritë. ² Fjala ‘hipokrit’ ka kuptimin ‘ti po e zmadhon veten, po thua më shumë gjëra se ç’janë ose ç’je në të vërtetë në jetën e përditshme’.

Tani, le të mos e ngatërrojmë të jesh i vërtetë me të jesh i përsosur. Ne besojmë se Perëndia është i përsosur. Por të gjithë e dinë se ti, unë, ata nuk janë të përsosur sepse s'ka asnjë të tillë, por çdo njeri ka nevojë të dijë nëse je i vërtetë dhe sa i sinqertë je. A kalon edhe ti sfida dhe si përballesh me to? A kalon gëzime dhe si i feston ato? Si të ka ndihmuar Perëndia në jetën e përditshme mes sfidash dhe problemesh?

Dhe sigurisht, ne nuk ndalojmë, por rritemi, forcohemi, zhvillohemi me fuqinë dhe favorin që na jep Perëndia sfidë pas sfide, vështirësi pas vështirësie.

E zemë se ti do të vish për një vizitë te kisha ICF Tirana sepse ke dëshirë të takosh komunitetin aty, njerëzit që janë pjesë e asaj kishe. Te dera janë dy persona që po të përshëndesin dhe njëri nga ata është me nerva, të sheh me nerva dhe të flet ftohtë. Kur e pyet, Po pse rri kështu, ai/ajo të përgjigjet, Po kështu jam unë, unë jam vetja kështu, ky jam unë në të vërtetë. Pse çfarë të bëj? Ta mbledh veten, të buzëqesh edhe kur është fallco dhe nuk më vjen për të buzëqeshur dhe ta mbaj brenda atë që ndiej në të vërtetë?

Të hiqem?!

Nxitja për dikë që po shërben, kudo që mund t'i shërbejë dikujt, në shtëpi, në punë, në kishë, kudo: Mëso sesi t'ia lësh shqetësimet e tua Zotit Jezus. Ai mund t'i marrë dhe ta rregullojë situatën, ta qetësojë furtunën dhe ta fuqizojë jetën tënde. Imagjino që ke patur një ditë të vështirë te puna. Lërja shqetësimet Zotit Jezus para se të hysh në shtëpi, përndryshe do t'i shkarkosh te njerëzit e shtëpisë që janë personat më të çmuar dhe do të lëndosh njerëzit më të dashur për ty.

Dikush tha: Po kjo i bie të jem fallco sepse me gjithë mend kam patur një ditë shumë të vështirë. Por nëse ia lë Zotit barrat, ngarkesat, streset e tua, nuk janë më halli yt, i ka marrë Ai dhe në shkëmbim të ka dhënë paqen e Tij, çlodhjen e Tij, fuqinë e Tij. Dhe kështu mund të jesh vetja dhe të jesh gëzimi i shtëpisë dhe shoqërisë që të rrethon.

Një gjë shumë interesante, por edhe shqetësuese: Shqipëria u rendit shumë poshtë në lidhje me sa besim kemi tek njëritjetri; ishte e fundit fare në listë me 2.4% të njerëzve që u besojmë të tjerëve. Ku shkoi besa, mbajtja e fjalës, shqiptari kur jep fjalën ther djalën dhe shumë shprehje të tilla? Anketa u bë nga Komisioni Evropian për të analizuar cilësinë e jetës duke analizuar nga marrëdhëniet me njëritjetrin, nivel pas niveli, puna, institucionet, sistemi ligjor... Përgjigjet e kësaj ankete e bëjnë akoma më të nevojshme që të jemi të vërtetë. Njerëzit që na rrethojnë, së pari dyshojnë shumë për çdo gjë dhe së dyti, e nuhasin kur je fallco.

Si mund ta rritësh besimin tek të tjerët:

1. Ji transparent nga ana profesionale dhe personale. Nuk ke pse të mburresh për një punë që ti nuk e bën dot ose nuk ke pse ta nënvlerësosh veten kur një gjë di ta bësh mirë. Ji vetja; të gjithë po mësojmë, po përmirësohemi, nuk ka asnjë të përsosur në punë. Dhe nga ana personale, kemi merakun se mos duke qenë të singertë, të tjerët do ta abuzojnë singëritetin tonë, kështu që hiqemi dhe themi gjëra dhe përshkrime që s'i kemi. Por sa gjatë mund të shtresh, sa njerëzve mund t'ua hedhësh, dhe a ia vlen? Nga ana tjetër, është transparenca ajo që e rrit besimin. Fryti: ti bëhesh i besueshëm në ato që thua, ato që ndan, ato që ke përjetuar, kur ndan hallet e tua dhe gëzimet e tua. 2. Trego empati. Si mund të thuhet ndryshe fjala 'empati'?

Mendoj që më super e përmbledh ky varg nga Bibla: Gëzoni me ata që gëzohen, qani me ata që qajnë.³ Kur ti përpiqesh të ndiesh atë që po ndien ai person, kur gëzohesh me promovimin që mori, notën e mirë ose letrat që i dolën... bëhesh më i besueshëm. Dhe thuaje, kur e ndien, atë që ndien për atë person: Gëzohem me ty. Festoj edhe unë me ty. A mund të lutem për ty? Si mund të të ndihmoj unë ty...

3. Ji i njëjtë gjithmonë. Bëhesh i besueshëm nëse ke të njëjtin qëndrim gjithmonë. Jo kur ke hall, je shumë i dashur dhe i mirë; sa i vë gjërat në vijë, nuk të sheh më me sy. Oportunistë ka plot, që shfrytëzojnë momentin për të përfituar diçka nga dikush. Por a u beson më njeri atyre? Ji i njëjtë, ki të njëjtën dashuri, kujdes, sinqeritet edhe kur ke nevojë dhe kur s'ke nevojë; ji i njëjtë. Kur je mirë dhe kur je keq. Dhe kjo do të rrisë besueshmërinë sepse njerëzit e kuptojnë që të kanë shok/shoqe për kokë sepse ti je i njëjtë gjithmonë, nuk po u servilosesh, por mund të mbështeten tek ti.

4. Shko kundër rrymës. A e di se shpesh është e vështirë të jesh i vërtetë? Duket sikur duke qenë i vërtetë po shkon kundër rrymës. Por, cila është zgjidhja? Të shkosh bashkë me rrymën? Bashkë me të mund të shkojë edhe një peshk i ngordhur, nuk duhet pikë force të shkosh me rrymën. Nga ana tjetër, të gjithë po kërkojnë për një shok, shoqe, punonjës, koleg, partner jete që të jetë i vërtetë, plot integritet, transparent dhe me dashuri të sinqertë. Numërohen me gishta, por ti e ke mundësinë të jesh ndër ta sepse ke përjetuar dashurinë e Perëndisë dhe të mbetet që thjesht ta reflektosh atë që ke marrë. Dhe do të jesh si magnet; shokët do të duan të rrinë me ty, pronarët do të duan të të marrin në punë, skuadra jote do të dojë që të punojë për ty, ai/ajo do të dojë të lidhë jetën me ty. Dhe duke qenë i tillë, jeta fillon dhe bëhet më e thjeshtë për ty dhe, më e rëndësishmja, emri i Zotit nderohet nga jeta jote! Dua ta mbyll me

dy vargje nga Bibla, por pa u dhënë shpjegim; thjesht lexoji: Dashuria le të mos jetë me hipokrizi, urreni të keqen dhe ngjituni (kapuni) pas së mirës. ⁴ Prandaj, hidhini tej gënjeshttrat dhe çdonjëri t'i thotë të vërtetën të afërmit sepse jemi gjymtyrë të njëri-tjetrit. ⁵

Për T'u Menduar

- Sa u beson ti njerëzve nga 1 deri në 10 _____ ?
- Sa i besueshëm je ti për ta nga 1 deri në 10 _____
- Tek ato të katërtat më lart, cila ishtë më e lehta për ty dhe cila më e vështira?
- Çfarë janë disa përfitime kur ti je i/e vërtetë?

Vazhdon tek dita tjetër: Fokusohe mi të gjejmë zgjidhje të kohës, përgjigje për pyetjet e kohës.

**“Nuk na duhet ta
bëjmë Biblën të
duket relevante,
ajo tashmë është
e tillë. Por ne
duhet të tregojmë
rëndësinë e saj.”**

– RICK WARREN

DITA 14

RELEVANT

Ecim Me Hapin e Kohës.

Relevant ose bashkëkohor është vlera e dytë e kulturës tonë. Fokusohemi të gjejmë zgjidhje të kohës, përgjigje për pyetjet e kohës. Prandaj pyesim veten vazhdimisht si ta përcjellim mesazhin e dashurisë së Perëndisë sa më qartë dhe në mënyrë sa më praktike te njerëzit e këtij brezi.

Ja të shikojmë mbretëreshën e Shebës, çfarë bëri ajo kur ishte në prani të mbretit Solomon. Pastaj shkoi te Solomoni dhe i foli atij për të gjitha gjërat që kishte në zemër. Salomoni iu përgjigj të gjitha pyetjeve të saj dhe nuk pati asgjë që të ishte e fshehtë për mbretin dhe që ky të mos ishte në gjendje ta shpjegonte.¹

Kështu e kuptoj unë fjalën “relevant” në lidhje me besimin: i ke përgjigjet për gjërat që po ndodhin vërdallë dhe sigurisht të bazuara te Fjala e Perëndisë, Bibla, dhe i shpjegon në mënyrë praktike ato, që t’i kuptojë ai që i dëgjon. Asnjëri nuk di çdo gjë; dakord, Solomoni mundej sepse ishte njeriu më i ditur që ka njohur bota e asaj kohe. Por, si ta sjellim, si ta themi, tregojmë, shpërndajmë mesazhin që kemi marrë në mënyrë sa më praktike dhe bashkëkohore?

Deri në shek. XV, Bibla lexohej në latinisht në kishat e asaj kohe. Me shumë gjasa shumica e njerëzve më shumë impresionoheshin – “sa i zgjuar ai, di latinisht” – sesa e kuptonin mesazhin e asaj pjese që u lexohej. “Relevant” do të thotë “ta sjellësh mesazhin e Biblës në kohën tonë, duke patur parasysh se Bibla filloi të shkruhej në shek. XIV para Krishtin dhe mbaroi së shkruari në shek. I pas Krishtit, duke ditur se ne nuk jemi marrësit e saj të parë, meqenëse

u shkrua për dëgjuesit e asaj kohe. Por parimet janë të njëjta dhe ta sjellësh mesazhin e saj të kuptueshëm dhe të qartë për këtë brez është vlerë e madhe, me qëllim që secili ta kuptojë atë në kontekstin ku ndodhet.

Një model më i hershëm në lidhje me relevancën është apostulli Pal. Ai, si misionari i parë, përdori rrugën dhe infrastrukturën e krijuar nga perandoria romake për të përcjellë lajmin e mirë kudo nëpër botën që njihej si botë në atë kohë. Nuk krijoi rrugë të reja ose harxhoi energji për të shpikur rrotën. Jo, përdori gjërat e kohës. Dhe e solli lajmin e mirë deri në Iliri.²

Ja një model tjetër. Martin Luteri, në shek. XVI e përktheu Biblën në gjuhën e asaj kohe për kombin e tij gjerman dhe e printoi që çdo familje ta kishte një Bibël në shtëpi dhe çdo njeri të mund ta kuptonte dhe ta lexonte mesazhin e saj.

Një model për kontekstin tonë është Gjerasim Qiriazhi, mesi i shek. XIX i cili bashkë me motrat e tij dhe patriotët të tjerë bënë revolucion duke promovuar gjuhën shqipe për ta shkruar dhe lexuar atë, madje edhe si gjuhë predikimi. Hapën shkollat shqipe, përkthyen literatura shqip. Madje në vitin 1888 përktheu dhe botoi Ungjillin e Mateut në gjuhën shqipe.

Në të tashmen, Bibla më shumë po lexohet nga telefoni sesa ajo prej letrë. Sepse ka aplikacione, një prej të cilave është YouVersion, nga ku mund ta lexosh Biblën nga telefoni në çdo kohë. Ne si ICF Tirana mendojmë: “Si mund të bëjmë një kishë për ta afruar brezin e ri, dhe jo vetëm ata, tek njohja e dashurisë së Perëndisë, që ta kuptojnë sa më mirë dhe sa më qartë Fjalën e Tij dhe ta jetojnë atë?” Ka dy gjëra të ndryshme që shpesh keqkuptohen nga shumë njerë: Mesazhi dhe Metoda. Këto të dyja janë gjëra të ndryshme dhe nuk janë të njëjta.

Kur themi “relevant”, nënkuptojmë “si të ndryshojmë metodat, si ta sjellim mesazhin në mënyrën sa më bashkëkohore?” Por mesazhi nuk ndryshon kurrë; është i njëjti mesazh: “Perëndia na deshi aq shumë sa dha Birin e Tij, i cili erdhi, vdiq në kryq, pagoi për ne dhe u ringjall të tretën ditë; kush beson në Të është i shpëtuar.” Ky është mesazhi dhe nuk ndryshon asnjëherë. Por ama metodat duhet të ndryshojnë gjithmonë: si ta përcjellim për grupmoshat e ndryshme, si të përdoret multimedia për ta përcjellë atë mesazh në vende të ndryshme?

Një gjë tjetër relevante është përdorimi i medias sociale për të sjellë mesazhin tek çdo person. Le të themi se ti je në udhëtim një të diel dhe nuk ke mundësi të shkosh në kishë, ose ke lëvizur nga Shqipëria dhe nuk ka një kishë afër teje. Thjesht mund të hysh online te social media e ICF Tirana, në Facebook ose Instagram, dhe të dielave në orën 11.00 paradite dhe 6.00 pasdite mund ta ndjekësh nga shtëpia, nga hoteli, nga fshati, qyteti, vendi ku ndodhesh atë të diel. Si të jesh relevant në jetën e përditshme në lidhje me besimin, sepse shumicën e rasteve jemi relevantë për të plotësuar nevojat tona personale apo jo?! Se ja, njerëzit nuk ecin në këmbë më, por përdorin mjetet e kohës për të lëvizur. Nuk kanë më telefona Nokia 3310, edhe pse ishin prej “çeliku,” por kanë smartfonë delikatë. Ose arredimi i shtëpisë, jetesa e përditshme. Duket sikur i pranojmë lehtësisht gjërat e kohës për nevojat personale por si ta përdorim edhe në gjëra të tjera, sidomos për ta forcuar besimin dhe për ta shpërndarë Lajmin e Mirë?

1. Lexoje Biblën nga telefoni yt. Nëse u zgjove vonë dhe nuk kishe kohë ta lexoje Biblën, lexoje nga telefoni rrugës kur je për në punë, për në shkollë, kur je në autobus, makinë, duke pirë kafën e mëngjesit. Bëj një plan leximi me 2-3 persona nga telefoni, vendos

një reminder ose ç'të duash, veç mos e lër pa lexuar atë ditë sepse e ke në dorë telefonin.

2. Ji kurioz. Me shumë gjasa, nuk mund ta kapësh ritmin e çdo gjëje të re që po del. Po kërkoja në google sa aplikacione ka. Android bashkë me Ios kanë mbi 5 milionë aplikacione që mund t'i shkarkojë kushdo. Kjo nuk është shifër për të të frikësuar, por është tregues se risitë nuk kanë të ndalur. Ji kurioz për gjërat e reja dhe ato më të duhurat për të të forcuar ty. 3. Ji efektiv, gjëj mënyra për t'i përdorur në mënyrë sa më efektive. Fillor një grup në Whatsapp, Messenger, Facebook ose në Instagram, ku mund të ndash me disa miq vargun e Biblës që të pëlqeu më shumë atë ditë. Bëji share një videoje, fotoje me mesazh inkurajues një miku/shoku/shoqeje, e shumë e shumë të tjera. Dua të të nxis kështu: përdor 10% të kohës që kalon me telefonin për të bërë diçka të tillë. Është e thjeshtë të kuptosh sesa kohë kalon në ditë në telefon sepse e tregon vetë telefoni për çdo ditë ose javë. Më e pakta, njerëzit rrinë 2-3 orë, më e shumta pastaj shkon 4 orë e lart. Por aq do të sugjeroja: 10% të kohës investoje duke bërë diçka që ka lidhje me besimin; ndaj një link, shkruaji dikujt, posto diçka, lexo Biblën nga YouVersion... .

3. Ji vetvetja. Ka persona që ndajnë vetëm gjëra nga Bibla dhe duket sikur janë super të perëndishëm. Ka njerëz që ndajnë vetëm momente pushimesh; duket sikur e kanë në terezi dhe nuk bëjnë asnjë punë. Ka njerëz që postojnë vetëm foto të vetes ose familjes; duket sikur bota e tyre aq është. Sugjerimi im do të ishte të ndaje pak nga të gjitha. “Besoj te Perëndia dhe ja si më foli Ai sot.” Ndan një varg nga Bibla, një përjetim. “E dua punën, jetën, shkollën.” Ndjaj nga e përditshmja. “Po argëtohem dhe po i shijoj gjërat e vogla dhe të mëdha të jetës” etj. etj... Dhe çfarëdo që thua dhe bën, bëje sa më thjesht dhe sa më praktikisht sepse ashtu do i bëjë punë dhe

atij tjetrit. Nuk është puna të jemi relevantë për të treguar kush jemi, sepse ti e njeh veten, e di kush je dhe s'të duhet aprovimi i të tjerëve. Duke e ditur se urdhërimi i parë është të duam Perëndinë, pastaj njeriun, le të jemi relevantë për t'iu gjendur dikujt afër sa më kollaj, sa më shpejt, në mënyrë sa më praktike. Le të jetë çdo gjë e re për t'ia lehtësuar jetën vetes dhe të tjerëve përreth, përndryshe a ia vlen? Nëse është për të përcjellë dashurinë e Perëndisë tek dikush, atëherë le të jemi sa më relevantë!

Për T'u Menduar

- Çfarë të vjen më lehtë, t'i përdorësh gjërat e kohës për përdorim personal apo për të ndihmuar dikë me to?
- Cila nga këto të katërta ishte më e vështira për t'u bërë?
- Cila ishte më e lehta?
- A mund të bësh diçka sot si provë: t'i përdorësh gjërat e kohës për të ndarë mesazhin e dashurisë së Perëndisë me dikë? Çfarë do të provosh?

Vazhdon tek dita tjetër: Të duam që çdo gjë që bëjmë, themi, mendojmë, të jetë ekselente, të reflektojë Perëndinë të cilit i shërbejmë.



**“Jetesën e arrijmë
me ato që marrim,
por jetën e arrijmë
me ato që japim.”**

- WINSTON CHURCHILL

DITA 15

EKSELENTË

Japim Më Të Mirën Për Perëndinë.

Të duam që çdo gjë e jona, të pasqyrojë Perëndinë të cilit i shërbejmë. Çfarë shprehje dhe moto e bukur! Ja si reagoi ajo, mbretëresha e Shebës ndaj Solomonit: Kur mbretëresha e Shebës pa gjithë diturinë e Salomonit, shtëpinë që ai kishte ndërtuar, ... ajo mbeti pa fjalë.¹

Fjala “ekselencë” kuptohet kur shikon diçka dhe nuk rri dot pa u mahnitur dhe pa reaguar, Ueee, sa bukur, e pabesueshme, kjo qenka nona fare, sa super qenka ose shprehje të ngjashme. Kur shikon krijimin e Perëndisë, sesa bukur i ka bërë gjërat, malet, lumenjtë, botën ujore ose tokësore, plazhet ose malet. Janë mahnitëse dhe të del natyrshëm ndonjë nga shprehjet shoqëruese si uaaaa, çfarë bukurie!

Duket qartë që Perëndia e do të bukurën, do që gjërat të jenë ekselente. Kur Ai krijoi qiejtë dhe tokën tha: Është e mirë.² Por kur Perëndia krijoi njeriun, Ai tha: Është shumë mirë³, është super fare, uaaa, është mahnitëse. Në gjithë krijimin e Perëndisë, njeriu ishte i tillë.

Kur shikon gjërat që Perëndia u kërkoi njerëzve të bënin, u thonte t’i bënin me materialet më të mira. Për shembull, tempulli që bëri Solomoni ishte me materialet më të mira. Ose kur Perëndia vendosi për të hequr, për të paguar mëkatet e botës, çfarë bëri? Ai dërgoi Birin e Tij në tokë për të vdekur në kryq për mëkatet tona, më të mirin, të vetmin që kishte.

Perëndia nuk tha: Po hajt, po dërgoj filan engjëll, se ai s'më bën më punë, e ka një krah të thyer, ka dalë në pension, nuk më duhet vërdallë; po e çoj në tokë që të bëjë ndonjë punë atje për të ndihmuar njerëzit! Jo, Ai dërgoi Birin e Tij për të paguar në kryq për ty, bëri maksimumin.

Ekselencë është mendësia kur i thua vetes: “Kur unë bëj diçka, dua të jap më të mirën.” Ndonjëri mund të thotë: Por kjo mendësi më ngarkon, më streson sepse unë nuk jam i tillë, kështu që nuk po bëj asgjë fare sepse ekselente unë s'kam gjasa që ta bëj. Megjithatë, ka dhe njerëz që thonë: Kjo lloj mendësie më motivon mua, që kur e bëj diçka e bëj siç duhet, jo sa për të kaluar radhën. Po ta krahasosh atë që mund të bëjmë ne me atë që është Perëndia, nuk ka gjasa as t'i afrohem i asaj që është Ai dhe si i bën gjërat Ai.

Për ta ilustruar këtë, dua të them shkurt një nga mrekullitë që bëri Jezusi, atë që tregon se me pesë bukë e dy peshq Ai ushqeu pesë mijë njerëz, një turmë të madhe. Aq ishte dreka e një djaloshi, pesë bukë dhe dy peshq; aq kishin dhe aq i sollën Jezusit. Dhe Jezusi nuk tha: Me mua po talleni; çfarë mund të bëjmë me kaq pak?! Shikoni mos gjeni ndonjë gjë më shumë, shikoni mos ka të tjera vërdallë. Jo, Jezusi e mori atë, më të mirën që kishte ai djalosh, dhe bëri më të mirën e Tij gjithashtu.

Falenderoi Perëndinë, e theu, ua dha dishepujve të Tij që ta shpërndanin dhe ndodhi mrekullia: e shumëfishoi atë që i dhanë.

Pjesa jonë është të japim më të mirën që kemi, sadopak që mund të jetë ajo, edhe nëse është pesë bukë e dy peshq. Kudo që je, në shtëpi, në punë, në shkollë, në kishë, kudo që je dhe po bën diçka, bëj maksimumin tënd. Ti jep më të mirën tënde, kjo ka rëndësi. Dhe

beso që Zoti Jezus do ta marrë, do ta bekojë, do ta përdorë dhe mrekulli do të ndodhin prej asaj që jep ti.

Një shembull që mund të jap. Në këtë pikë të historisë së kishës sonë, jemi duke u lutur dhe duke besuar se Zoti do të sigurojë financa që të kemi një ndërtesë tonën. Këtu ku jemi, po e përdorim në maksimum, por s'ka lidhje fare as me ekselencën, as me asgjë. Ka persona që shokohen kur vijnë dhe shikojnë ndërtesën tonë të vogël. Ajo që nuk dinë shumica është sesi kemi filluar para 12 vitesh, pa lekë, pa mbështetje, pa asgjë. Një grup të rinjsh që besonim: “Duam të bëjmë një kishë për të arritur brezin e ri me lajmin e mirë të Jezus Krishtit.” Dhe aty ku jemi, kemi arritur hap pas hapi, pas hapi. Njerëzit kanë dhënë maksimumin e tyre për të arritur deri këtu ku jemi. Disa kanë dhënë maksimumin e kohës së tyre, disa maksimumin e aftësive dhe dhuntive të tyre, disa maksimumin e financave të tyre. Është bërë me mund dhe sfida çdo gjë, çdo përpjekje dhe çdo iniciativë. Ajo që kemi patur ka qenë pesë bukë e dy peshq.

ICF Kids, festimet e fëmijëve, ndodhin në një ndërtesë tjetër që është pesë minuta larg nga ndërtesa e kishës, sepse nuk mund të jepnim më të mirën për fëmijët në ndërtesën ku jemi.

Atje fëmijët luajnë, festojnë, garojnë, mësojnë diçka të re. Nuk është kjo finalja që duam, sepse duam t'i kemi në një ndërtesë të gjitha grupmoshat, por sot për sot ajo është më e mira që mund të bëjmë. Por kurrë nuk do të ndalojmë. Në çdo ditë, në çdo mundësi do të japim më të mirën që mundemi.

Ekselencia nuk është perfeksion, por është thjesht dhënia e pesë bukëve dhe dy peshqve që kemi. I lëmë tek duart e Jezusit. Ai i merr,

falenderon Perëndinë, i thyen, ua shërben njerëzve të tjerë dhe aty ndodh shumëfishimi, aty ndodh mrekullia.

Nëse ti po mendon si mund të japësh më të mirën për Perëndinë, do të të përgjigjesha me një pyetje dhe katër sugjerime: Çfarë ke në dorë tani? Atë jep!

Ja ku mund të japim më të mirën:

1. Dashuri dhe nderim. Ajo që mund t'i japim Perëndisë së pari është dashuria jonë, përkushtimi ynë ndaj Tij. Sa herë që lutesh, jepi Atij falenderim, mirënjohje, nderim para se të kërkosh gjërat që të duhen. A do ta falenderosh që tani për gjërat e tua, qofshin dhe gjëra të vogla? Tregohet një histori sesi në kohën e Covid-it, një burrë në moshë doli nga spitali, por duhet të merrte oksigjen për disa ditë. Spitali i dha faturën e bombulave të oksigjenit që ishin të mjaftueshme për një javë. Ai filloi të qante, infermierja iu afrua dhe i tha: Zotëri, nëse fatura ju duket e lartë, mund të gjejmë një mënyrë për ta paguar. Ai tha: Jo, jo, i kam paratë për të paguar oksigjenin, por kam 86 vjet që marr oksigjen falas nga Perëndia dhe s'e kam falenderuar një herë. Falenderojë Perëndinë për gjërat bazike që siguron për ty dhe për çdo gjë tjetër.

2. Dhuntitë dhe talentet. Siç dha djaloshi ato që kishte, ti jep nga gjërat që mund të bësh për të tjerët. Pavarësisht që duket sikur po e bën për njerëzit, në fakt kështu mund t'ia japim shërbimin tonë Perëndisë kur bëjmë për të tjerët. Jezusi tha: Sa herë që keni bërë diçka për dikë, ma keni bërë Mua. Cilado qoftë dhuntia ose aftësia jote: muzika, arti, mësimi, shërbimi, çfarëdo që mund të bësh që dikush ta ndjejë dhe kuptojë dashurinë e Perëndisë prej teje. 3. Kohën. Kur bën kohën e qetë, lexon Biblën dhe lutesh.

Kur i jep dikujt nga koha jote, qoftë edhe një kohë në kafene për ta dëgjuar atë, për t'u lutur për të ose bën punë vullnetare diku, po dhuron nga koha jote.

3. Financa ose çdo gjë tjetër. Kur jep të dhjetën ose çfarëdo shume për gjërat që duhen në shërbesën e Perëndisë. Nuk ka aq rëndësi shuma që dhuron sesa qëndrimi i zemrës; atë që jep, ta japësh me buzëqeshje dhe gëzim. Sikurse dha djaloshi nga dreka e tij për Jezusin; ne japim sepse jemi bekuar që të jemi bekim dhe jo që t'i përdorim të gjitha për vete.

Për T'u Menduar

- A e ke menduar ndonjëherë ekselencën në këtë lloj forme?
- Duket sikur njerëzit duan veç të mbarojnë punën, por jo të japin maksimumin? Pse ndodh kjo vallë, si e mendon ti?
- Cila është më e vështira nga këto të katërta?
- Po më e lehta për ty?
- A do të vendosësh që sot, që tani, për të bërë çdo gjë me ekselencë?

Vazhdon tek dita tjetër: Dhe babai e priti krahëhapur sapo e pa dhe tha: 'Biri im ishte i humbur dhe u gjet përsëri.'⁴



**“Ligjet e mikpritjes
shqiptare janë më
të forta se armët.”**

– EDIT DURHAM

DITA 16

MIKPRITËS

Krijojmë Atmosferë Të Dashur, Welcome Home.

Ç'mund të bëjmë që mikpritja jonë të pasqyrojë kulturën e mbretërisë së Perëndisë që gjendet përgjatë Biblës? Shiko çfarë mikpritje gjeti mbretëresha e Shebës dhe sa u impresionua ajo! Kur mbretëresha e Shebës pa gjithë diturinë e Salomonit, shtëpinë që ai kishte ndërtuar, gjellët e tryezës së tij, banesat e shërbëtorëve të tij, shërbimin e kamarierëve të tij dhe rrobat e tyre, kupëmbajtësit e tij dhe holokaustet që ai ofronte në shtëpinë e Zotit, ajo mbeti pa fjalë.

¹

Te Luka kapitulli 15, Jezusi tregon historinë e një babai me dy djem. I vogli i kërkoi babait pjesën e tij të pasurisë dhe i ati ia dha. Ai pastaj iku larg, i prishi të gjitha dhe ra në hall të madh, por kur i thirri mendjes, i binte më mirë që të kthehej në shtëpi. Dhe babai e priti krahëhapur sapo e pa dhe tha: Biri im ishte i humbur dhe u gjet përsëri.²

Te kisha, komuniteti i ICF Tirana, djali i vogël që po kthehet në shtëpi, për ne është çdo person që po vjen për herë të parë tek ICF-ja, kurse djali i madh janë personat që janë pjesë tashmë prej njëfarë kohe ose prej një kohe të gjatë. Dhe duke patur këtë shëmbëlltysë në mendje, po krijojmë një kulturë mikpritëse. Ta përjetojë çdo vizitor shprehjen Welcome Home, mirë se erdhe në shtëpi, jemi shumë të gëzuar që ke ardhur të na vizitosh. Nuk ka rëndësi ku ke qenë, çfarë ke bërë ose s'ke bërë, çfarë beson apo nuk beson; këtu je i mirëpritur ashtu siç je. Ne gëzohemi shumë që ke vendosur të vish në shtëpinë e Zotit. Dhe kur vjen një familje për vizitë i pyesim:

Si mund t'ju ndihmojmë, çfarë mund të bëjmë për ju? Duam që ata si familje ta shijojnë kohën bashkë me ne. Dhe nuk u themi: “Shiko se fëmijët mblidhen në filan vend; ec majtas, pastaj kthehu djathtas, pastaj drejt; jo, jo, dikush i shoqëron deri te vendi ku mblidhen dhe argëtohen fëmijët.

Kjo është mikpritja. Dhe çfarë mund t'i thuash për mikpritjen një shqiptari sepse çdonjëri prej nesh është shumë mikpritës vetë. Ne e imagjinojmë sikur ai person na ka ardhur në familje për vizitë, sikur është ulur te dhoma e pritjes në shtëpinë tonë. Sigurohemi që ai/ajo ka vëmendjen tonë, që ndihet i rëndësishëm, që mund ta shijojë kohën që është aty me ne.

Kurse biri që qëndroi në shtëpi, simbolizon ata që janë besnikë ndaj familjes ICF Tirana, që kanë kohë e vite që janë pjesë e saj. Ata e shikojnë si familje prej vitesh, një familje ku marrin dhe japin; ata bëjnë për këtë familje dhe ne bashkë e ndërtojmë këtë familje, me njëri-tjetrin.

Por edhe sigurohemi që ata që janë në familje të qëndrojnë të lidhur. Dërgojmë mesazhe, marrim në telefon, shkëmbejmë emailë, pimë kafe, shkojmë për kohë çlodhjeje një fundjavë në Durrës ose diku tjetër, bëjmë kampe dhe aktivitete së bashku, festojmë bashkë gjërat e vogla dhe të mëdha, qajmë e lutemi bashkë me ta në kohë sfidash. I përgëzojmë gjithë kohën për investimin që japin rregullisht në familjen e tyre. Sigurohemi që çdo person të ndihet i vlerësuar, i çmuar dhe pjesë e rëndësishme në familjen e tij. Disa mënyra për ta praktikuar mikpritjen: Nëse do ta fillosh praktikimin e mikpritjes direkt, së pari bëj diçka në kohën e festimeve të ICF Tirana, para ose pas festimeve te zona e barit ose në forma të ndryshme.

Ose fillo një grup të vogël tek shtëpia jote. Mblidhuni bashkë 4-5 persona dhe kaloni kohë duke u miqësuar, lexuar e studiuar Biblën dhe duke u lutur për njëri-tjetrin. Nëse është shumë për ty që të takoheni çdo javë tek shtëpia jote sepse duhet të pastrosh shtëpinë mirë ose duhet të bësh gjëra të veçanta çdo herë, nëse e ndjen këtë presion, takohuni çdo javë tek një familje e ndryshme. Një mënyrë sesi mund të bëheni krijues gjithë kohën është kur çdo njeri e hap shtëpinë e tij për grupin një herë në muaj dhe bëhet me rotacion. Mund të ketë diçka të veçantë për të ngrënë ose pirë, tamam si traditë shqiptari, por thjesht duke shtuar kohën e studimit të Biblës dhe lutjen. Kështu filloi kisha e parë në shekullin e parë; njerëzit hapnin shtëpitë e tyre dhe mblidheshin nëpër shtëpitë e tyre 2-3 familje bashkë, disa herë më shumë se atëherë, ose në oborret e shtëpive të tyre. Madje edhe festimet e mesjavës në ICF Tirana, ato që janë për adoleshentët, studentët ose moshat e tjera, janë me tavolina dhe gjithmonë ka diçka për të ngrënë/pirë që secili të ndihet sadopak si në shtëpi. Mikpritja ka lidhje të ngushtë me zemrën. Kur ti bën diçka për të krijuar një atmosferë të tillë dhe jep nga koha jote për ata që janë të rinj ose për ata që janë pjesë e familjes tashmë dhe e bën këtë për kohë të gjatë, kjo stabilizohet në një lloj mendësie të fortë dhe pastaj të vjen shumë natyrshëm kudo që je.

Çfarë përfitimesh ka kur je mikpritës:

1. Ka kënaqësi personale. Sepse të jep gëzim kur jep nga jeta jote dhe ndikon një person, sado gjë e vogël të jetë ajo që ti bën, qoftë te kisha, te shtëpia jote ose kudo. Ndërsa po i ofroja mirëseardhjen dikujt, ai filloi direkt duke u prezantuar dhe u shpreh sesa i gëzuar ishte që na kishte gjetur, sepse kam disa kohë që ju

ndjek nga Instagrami dhe se isha kurioz ta shikoja nga afër ICF-në. U gëzova shumë që paska njerëz që i ndjekin me kuriozitet gjërat që postojmë dhe që dikush erdhi vetë për ta parë nga afër. Më dha shumë gëzim që isha unë i pari që e mirëprita atë person.

2. I ndryshon jetën dikujt. Kur ai/ajo ndihet i mirëpritur dhe e ndjen dashurinë e singertë, mund t'i ndryshoj jetën. Para ca vitesh, ishte një vajzë studente të cilës sapo erdhi te dera e ICF-së, nisën t'i mbusheshin sytë me lot dhe s'po e kuptoja pse-në. Ajo tha: Vetëm kur pashë tabelën 'welcome home' te dera, u preka shumë dhe mund ta imagjinoj sesa e mirëpritur do të ndihem në këtë familje. Dhe ashtu ndodhi; ajo u bë pjesë e komunitetit tonë dhe më vonë pjesë e skuadrës. Aty njohu partnerin e jetës dhe bashkë kanë një djalë; asaj iu ndryshua jeta. Sigurisht që ishin shumë faktorë, por filloi me mikpritjen. Ka shumë fuqi tek çdo gjë e vogël kur bëhet me dashuri të madhe.

3. Ndryshon një komunitet. Nëse secili bëhet pak më shumë mikpritës, gjithë komuniteti do të jetë si një familje e madhe dhe e dashur, një vend ku mezi pret të vish dhe të kalosh kohë. Kur vjen dikush për herë të parë, bëjmë një anketë: cilat ishin dy gjërat që të pëlqyen më shumë dhe një gjë që mendon se duhet bërë më mirë. Në 99% të rasteve, e para që i ka lënë përshtypje dikujt është mikpritja e ngrohtë dhe që janë ndier si në shtëpi. Ja pse ia vlen ta kemi të fortë këtë kulturë mikpritjeje.

4. Nderohet emri i Zotit. Jezusi vetë tha: Nga kjo do t'ju njohin që jeni të Mitë, nëse keni dashuri njëri me tjetrin.³ Që i bie, nëse dikush ndihet i mirëpritur si në shtëpi dhe i dashur nga ti, askush nuk do të thotë: sa çun/gocë i/e mirë qenka! Ndoshta ti atë

po prisje, shprehjen e kongës tironse çun si unë moj çun si unë, çun si unë ti s'ke me gjet. Më fal që po t'i prish pritshmëritë, por në shumicën e herëve nuk do t'i marrësh ti përgëzimet, por ata do të thonë: Ja sa të dashur janë ndjekësit e Krishtit, ja sa ndryshe dhe të veçantë janë. Sepse e dinë që kjo gjë, edhe pse është pjesë e kulturës shqiptare, nuk është se na vjen më aq natyrshëm. Por është dashuria e Perëndisë nëpërmjet teje që ta mirëpresësh, ta vlerësosh dhe çmosh tjetrin si pjesë e familjes. Shiko, dashuria po nuk u shpreh, nga do të kuptohet? Nëse Perëndia na ka urdhëruar ta duam njëri-tjetrin, si do të duket? Mikpritja është një nga mënyrat sesi shprehim dashurinë për dikë; çdo njeri ka nevojë për një komunitet ku ndihet i dashur, i vlerësuar dhe si në shtëpi. Le ta zmadhojmë këtë komunitet që ka filluar tashmë dhe vjen duke u rritur javë pas jave.

Për T'u Menduar

- Sa mikpritës je ti? Si do të ndiheshe nëse dikush do të vinte papritur tek dera, dikush që s'e ke ftuar e as nuk të ka lajmëruar?
- Sa do që ta kultivosh këtë gjë nga 1 deri në 10?
- A ke dëshirë të fillosh një grup të vogël të shtëpia jote ose të shërbesh tek mikpritja e festimeve të së dielës ose në ngjarje më të mëdha?
- Cilën nga këto të katërta nuk e kishe menduar më parë?
- Cilën do të fillosh ta praktikosh që këtë javë?

Vazhdon tek dita tjetër: Për çdo gjë falenderoni... – Bibla



**“Çdo gjë
bashkëvepron
për mirë...”**

– BIBLA

DITA 17

TË KËNAQUR

Gëzimi Në Zotin Është Forca Ime.

Kisha, komuniteti që po ndërtojmë, është një vend ku mezi pret të shkosh, jo vend prej të cilit mezi pret të ikësh. Meqë kemi marrë si model përjetimin e mbretëreshës së Shebës kur vizitoi Solomonin, ja çfarë tha ajo për këtë gjë: Lum shërbëtorët e tu që rrinë gjithnjë përpara teje dhe dëgjojnë diturinë tënde! ¹ Ajo ishte shumë e kënaqur kur pa se me çfarë vlerash dhe çfarë kulture kishte ndërtuar Solomoni, dhe sesi ajo ishte bërë diçka ngjitëse; e kishin të gjithë dhe e pëlqenin të gjithë.

Po sikur ta shikojmë dorën e Perëndisë në çdo gjë, të vogël ose të madhe? Po sikur ta shikojmë gotën e ujit gjysmë të mbushur, jo gjysmë bosh? Po sikur të shikojmë mirësinë e Perëndisë, madhështinë e Tij në çdo gjë? A e di pse do të ishte e mirë kjo gjë? Sepse Bibla thotë se në fund të historisë, të kapitullit të fundit të botës, Perëndia ka fituar, Ai është fitimtari. Ka kapituj në mes nga sot e në vazhdim ku jeta do të ketë ulje dhe ngritje. Do të ketë sprovë e sfida, do të ketë gëzim, bekime, favor. Do të ketë furtuna dhe kohë të bukura.

Por fjalën e fundit e ka Perëndia; veçse në fund Ai është fitimtari. Që i bie, nëse ti ke zgjedhur t'i besosh Atij, Ai është kapiteni i skuadrës dhe ti je në skuadrën fituese. A e di si thotë Bibla për fundin? Në fund, çdo gju do të përkulet, çdo gjuhë do të rrëfejë se Krishti është Zot², se Perëndia është i mirë, është madhështor, se Ai është fantastik.

Kjo më jep kënaqësi, kjo më jep gëzim. Nuk jam i gëzuar sepse po i bëj “pause” trurit ose logjikës. Jo, jo, sepse kam sigurinë tek

premtimet e Perëndisë dhe kam sigurinë se Perëndia e ka fjalën e fundit dhe fjala e fundit është fjalë fitoreje dhe shprese.

Imagjino një grup njerëzish, një komunitet, që kur janë bashkë ose vetëm, janë plot gëzim dhe të kënaqur sepse njohin mirësinë, gëzimin dhe besnikërinë e Perëndisë, Atit të tyre. Dhe ky lloj gëzimi bën të veniten sfidat dhe ngarkesat e jetës së përditshme.

Dhe një mënyrë sesi e mbajmë të gjallë, të karikuar, këtë kënaqësi dhe gëzim në Zotin është kur ndajmë me njëritjetrin gjëra që po bën Perëndia në jetën tonë. Ndërkohë që lutemi dhe Perëndia përgjigjet, le të ndajmë me njëri-tjetrit sesi u përgjigj Perëndia, çfarë mrekullie ka bërë tek ti, çfarë rruge ka hapur, si po vepron, si po bën gjëra të reja tek ti. Dhe kështu gëzohemi edhe ne të tjerët dhe marrim guxim për t'u lutur dhe kërkuar në emrin Jezus para fronit të Atit Perëndi.

Trego çfarë po bën Perëndia te familja jote, te jeta jote personale, te puna jote, te kisha, te familja. Falëndero Perëndinë për to. Për çdo gjë falenderoni, sepse ky është vullneti i Perëndisë³ - thotë Shkrimi. Sigurisht që është e vështirë; më natyrshëm të vjen

të ankoresh, të shikosh gjërat që mungojnë. Dikush tha: Ku është Zoti kur ndodhi ai aksident? Ia ktheva: Pse duhet të pyesim ku është Zoti kur ndodh një e keqe; po sikur të pyesim, ku është Zoti çdo sekondë? Ku është Zoti kur ndodh një gjë e mirë, ku është Zoti sa herë që lind dielli deri në përfundim?

A mund ta bëjmë këtë gjë pjesë të kulturës tonë të re? Të gjejmë gëzimin në Zotin sepse ky lloj gëzimi do të kthehet në forcë dhe jeta do të jetë më e plotë më e gëzuar; do të jetojmë më të kënaqur.

Ky lloj qëndrimi le të jetë baza e jetës, jo masa e gjërave që kemi ose nuk kemi, as masa e suksesit që po arrijmë, ose s'po arrijmë. Le të kemi në qendër të jetës sonë Perëndinë, gëzimin në Zotin, sepse kur të kemi sukses, do të festojmë dhe do t'i jemi mirënjohës Atij; kur të kemi sfida, do t'i thërrasim emrit të Tij për ndihmë; kështu Ai mbetet qendra e jetës sonë. Dhe jetën e kam bazuar tek premtimet e Tij, jo tek përjetimet e mia, sepse përjetimet e mia janë me luhatje, por premtimet e Perëndisë qëndrojnë përjetë.

Si të jesh i gëzuar çdo ditë:

1. Pranoje që çdo gjë bashkëvepron për mirë. Premtimi i Perëndisë është se në kohë sfidash ose gëzimesh Ai do të bëjë që çdo gjë të bashkëveprojë për mirë për ata që e duan Perëndinë.⁴ Ka raste kur i them Perëndisë në situata të vështira: “Nuk e di ku do të dalë e mira këtu në këtë që po kaloj, por unë do të të besoj Ty; Ti do t'i bësh gjërat të bashkëveprojnë për mirë.” Ky lloj qëndrimi do të bëjë të mundur që i ligu të mos ma vjedhë gëzimin.

2. Gjeje Perëndinë kudo. Bëje zakon këtë, të shikosh dorën e Perëndisë kudo. Sigurisht, jo tek mëkatet. Sepse çdo gjë e mirë vjen nga Perëndia, e keqja e ka rrënjën tek i ligu, disa herë tek bota, disa herë tek natyra ime e vjetër. Por e mira gjithmonë e ka burimin nga Perëndia. Dhe ta bësh zakon këtë gjë: ta shikosh dorën e Perëndisë në çdo gjë të mirë, kjo do ta shtojë gëzimin dhe kënaqësinë e jetës.

Dy nga motrat e mia kanë bletë dhe një ditë ndërsa po provoja mjaltin që kishin nxjerrë, po kujtoja vargun që thotë: Fjala e Perëndisë është si mjalti. E ktheva në lutje. Kaq e ëmbël dhe e

shijshme është Fjala jote, Perëndi; faleminderit për mjaltin dhe për Fjalën tënde, Perëndi.

3. Personalizojë leximin e Biblës. Bibla ka mbi shtatë mijë premtime. Personalizoji ato, p.sh. kur vargu thotë: Perëndia aq shumë e deshi botën, në vend të “botën” vendos emrin tënd. Sa herë që Perëndia premtonte se do të jetë me ty, vendos emrin tënd. Personalizojë, sepse janë premtime personale. Në momentin që ti zgjodhe Krishtin Jezus dhe u bërë bir/ bijë në familjen e Perëndisë, çdo premtim në Bibël është yti; premtimet janë personalisht për ty.

4. Falenderojë Perëndinë para kohe. Nëse e falenderojmë dikë pasi ka bërë diçka për ne, kjo është normale. Faleminderit që ma solle kafën, - i themi kamarierit. Faleminderit që bërë atë gjë për mua, - i themi dikujt. Sigurisht që është mirë të jemi mirënjohës dhe falenderues ndaj Perëndisë për çdo gjë që ka bërë dhe po bën sot. Por, po sikur të jemi falenderues edhe për atë që kërkojmë në lutje, për atë që do të vijë në të ardhmen? Auuu, kjo është e bukur sepse kjo tregon besim. Të falenderoj që tani o Perëndi, sepse e besoj se Ti do e bësh, do të vepros, do të...

E sigurt se ka dhe shumë mënyra të tjera për ta mbajtur zemrën të gëzuar dhe të kënaqur në Zotin. Kjo nuk ka kuptimin që të jetojmë një jetë të vogël dhe mediokre, thjesht duke u kënaqur me atë që po kalojmë ose kemi sot. Nuk po them këtë gjë. Sepse Jezusi vetë ka thënë: Kërkoni, trokisni, lypni. Jakobi, vëllai i Jezusit tha: Ju s’keni sepse nuk keni kërkuar. Kërkoni në emrin e Jezusit, synoni dhe ndërhyini në lutje sepse Ai ka thënë se do të bëjë shumë më shumë. Por për atë që po ndodh sot, atë që ke sot, sot ji plot me gëzim, mirënjohje dhe falenderim.

Për T'u Menduar

- Nga njëshi deri te dhjeta, çfarë note do t'i vendosësh vetes, sa i/e gëzuar je ____ ?
- Nëse do të kishe përpara një gotë 50% me ujë, cili do të ishte përshkrimi yt?
- A ka diçka që po të shqetëson sot, tani? Po sikur t'ia lësh Perëndisë që merakoset për ty dhe të marrësh gëzimin e Tij që tani?
- Nga këto të katërta, cila është më e lehta? Po më e vështira?

Vazhdon tek dita tjetër: Gjej kënaqësinë tënde në Zotin dhe Ai do të plotësojë dëshirat e zemrës sate. ⁵



**“Bekimi më i madh
në gjithë botën
është kur ti je
bekim për dikë.”**

– JACK HYLES

DITA 18

BUJARË

Ai Na Bekon Që Të Jemi Bekim.

Besojmë se ka më shumë kënaqësi të japësh sesa të marrësh dhe e konsiderojmë frymën e bujarisë si privilegjin tonë. Dua ta mbyll me vlerën e gjashtë që plotëson kulturën e komunitetit ICF Tirana. Ja të shohim si mbyllet vizita e mbretëreshës së Shebës tek mbreti Solomon. Mbreti Salomon i dha mbretëreshës së Shebës të gjitha gjërat që ajo i kërkoi; përveç këtyre, Salomoni i dha asaj shumë gjëra me bujarinë e tij të madhe mbretërore. Pastaj ajo mori përsëri rrugën dhe u kthye në vendin e saj bashkë me shërbëtorët e vet.¹ Ajo jo vetëm që mori ato që kërkoi, por përjetoi një bujari të madhe. Duket që Solomoni e kishte bujarinë vlerë të madhe.

Bujaria, në fakt, e ka filluesën te Perëndia vetë. Ai na deshi aq shumë sa DHA me bujari të vetmin Bir që kishte që të jetonte në tokë mes njerëzve për 33 vite dhe të vdiste vdekjen më të tmerrshme, vdekjen e kryqit, për të paguar për mëkatet tona. Dhe premtimi i Biblës është se nëse ne e vendosim Perëndinë të parin në financat tona, dhuntitë tona, kohë tonë, synimet tona,

në çdo gjë, Ai do të na japë dëshirat e zemrës tonë. Gjej kënaqësinë tënde në Zotin dhe Ai do të plotësojë dëshirat e zemrës sate.²

Dikur thuhej se shqiptari është bujar, bukë e kripë e zemër t'bardhë. Por a është më tani po aq e vërtetë? Tani, kur dikush zgjedh Krishtin, nuk ka më vetëm kulturën e vendit të tij, por ka gjithashtu kulturën e Mbretërisë së Perëndisë. Dhe një nga vlerat e kësaj kulture është bujaria.

Perëndia na jep, na bekon, siguron për ne, por nuk ndalon aty; Ai do që ne të bekojmë, të japim, të sigurojmë për dikë, të mos ndalojë zinxhiri i bekimit. Bujaria është mendësi që do theksuar dhe praktikuar shpesh, duke e ditur se ne nuk mund t'i japim Perëndisë më shumë se ç'na jep Ai ne.

Ne bëjmë në dasma diçka që shkon me vlerën e vendosjes së Perëndisë të parin: Kur një çift martohet, nga fundi i dasmës vjen torta e madhe. Dhe çifti e pret dhe merr vetëm një copë nga ajo dhe pjesa tjetër u jepet dasmorëve. Imagjino të ndodhë e kundërta: të marrin dasmorët një herë, ta bëjnë rrëmuje krejt tortën, pastaj, po ngeli gjë, t'i japin edhe çiftit një copë. A ka rëndësi nëse çifti merr i pari një pjesë torte dhe jo i fundit? Sigurisht që po, sepse tregon nderim dhe respekt kur e fillojnë ata tortën.

E njëjta gjë me Perëndinë. Prandaj, le të zgjedhim që do të vendosim Perëndinë të parin në gjërat që bëjmë, në gjërat që themi, në gjërat që japim, në mënyrën si drejtojmë veten, familjen dhe të tjerët. Japim me bujari, duke besuar se Perëndia e mban fjalën dhe do të na e kthejë shumëfish bujarinë tonë. Ja ta shikojmë nga ana praktike:

1. Bekimet e Perëndisë vijnë tek ti që pastaj të kalojnë tek të tjerët. Perëndia na bekon që ne të vazhdojmë të bekojmë të tjerët. Nuk na bekon që t'i përdorim të mirat vetëm për vete. Si i tha Perëndia Abrahamit: Do të të bekoj që të jesh bekim.³ Që të jesh si një liqen i gjallë, që merr dhe jep. Në Izrael është deti i Galilesë që merr ujë dhe nxjerr ujë dhe është plot gjallëri, me peshq dhe bimësi. Kurse Deti i Vdekur është me gjithë mend i vdekur. Ai vetëm merr ujë, por nuk nxjerr; në të nuk ka pothuajse asnjë gjallesë, por vetëm kripë. Perëndia do

që të na japë dhe ne të japim, dhe kjo do ta gjallërojë më shumë jetën tonë.

2. Perëndia kujdeset për nevojat e tua kur bekon të tjerët.

Perëndia premton të bëjë shumë për ata që ndihmojnë të tjerët. Perëndia të garanton se nëse ti e ke mendjen të bekosh të tjerët, Ai do të kujdeset për nevojat e tua. Ja si ka premtuar Jezusi: Në të vërtetë po ju them se nuk ka asnjë që të ketë lënë shtëpinë ose prindërit, ose vëllezërit, ose gruan ose fëmijët, për mbretërinë e Perëndisë, që të mos marrë shumëfish në këtë kohë, dhe në kohën e ardhshme jetën e përjetshme.⁴ Kur e ke mendjen të ndihmosh të tjerët, Perëndia merr përsipër përgjegjësinë që të të ndihmojë ty. Dhe kjo është ndihmë e madhe sepse Ai është më i zoti për t'u marrë me hallet, nevojat dhe sfidat e mia sesa unë vetë.

3. Do të kthehet ajo që mbjell. Sa më shumë që bekon të tjerët, aq më fort do të të bekojë Perëndia ty. Ja si ka thënë Ai: Jepni dhe do t'ju jepet: një masë e mirë, e ngjeshur, e tundur, gufuese do t'ju derdhet në gji, sepse me atë masë që do të matni, do t'ju matet edhe juve gjithashtu.⁵ Ne nuk ia kalojmë dot në bujari Perëndisë, Ai nuk të ngelet borxh. Te ky varg, duket sikur Zoti thotë: “Hajde bëjmë një garë, kush jep më shumë. Ti jep, Unë jap, kush fiton në fund?” Kush do të fitojë thua?

4. Kur Perëndia të bekon shumë, pret që të japësh shumë.

Jezusi e tha kështu: Kujt iu dha shumë, do t'i kërkohet shumë; kujt iu besua shumë, do t'i kërkohet më shumë.⁶ Mos ki merak se mos po jep shumë, mos po tregohesh bujar më shumë se ç'duhet me bekimet që të jep Perëndia. Sepse sa më bujar të jesh me atë që Perëndia të ka dhënë, aq më shumë do të ta kthejë Ai.

Si mbyllje e pjesës së dytë do të theksoja: Shiko, çdo familje ka një set vlerash, gjëra që vlerëson dhe çmon më shumë. Ne si kisha ICF Tirana kemi këto gjashtë vlera dhe duke i praktikuar këto ne ndërtojmë një kulturë unike në komunitetin tonë.

Dhe këto vlera nuk ndodhin rastësisht, nuk vijnë natyrshëm; janë mendësi që stabilizohen duke i praktikuar derisa të bëhen pjesë e jetës tëndë. Dhe kur jetojmë të gjithë me të njëjtat vlera, kjo prodhon unitet për ne si familje, si komunitet. Nëse secili bën në kokë të vet, prishet uniteti dhe nuk shkojmë të gjithë së bashku në të njëjtin drejtim.

Dhe duke synuar të gjithë bashkë të njëjtën gjë, do të ndodhë si në kohën e mbretit Solomon, që njerëzit do të vijnë nga ana e anës për të pyetur dhe për të parë vlerat, kulturën e veçantë që ka ICF Tirana. Dhe ne do t'u themi me plot gojën: “Ja pse jemi këtu ku jemi, sepse kemi si kulturë, si bazë këto gjashtë vlera.”

A je gati të përkushtohesh dhe ta jetosh jetën në bazë të këtyre gjashtë vlerave?


___ Po ___ Akoma Jo

Për T'u Menduar

- Sa do ta vlerësoje veten në lidhje me bujarinë nga një deri në dhjetë ____ ?
- Në një ditë normale, cilat fjalë përdor më shumë “s’kam”, “kam” apo “Zoti më ka bekuar mjaftueshëm dhe do të më bekojë edhe më”?
- Ndër ato katër sugjerimet sesi të jesh bujar, cili ishte më i lehti për ty? Po më i vështiri?

- A e ke përjetuar këtë gjë: ke qenë bujar dhe Perëndia ta ka kthyer?
- Me cilën nga këto të treja je më dorështrenguar: me kohën, lekët apo shërbimin ndaj dikujt?
- Si do e praktikosh bujarinë që sot? A të vjen diçka praktike në mendje për këtë gjë?

Vazhdon tek dita tjetër: Kujdesuni, pra, që të ecni me kujdes dhe jo si të marrët, por si të mençurit, duke e shfrytëzuar kohën, sepse ditët janë të mbrapshta.⁶



**“Pa Perëndinë jeta
nuk ka qëllim, dhe
pa qëllim, jeta nuk
ka kuptim. Dhe pa
kuptim jeta nuk ka
pikë rëndësie apo
shprese.”**

– RICK WARREN

Pjesa 4

Një Hap Më Tej, Cila Është Pjesa Ime?

Deri tani kemi parë sesa i paparë është Perëndia. Zgjidhe t'i besosh Jezusit me dëshirën dhe vullnetin tënd. Pe menunë e ushqimit që të duhet për të ecur dhe për t'u rritur në Zotin dhe sesa kulturë unike ka komuniteti ICF Tirana.

A ia ke bërë këto pyetje vetes: “Po nga unë, a pritet gjë? A mund të bëj diçka?” Jo për të marrë merita, por për t'i thënë faleminderit Perëndisë që më ka krijuar, që më njeh, që më ka dhënë një plan shpëtimi dhe që më ka pajisur me aftësi, dhunti.

Nëse këto janë pyetje që i ke menduar, atëherë do ta shijosh shuumë këtë pjesë të fundit të librit. Sepse do të shikosh sesa i rëndësishëm është roli yt në trupin e Krishtit. Kështu e krahason Bibla: Krishti është Kreu, Koka; Kisha (komuniteti i krishterë) është trupi. Dhe qëllimi i trupit është të dëgjojë Kokën dhe të bëjë gjëra që forcojnë këtë trup dhe sjellin ndikim përreth duke bërë për të tjerët gjithashtu, në emrin e Jezusit, sikur të ishte Ai vetë prezent aty. Nëse një pjesë e trupit nuk e kryen funksionin e saj, trupi ka anomali, sepse është krijuar të veprojë dhe të bashkëveprojë me të gjitha gjymtyrët dhe pjesët e trupit. Imagjino sikur zemra të thoshte: po bëj pushim ca ditë, s'do të punoj këtë javë? Ose një pjesë e trupit me më pak rrezik, gishti i vogël, të thoshte “nuk do të lëviz sot, do të rri varur dhe në gjumë gjithë ditën? Do të ishte anomali dhe gjë e çuditshme sepse duke qenë pjesë e trupit, pritet të bashkëveprojë. E njëjta gjë vlen për çdo person që ka zgjedhur Krishtin: pritet të jetë pjesë e trupit të Tij, kishës lokale, pritet që në atë komunitet, familje dhe jashtë saj të bëjë diçka, të marrë dhe të jap. Po çfarë? Ja ta eksplorojmë bashkë!

Nuk është se do ta arrish vetëm këtë pjesë, por me ndihmën e Frymës së Shenjtë, me ndihmën e familjes, komunitetit të krishterë pjesë e të cilit je ose po bëhesh; kështu mund ta plotësosh qëllimin që Perëndia ka për ty, arsyen pse të solli Ai në këtë tokë.

**“Kurrë mos e dysho
fuqinë e ungjillit
dhe as mos beso
se mund të ketë
persona, grupe ose
vende për të cilët
ungjilli nuk bën
punë.”**

– CHARLES SPURGEON

DITA 19

NDAJ LAJMIN E MIRË ME DIKË

Këtë Mund Ta Praktikosh Vetëm Në Tokë.

Të ndash lajmin e mirë; kjo është mundësi që të jepet vetëm për aq kohë sa je në tokë, është një gjë që mund ta praktikosh vetëm këtu sepse në qiell njerëzit nuk kanë nevojë të besojnë, ata do ta shikojnë me sy çdo gjë që kanë besuar për Perëndinë nga Bibla. Ky varg për mua është me shumë rëndësi dhe përgjegjësi. Jezusi tha: Sikurse Ti më ke dërguar Mua në botë, po ashtu Unë i kam dërguar ata në botë.¹ Ueee, një mision kaq të madh, kaq kyç, kaq për jetë a vdekje, Jezusi ua la në dorë njerëzve? Po, ashtu është. Nëse ata nuk do të kishin dashur, Lajmi i Mirë nuk do të kishte shkuar askund; do të kishte mbetur vetëm në Izrael dhe do të ishte fikur kur ai brez të vdiste.

Çfarë është Lajmi i Mirë? E kam shpjeguar me më shumë detaje tek dita 5. Kur ndan Lajmin e Mirë, po ndan këto katër të vërteta: Perëndia të do pa kushte. Mëkati na ka ndarë nga Perëndia. Jezusi pagoi në kryq për mëkatet tona. Kur zgjedh të besosh dhe ta pranosh Jezusin si Zot dhe Shpëtimtar, ti pajtohesh me Perëndinë, bëhesh bir/bijë i Tij dhe pjesë e familjes ku Perëndia është Ati yt.

Kur ti e kupton dhe e ke përjetuar dashurinë e Perëndisë, kur e di se Ai të ka krijuar që të të dojë, kur e di se jeta jonë nuk është rastësi, ka një qëllim, atëherë Perëndia pret që ti, unë, t'ua tregojmë të tjerëve këto gjëra, t'ua pasojmë të tjerëve.

Unë e fillova mbrapsht; ndër të parët me të cilët fillova ta ndaja Lajmin e Mirë ishte hoxha i fshatit tim. Kjo sepse isha me sfond të tillë besimi më parë dhe dija shumë gjëra për atë besim dhe ishte një djalë i ri, pak më i ri se unë, kisha dhe kam shumë respekt për të dhe

familjen e tij. Doja që ai të merrte, të besonte, të gjente këtë që gjeta unë. Por nuk pata sukses; rrinim me orë të tëra duke debatuar bashkë dhe kaq. Një mbrëmje, kur po lexoja Biblën, lexova një varg që për mua kishte vetëm një mesazh: ndalo së foluri me atë person, fillo të flasësh me dikë që dëshiron të dëgjojë atë që ke për të thënë. Dhe fillova ta ndaja Lajmin e Mirë me motrat e mia, me kushërinjtë e mi, me shokët, komshinjtë dhe në një kohë të shkurtër më shumë se gjysma e kushërinjve dhe të njohurve që njihja zgjodhën t'i besonin Jezusit.

Prandaj dua ta them që në fillim: nuk është puna jote ta bindësh dikë se Perëndia e do shumë dhe se Jezusi është e vetmja rrugë shpëtimi dhe pajtimi me Perëndinë. Bindja është puna e Frymës së Shenjtë; puna jonë është të ndajmë, të dëshmojmë, të tregojmë çfarë ka bërë Zoti për ne, për ty, për mua.

Po mirë, kujt t'i them? Shiko si e thotë Bibla: Ju do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju dhe do të bëheni dëshmitarët e mi në Jeruzalem dhe në gjithë Judenë, në Samari dhe deri në skajin e dheut.²

Kështu filloje. Ja ta shohim më nga afër.

1. Do t'u them atyre që janë në botën time. Mbaj mend se një këngë në vitet e para të besimit fillonte: K'të pak dritë që kam, dua ta ndriçoj. Së pari, ndriçoje te njerëzit në botën tënde, te ata që janë rreth e qark teje. Jezusi shëroi një djalosh një ditë dhe pasi e shëroi, ky djaloshi i tha: "Dua të udhëtoj me Ty, Jezus, dua të të ndjek Ty, të rri me Ty." Jezusi i tha: Jo, nuk dua të vish me Mua, por dua... 'Kthehu në shtëpinë tënde dhe trego çfarë gjërash të mëdha ka bërë Perëndia për ty.' Dhe ai shkoi anembanë qytetit duke treguar gjërat e mëdha që Jezusi bëri për të.³ "Kthehu në shtëpinë tënde", -

i tha Jezusi. Ai na thotë të njëjtën gjë dhe ne: “Fillo të ndash, dëshmosh, tregosh Lajmin e Mirë te shtëpia jote, te lagjia jote, te pallati yt, te kolegët e tu, te shokët/shoqet e shkollës, me njerëzit që jeton përditë; ajo është bota jote, ai është Jeruzalemi yt.” Dishepujt e Jezusit, kur Ai ua dha këtë porosi, ishin në Jeruzalem. “Fillojeni nga këtu ku jeni”, - u tha Jezusi. E njëjta gjë për ty; filloje aty ku je. Ne kemi lajmin më të mirë në botë. Por le ta ndajmë, t’i themi dikujt për Jezusin, duke filluar së pari te shtëpia, te njerëzit që kemi rreth e qark, te Jeruzalemi ynë.

2. Do t’u them atyre që janë përtej botës time. Dashuria për njerëzit le të dalë dhe jashtë zonës tonë të rehatisë; të shkojmë edhe te njerëz me sfond të ndryshëm, shkollim të ndryshëm, gjendje ekonomike të ndryshme, gjendje sociale të ndryshme. Sepse misioni ynë ka pasoja të përjetshme; bëhet fjalë për qiell ose ferr, kështu që duhet të jemi të gatshëm të dalim nga zona e rehatisë.

Nëse unë do të kisha gjetur vaksinën e kancereve dhe tumoreve do t’ua jepja të gjithë atyre që kanë nevojë. Do të ishte krim nëse do ta mbaja sekret sepse po vdesin njerëz përditë për shkak të këtyre sëmundjeve. Por ama, ti dhe unë kemi diçka më të rëndësishme; kemi “ilaçin” sesi dikush mund të pajtohet me Perëndinë dhe të ketë jetën e përjetshme dhe na është dhënë falas, secilit prej nesh. Dikush të deshi ty aq sa erdhi dhe të tregoi për dashurinë e Perëndisë. A do të bësh edhe ti të njëjtën gjë? Tregoji dikujt për këtë dashuri.

E kam bërë veten time të dobët me të dobëtit për të fituar të dobëtit; e kam bërë veten time gjithçka për të gjithë, që të mund të shpëtoj me çdo mënyrë disa njerëz.⁴ Më thjeshtë i bie, nuk rri vetëm me njerëz që janë të ngjashëm me mua sepse kemi mision për të ndërtuar ura dhe jo mure. Perëndia pret që ne ta hedhim hapin e të shkojmë. Cili është udhërimi i dytë më i madhi? Duaj të afërmin

tënd! Nuk duhet të shkosh shumë larg për këtë gjë. Besimi i pastër dhe pa njollë përpara Perëndisë dhe Atit është ky: të vizitosh jetimët dhe të vejat në pikëllimet e tyre dhe ta ruash veten të pastër nga bota.

5

Jezusin, gjatë kohës së tij në tokë, do ta gjeje gjithmonë afër njerëzve të lënë pas dore, atyre që ishin të dobët, që ishin të shtypur, të përbuzur nga shoqëria, të sëmurëve, nevojtarëve... . Kur ti ke këtë lloj zemre dhe bën këto gjëra, ja çfarë do të thotë Jezusi ty një ditë: Sepse pata uri dhe më dhatë për të ngrënë, pata etje dhe më dhatë për të pirë; isha i huaj dhe më pritët, isha i zhveshur dhe më veshët, isha i sëmurë dhe ju më vizitonit, isha në burg dhe erdhët tek Unë.⁶

Dhe nëse habitesh dhe thua: Kur o Zot, kur ka qenë, se nuk po kujtohem, mos ka qenë ndonjë tjetër dhe po më ngatërron? Jezusi do të përgjigjet: Sa herë ja ke bërë këto gjëra dikujt, ma keni bërë Mua.⁷ Kur i jep dikujt edhe një gjë të vogël, një inkurajim, një orë kohë në kafene për ta dëgjuar, pak lekë, rrobat e tua që s'po i përdor më, një dhuratë për dikë në nevojë. “Çdo shërbim që i bën dikujt, ma ke bërë mua”, - thotë Jezusi.

Jezusi tha te ungjilli i Markut, kapitulli 10: “Çdo përpjekje dhe çdo gjë nga e cila ju hiqni dorë dhe e jepni, e sakrifikoni për hir të Lajmit të Mirë, Unë atë gjë do t'juja kthej 100fish.” Perëndia thotë, se asnjë investim nuk është i kotë; në ekonominë e Tij, çdo gjë që bën në emrin e Tij, Ai do ta shumëzojë me 100.

Kështu që mos u dorëzo; nëse ke qenë i tërhequr, të lutem filloje me diçka sado e vogël të jetë. Ndaj Lajmin e Mirë me fjalë a me vepra dashurie, me gjëra të vogla ose të mëdha.

3. Do t'ia them gjithë botës. Po pse? Le ta kemi mendjen te bota e madhe, ta duam, të kujdesemi për botën, sepse së pari Perëndia kujdeset për të. Ky lloj kujdesi për botën do të na çojë në një nivel pjekurie akoma më të lartë. Pastaj u tha atyre: 'Dilni në mbarë botën dhe i predikoni ungjillin çdo krijese.'⁸ Ka disa të veçanta te ky varg. Nuk u flet vetëm pastorëve, nuk u flet vetëm drejtuesve të kishës, nuk u flet vetëm misionarëve, por u flet gjithë ndjekësve të Tij. Jezusi thotë: Nëse jeni dishepujt e Mi, më ndiqni Mua dhe Unë do t'ju bëj peshkatarë njerëzish. Ai u thotë ndjekësve të Tij të shkojnë kudo, sepse çdo person e meriton ta dëgjojë Lajmin e Mirë. Çdo person është i çmuar dhe ka nevojë ta dëgjojë Lajmin e Mirë. Dhe kur e tha Jezusi këtë, kishte pak mënyra transporti, mund të udhëtoje me këmbë, me gomar, kalë ose deve. Kishte edhe anije me rrema, por ishte sistem shumë i ngadaltë dhe jo shumë njerëz lëviznin me anije; kaq ishin mënyrat. Sot ke biçikletë, motorçikletë, makina nga të gjitha llojet, linja tragetesh, autobuzësh, avionësh, ke internetin që e ka zvogëluar botën fare. Mund të flasësh me gjithën botën ndërkohë që je me tuta dhe pa dalë nga shtëpia fare.

Njerëzit kudo në botë kanë uri për Lajmin e Mirë. Çdo person ka nevojë për Jezusin; thellë në zemrën e tyre janë bosh pa Perëndinë. Çdo person në botë, çdo shqiptar e meriton ta dëgjojë sesa shumë e do Perëndia dhe se Ai ka një plan për jetën e tij/saj. Përdore internetin për ta çuar Lajmin e Mirë tek një person më shumë, tek një shqiptar më shumë. 4. A do të shkojë dikush në qiell për shkakun tënd?

Njerëzit e fitojnë qiellin nëse zgjedhin t'i besojnë Jezusit si Zot dhe Shpëtimtar. Mos më keqkupto; nuk i marrim ne në krahë për t'i çuar atje. Por po them, sa personave ua ke dhënë ti mundësinë që ta dëgjojnë Lajmin e Mirë? Kur të jesh në qiell, a do të të thotë dikush: Faleminderit që ma tregove Lajmin e Mirë! Ti e dije Lajmin e Mirë

dhe nuk e mbaite sekret, por ia the dikujt që njihje, dikujt që e doje, dikujt që e kishe afër, dikujt që ishte ndryshe nga ti, dikujt që jetonte larg Shqipërisë.

A do ta thuash një lutje: “Perëndi më përdor mua, Jezus më përdor mua, ‘me qëllim që mbi tokë të njihet rruga Jote dhe shpëtimi Yt midis gjithë kombeve.’”⁹

Nëse bën një lutje të tillë, lutje gatishmërie dhe dorëzimi, do të shikosh se nëpër çfarë aventure të bukur do të të çojë Perëndia. A je gati për ta thënë këtë lutje: Zot më përdor mua me qëllim që mbi tokë të njihet rruga Jote dhe shpëtimi Yt midis gjithë kombeve?

Për T’u Menduar

- Kush ta ka thënë ty i pari Lajmin e Mirë? A i ke thënë “faleminderit”? Nëse jo, a do t’i shkruash një mesazh ose ta merrësh në telefon për t’i thënë thjesht “faleminderit”?
- A t’u kujtua dikush në botën tënde që do t’ia ndash Lajmin e Mirë? Shkruaji emrat këtu poshtë.
- A t’u kujtua dikush ndryshe nga ti që mund t’ia ndash Lajmin e Mirë në forma praktike? Shkruaji emrat këtu poshtë.
- A të vjen në mendje ndonjë mënyrë sesi ta përdorësh internetin për t’ia ndarë dikujt Lajmin e Mirë?

Vazhdon tek dita tjetër: Andrea takoi të parin vëllanë e vet, Simonin, e i tha: ‘Gjetëm Mesinë, domethënë Krishtin.’ Pastaj e çoi atë te Jezusi...’¹⁰



**“Jezus Krishti
erdhi për të bërë
tri gjëra: Për të
falur të shkuarën
tënde, për t’i dhënë
qëllim të sotmes
dhe për të siguruar
përjetësinë tënde
në qiell.”**

– RICK WARREN

DITA 20

E GJETA

A Të Ta Them Edhe Ty?

Imagjino sikur je në kinema për të parë një film, ke marrë kokoshka, pije, e ke gjetur karrigen dhe je rehatuar. Ka tre gjasa sesi mund ta përjetosh këtë kohë:

a. Nëse filmi është çka, ka shumë gjasa që do të të shqetësojnë të gjitha zhurmat që po bën dikush mbrapa, në mos deri në fund të sallës, ose drita e telefonit e atij tjetrit edhe pse është 10 metra lart, zhurmat e kokoshkave që hanë të tjerët. Karrigia s'të duket dhe aq e rehatshme.

b. Nëse filmi është i mirë, nuk të shqetësojnë zhurmat e të tjerëve; e ke mendjen vetëm tek filmi, kokoshkat e tua dhe pija që ke marrë për vete.

c. Por nëse filmi është shumë i mirë, është super fare, ti shkrihesh me filmin; nuk të shqetëson asgjë, madje ke harruar se ke blerë kokoshka. Të duket sikur je futur në film dhe po e përjeton, po të trazon. Dhe do që, sa të mbarojë t'u flasësh të gjithë shokëve për të, sepse ata duhet ta shikojnë patjetër këtë super film; do që t'ua tregosh, por as nuk do t'ua prishësh shijen që beson se do të marrin.

E di pse e fillova kështu? Sepse dua të të kujtoj se ti je krijuar për më shumë. Ne jemi krijuar për diçka përtej vetes. Nuk jemi krijuar të biem në dashuri vetëm me veten tonë dhe të rrimë para pasqyrës dy a më shumë orë në ditë, të rrimë në media sociale mbi pesë orë në ditë dhe të hedhim mbi dhjetë selfie, ku në 90% të rasteve, në foto je ti dhe vetja jote. Por Ai do që të bëhesh pjesë e diçkaje, do që të përfshihesh, të futesh brenda dhe të mos e

kesh mendjen fare te shpërqendrimet që ndodhin rreth e qark teje.

Kur ti njeh Krishtin si Zot dhe Shpëtimtar, ti bëhesh pjesë e diçkaje të madhe që quhet Familja e Perëndisë, Mbretëria e Perëndisë, ku mbret është Jezus Krishti. Dhe kur e ke mendjen tek Mbreti dhe si t'i pëlqesh Atij, i harron shpërqendrimet e vogla, sepse së pari e ke mendjen tek i pari. Ndiheh gjithashtu i privilegjuar që Jezusi të ka bërë pjesë të kësaj gjëje të bukur dhe të madhe.

Ja çfarë i ndodhi njërit prej dishepujve të parë të Jezusit: Andrea takoi të parin vëllanë e vet, Simonin, e i tha: 'Gjetëm Mesinë, domethënë Krishtin.' Pastaj e çoi atë te Jezusi...¹ Andrea ishte aq i gëzuar kur gjeti Jezusin, saqë shkoi te vëllai, te personi më i dashur për të dhe i tha: E gjeta Jezusin, dua ta gjesh edhe ti!

Jezusi tregon tri histori në një kapitull te ungjilli i Lukës, kapitulli 15, për gëzimin kur dikush gjen diçka të çmuar: Delja e Humbur, Monedha e humbur, Djali i humbur. Të tria mbarojnë me gëzim: Gëzohuni bashkë me mua, sepse e gjeta delen time që më kishte humbur. Gëzohuni bashkë me mua, sepse e gjeta monedhën që kisha humbur. ...të hamë dhe të gëzohemi, sepse ky biri im kishte vdekur dhe u kthye në jetë, kishte humbur dhe u gjet përsëri. Dhe filluan të bënin një festë të madhe.² Ka gëzim, ka festë në qiell dhe në tokë kur një person më shumë fitohet për Krishtin, i rrëmbehet mbretërisë së errësirës dhe shtohet në familjen e Perëndisë. Ja si thotë vargu: Por të gjithë atyre që e pranuan, Ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë, atyre që besojnë në emrin e Tij.³ Po mirë, tani që unë e njoha, e gjeta Krishtin, pse ta vras mendjen për të tjerët?! Barii mund të shkonte për të fjetur gjumë sepse i kishte nëntëdhjetenëntë delet në vathë, vetëm një kishte humbur. Por, zemra e Perëndisë është

e dashur, nuk gjen qetësi derisa ta gjejë dhe ta sjellë në shtëpi atë që ka humbur.

Le të shohim disa hapa praktikë sesi t'i tregosh dikujt unë e gjeta Jezusin, por dua ta gjeshe edhe ti. Do të bëjmë tri gjëra bashkë:

- a. Do të të tregoj mënyrën më praktike si ta ndash historinë tënde.
- b. Dua ta shkruash dëshminë tënde te vendet bosh që ta kesh gati kurdo që të jepet mundësia për ta ndarë me dikë.
- c. Si model, dua të të tregoj sesi e gjeta unë Jezusin.

A. Cila nga këto ngjan me ty? Diçka që kishe para se të njihje Jezusin dhe çfarë të dha Ai, me çfarë e ndërroi? Me këtë filloje: Çfarë ka bërë Zoti për ty? Çfarë ndryshoi Ai tek ti?

Shqetësime—Ankth Paqe—Qetësi
Turp—Faj Falje
Zemërim—Me Nerva Durim—Dashuri
Boshllëk—Pa Qëllim Kam Qëllim
Trishtim Ngushëllim dhe Gëzim
Stres—Rraskapitje Fuqi dhe gëzim për jetën
Vetëvlerësim të ulët Plot me vlerësim
Pa fuqi fizike Forcë për të vazhduar
Zhgënjim Besoj planin e Perëndisë
Pasiguri Konfidencë dhe siguri
Keqardhje Kam një mundësi të re
I Pakënaqur nga jeta I Kënaqur dhe i qetë
Depresion, zhgënjim Shpresë
Frikëra Besim për t'u përballur me to
Jetë e mërzitshme Aventurë me Perëndinë

Diçka më mungon Ndjesi Plotësimi I
 Hidhëruar, Inatçor I çliruar nga e shkuara
 Lëndim nga mohimiDashuri pa kushte nga Perëndia
 Probleme me marrëdhënietMarrëdhënie të mira
 Probleme me financatI qetë për financat
 Probleme nga shkolla E dua shkollën, edukimin
 Varësi, zakone jo të miraFuqi për të ndryshuar
 Fokus te vetjaDashuri për njerëzit
 VetmiAi është gjithmonë me mua

Tani që gjete një ose dy, shkruaji në një fjali. Historia e jetës sime e përmbledhur me një fjali:

B. Historia ime me katër pjesë:

1. Si ishte jeta ime para se të njihja Krishtin? Te cilat gjëra mund ta gjej veten një jobesimtar tek ti? Çfarë qëndrimesh kishe që i ka një jobesimtar akoma? Çfarë gjërash kishin më shumë rëndësi për ty? Ku po e kërkoje qëllimin e jetës, me çfarë e kishe zëvendësuar Perëndinë? (dukje, sporte, qejfe, lekë, pije, argëtim, seks, hobi...) Çfarë e dominonte një javë normale tënden?

2. Si e kuptova që kisha nevojë për Jezusin? Si dëgjove për Jezusin në fillim? Çfarë të shtyu të besojë? Çfarë ishte diçka në jetën pa Perëndinë që nuk po të pëlqente më; kalove ndonjë lëndim, problem, situatë të vështirë, sfidë? Kjo shkon me atë fjalinë që zgjodhe si temën e jetës në fillim. Si ta tërhoqi vëmendjen Perëndia? Çfarë të nxiti që të besojë?

3. Si ia përkushtova jetën Krishtit? Çfarë bëre specifikisht kur e more atë përkushtim? Kur ndodhi? Çfarë the kur u lute? Ji sa më specifik te kjo pjesë.

4. Ndryshimi që i ndodhi jetës sime. Çfarë ndjeve pasi u lute, çfarë përjetove? Çfarë problemesh u zgjidhën? Si të ka ndryshuar Jezusi, çfarë është bërë më mirë tek jeta jote? Si i ke marrëdhëniet me njerëzit? Jep një shembull të një marrëdhënieje të rregulluar.

C. Historia e jetës time. Për mua, e përmbledhur me një fjali do të ishte: Kisha boshllëk, jetë pa qëllim; tani kam qëllim. Kisha varësi dhe këto i kisha për të mbushur boshllëkun; tani varem te Perëndia.

Kisha shumë dëshira edhe pse jetoja në mal, në luginën e Shëngjergjit të Tiranës. E doja shkollën, por përtoja të mësoja. Fillova ta lë shkollën pas dore dhe të pija lokaleve (dy kishim gjithsej; një herë te njëri, një herë te tjetri) dhe nëpër festat që bënim te shkolla dhe vazhdoja të pija edhe kur isha në shtëpi. Kur nuk fitova shkollën e lartë, u dëshpërova shumë; u thellua gjithë ai boshllëku dhe hutimi që kisha dhe vazhdova të pija më shumë.

Një natë, kur isha te shtëpia e dajës për darkë dhe sigurisht duke pirë, pashë rastësisht në dritare një libër të çuditshëm, me kapak të zi. Kur e hapa, ishte me shkonja të vogla, fletë shumë të holla dhe faqet e librit ishin të ndara në dy kolona. Libër shumë i çuditshëm! Ishte qershor 1993, si kënga e Alban Skënderaj “Viti ’93”, por me tjetër fokus.

Të nesërmen, nga kurioziteti e mora ta lexoja atë libër. Ishte Bibla, Dhjata e Re dhe fillova te libri i parë: “Ungjilli sipas Mateut”. Që në fillim, kapitujt 5 deri në 7 për mua ishin dhe janë tre kapitujt me fjalët më të bukura, më të thella, më trazuese në botë: predikimi në mal i Jezusit. Vendosa t’i besoja Jezusit sepse gjërat që kisha dëgjuar për Të ishin shumë ndryshe nga ato që lexova aty. Më vonë u luta për diçka dhe Zoti m’u përgjigj; ishte një siklet fizik që nuk ia kisha thënë asnjërit dhe nuk mora asnjë mjekim, por u luta dhe pas disa ditësh iku. Kjo e forcoi më shumë besimin tim.

Si fillova të besoja? Në fund të këtij libri ishte një lutje model, e ngjashme me atë të dita 5. U luta sipas atyre fjalëve, por edhe me fjalët e mia; ishte si lutje dorëzimi total te Jezusi. Jezus, merre dhe drejtoje jetën time, pastroje dhe më fuqizo që të mos bie më pre e zakoneve që kam, më bëj tjetër njeri, unë nuk mundem më!

Sikur më iku një ngarkesë e madhe nga shpatullat pas asaj lutjeje. Nuk vura alkol më në gojë për tetë vite; tani mund të pi pak, por më ka ikur krejt dëshira për alkol. U bëra më i dashur me motrat e mia – kam pesë motra. Fala njerëzit që na kishin lënduar dhe dëmtuar shumë si familje dhe po bëhej më e lehtë të falja edhe të tjerë, sepse mbledhja shumë zemërim dhe doja hakmarrje. Atë ditë, mora një qëllim jete të ri. Mund të më ndodhnin gjëra dhe më kanë ndodhur shumë gjëra të vështira, por nuk më është lëkundur besimi që kam vënë te Jezusi, madje ka ardhur duke u forcuar.

Do ta mbyllja bisedën duke e nxitur personin me të cilin po e ndaja dëshminë time: A do të besosh te Jezusi për të patur një jetë ndryshe në të gjitha dimensionet e saj? Sepse Jezusi të pastron të shkuarën, e fal dhe e pastron çdo mëkat dhe çdo faj, i jep qëllim dhe qartësi të sotmes, i jep siguri të ardhmes.

Nëse ai ose ajo ka dëshirë, pa presion, por me vullnet të lirë, lutuni së bashku. Nëse të ndihmon, ke një model lutjeje te Dita Pesë, ndihmoje atë person në udhëtimin e ri që nisi, më kontakto mua, ICF Tirana për të ndihmuar me një Bibël, gjëra që mund të duhen. Kaq e thjeshtë është!

Për T'u Menduar

- A e kishe menduar kaq të thjeshtë historinë e jetës sate? A mund ta ndash me dikë për 3-4 minuta?
- Cilën nga këto të katërta e pate më të lehtë për ta formuluar; cilën e pate më të vështirë?
- A ndihesh gati për ta ndarë historinë tënde me dikë që sot? Me kë? _____

Vazhdon tek dita tjetër: Perëndia e sillte mbarë në duart e tij çdo gjë që bënte ai.⁴

**“Lutu sikur çdo gjë
varet nga Perëndia.
Puno sikur çdo gjë
varet nga ti.”**

- AGUSTINI

DITA 21

PUNA ËSHTË ADHURIM.

A Thua Të Jetë e Vërtetë?

Puna është adhurim, është njëlloj si të adhurosh Perëndinë. A thua të jetë e vërtetë?

Shiko, kur Perëndia krijoi botën, krijoi Adamin dhe e vuri në kopshtin e Edenit. Dhe kur Perëndia i kërkon atij “punoje, kultivoje tokën”, në hebraisht është përdorur fjala אָדָוָה (avodah). Kjo fjalë e përkthyer është e njëjta për punën, shërbimin, adhurimin. Adami që punonte dhe kujdesej për kopshtin e Edenit e kishte punën e tij si adhurim ndaj Perëndisë.

Por si mund të jetë kështu, sepse duket sikur adhurimi është tjetër gjë, puna është tjetër gjë? I gjithë Shkrimi përmbledhet në dy urdhërime, - tha Jezusi. Duaj Perëndinë... duaj njeriun. Kur ti punon, kur i shërben dikujt, po ia lehtëson jetën atij personi dhe meqenëse nga puna ose shërbimi yt po përfiton një njeri, kjo është formë adhurimi ndaj Perëndisë; ti po kujdesesh për njeriun që është bërë sipas imazhit të Perëndisë.

Nëse punon kamarier, duke i shërbyer dikujt kafënë ose atë që ka porositur, ti po e ndihmon atë të qetësohet duke pirë kafënë ose duke ngrënë. Nëse punon te kasa e një marketi, ti po ia lehtëson jetën dikujt me punën tënde. Nëse je në punë tjetër: mjek, mësues, infermier, inxhinier, bujk në fshat, mekanik, lan makinat, punon në një OJF, art, studio... puna dhe shërbimi yt po ia lehtësojnë jetën dikujt dhe kjo i sjell kënaqësi Perëndisë, kjo është njëlloj si të adhurosh Perëndinë.

A mund ta imagjinosh sikur çdo person të punonte me këtë lloj mendësie? Sikur po adhuron Perëndinë me punën, shërbimin e tij? Puna s' do të ishte më punë; do ishte gëzim që ti ke mundësi t'ia lehtësosh jetën dikujt. Dhe më e bukura, në fund të muajit do të paguhesh, por nuk e ke këtë synim jete; kjo vjen si rezultat i punës së mirë dhe me cilësi. Çdo shef, çdo përgjegjës, drejtor, pronar do të donte disa punonjës të tillë, që e bëjnë punën si adhurim, me pasion, me dëshirë, japin maksimumin dhe, natyrshëm, shkëlqejnë në atë që bëjnë.

Max Weber ishte ai që solli revolucion në këtë gjë dhe i dha theksimin e duhur në atë që e quajti “doktrina e punës”. Në vitin 1904, ai shkruajti një libër për etikën protestante (ungjillore) në punë. Sepse etika e punës dhe cilësia e punës nga të krishterët protestantë binin shumë në sy. Por kjo lloj mendësie mori zgjerim dhe theksim që në kohën e Martin Luterit në kohën e Reformimit, shek. XVI. Një nga thëniet e tij të preferuar për mua është kjo me fshatin: Edhe nëse puna jote është mjelja e lopëve ose pastrimi i bajgave të tyre, bëj më të mirën që Perëndia të marrë lavdi nga ajo lloj pune. —Martin Luteri

Si tha? Edhe nëse punon në fshat duke mjelë lopët ose duke pastuar katoinë e lopës, edhe me atë punë Perëndia mund të marrë lavdi kur jep maksimumin tënd dhe e bën super. Ai tha gjithashtu se ajo punë është njëlloj me atë të predikuesit, të gjykatësit, njëlloj me prindërimin ose çdo lloj pune tjetër. Madje ai e ktheu ndryshe duke thënë: Perëndia po e mjel lopën nëpërmjet teje. Ne lutemi që Zoti të sigurojë bukën tonë, bukëpjekësi çohet dhe punon turn i tretë çdo natë që në mëngjes të kemi bukë të ngrohtë. Perëndia siguron veshjen tonë, por pambuku është në arë dhe leshi është në kurrizin e deles. Shkon njeriu që e mbledh pambukun, e qeth delen, e përgatit

për t'u bërë rroba. Me punët tona, i urituri ka bukë për të ngrënë, i zhveshuri ka rroba për t'u ngrohur.

Për mua, nëpërmjet meje Perëndia po e shkruan këtë libër, nëpërmjet meje Perëndia po lan enët te familja ime, po hedh mbeturinat te koshi, po blen ushqimet te marketi. Nëpërmjet meje, Ai i mësoi çunat e mi të ngasin bicikletën. Nëpërmjet teje, Ai bën fotot dhe videot që poston ti në social media, bën punët aty ku je ti, prezanton shtëpitë që po jep me qera ti, bën kafen që ia shërbeve dikujt, i jep diçka dikujt në nevojë; nëpërmjet teje, Perëndia po kujdeset për prindërit e tu të moshuar. Perëndia po i bën nëpërmjet teje ato punë.

Puna jonë i sjell kënaqësi Perëndisë sepse po kujdesemi, po ia lehtësojmë jetën një personi. Që i bie, çdo lloj pune është e shenjtë, është e veçantë, është adhurim për Perëndinë. Nënata, prindërit që rrisin fëmijën në shtëpi, ata që drejtojnë qytetin a shtetin, ai që mbjell dhe korr në arë, ai që mjet lopën, ai polici që rregullon trafikun dhe ruan qetësinë, ai që nget autobusin, ai që pastron qytetin, ai që...

E di, e di që kjo nuk është normë e përditshme sepse njerëzit e vlerësojnë njëri-tjetrin ose veten në bazë të pozicionit të punës. Por a mund ta shikojmë me sytë e Perëndisë çdo lloj pune? Për atë që është në shkollë, a mund të studiosh dhe t'i marrësh ato dhjetat sikur do t'ia paraqitësh Perëndisë, të nderosh Perëndinë me gjërat që studion?

Kjo lloj mendësie do të sillte revolucion sepse do ta shikonim çdo punë...

1. Si të njëllojtë. Pa bërë garë që t'ia kalojmë dikujt. Ta kthejmë garën tek vetja, që çdo gjë që na zë dora ta bëjmë duke dhënë maksimumin tonë; me të njëjtin pasion siç punojmë në shtëpi, të shërbejmë në kishë, të punojmë në punë ose studiojmë në shkollë. Të jemi njëlloj pasionantë për çdo gjë.

2. Pa hierarki. Të gjithë ngordhin për të qenë një çikë shef, drejtor, përgjegjës. Por në sytë e Perëndisë, nëse ajo puna që bën ti i shërben dhe ia lehtëson jetën dikujt, ajo është punë super. Ta shikojmë punën jo si mburrje “shiko çfarë di të bëj unë”, por ta shikojmë për lavdi të Perëndisë “shiko çfarë mund të bëjë Perëndia nëpërmjet meje!”

3. Si shërbim. Puna shikohet si mjet për të sjellë të mira materiale: “Veç të sjellë lekë në shtëpi, pa nuk ka rëndësi çfarë pune bën.” Po sikur ta shikosh punën si vendi ku ti i shërben Perëndisë dhe të afërmit tënd, aty ku je? Ta nisësh ditën e punës a të shkollës duke i thënë vetes: Sot unë do t'i shërbej Perëndisë këtu ku jam.

4. Jo si e fundit. Kjo nuk do të thotë të mos kesh ambicie të mirë, të dëshirosh, të synosh, të ëndërrosh për më shumë. Nuk do të thotë të rehatohesh aty ku je dhe të mos bësh asnjë përpjekje për diçka të re. Sepse ne jemi krijuar në imazhin e Tij; ne krijojmë, kultivojmë, përmirësojmë çdo gjë që na zë dora.

Një gjë që e ngatërrojmë shpesh është, kur jemi në punë bëjmë sikur punojmë dhe puna ngelet pas dore. Kur jemi pushim, bëjmë sikur pushojmë sepse na kanë ngelur punë mbrapa për t'u bërë. Por nëse ndjekim parimin “kur punojmë japim më të mirën, japim maksimumin, dhe kur pushojmë, pushojmë tamam”, kjo do të sjellë më shumë balancë dhe më shumë çlodhje.

Perëndia bëftë siç bëri me duart e Jozefit: Perëndia e sillte mbarë në duart (e Jozefit) çdo gjë që bënte ai ¹ Por ama Jozefi bënte më të mirën, jepte maksimumin e tij.

Aq sa është puna e shenjtë, aq është edhe pushimi i shenjtë. Një ditë pushim për t'u çlodhur, për të gjeneruar energji, është po aq e nevojshme. Aq e nevojshme saqë Perëndia e vuri si një nga dhjetë urdhërimet: Ditën e shtatë bëj pushim! ² Që i bie, kur ti pushon është adhurim gjithashtu. Sepse kur ti pushon, po i thua vetes “nuk e mbaj unë peshën e gjithë botës; po nuk punova unë, a do të shembet e gjitha?” Nëse ke patur mendime të tilla, si ia bëri bota kur ishim të mbyllur në kohën e Covidit pa ndihmën tënde? Kur ti pushon, po thua: “Unë e di se Perëndia është në kontroll dhe jo unë. Nëse Ai thotë se unë duhet të pushoj një ditë në javë, do të pushoj sepse Ai e ka për të mirën time dhe e di më mirë si funksionon trupi im dhe çfarë i duhet atij.”

Që i bie, le të japim maksimumin tek të dyja: kur punojmë, të japim maksimumin, por edhe kur pushojmë, ta bëjmë atë siç duhet, pushim me gjithë mend.

Se mos ngatërrohemi: Kur ne punojmë dhe japim më të mirën, kjo nuk na bën më të mirë para Perëndisë, nuk na shton pikë në dashurinë e Tij ndaj nesh; nuk shpëtohemi nga etika e lartë e punës. Sepse Perëndia nuk ka nevojë për punët tona, por ka nevojë i afërmi ynë. Ne e bëjmë sepse kemi njohur dashurinë e Perëndisë; nuk e bëjmë për ta fituar ose zmadhuar atë. Miqësia jonë me Perëndinë e ka bazën te puna e Tij, jo te puna jonë, tek hiri i Tij, te plani i shpengimit që vjen nga jeta, vdekja dhe ringjallja e Jezus Krishtit. Por ama Ai na kërkon ta duam njëri-tjetrin, t'i shërbejmë njëri-tjetrit. “Po e bëtë për njëri tjetrin, ma keni bërë Mua.” ³ Që i bie, sa herë e duam dikë dhe i shërbejmë atij/asaj me punën ose shërbimin

tonë, po i shërbejmë Krishtit. Në tokë nuk i shërbejmë dot Perëndisë drejtpërdrejt. E adhurojmë Atë, i drejtohem Atij me lutje drejtpërdrejt, por mënyra sesi e adhurojmë me punën tonë, është kur shërbejmë, kur punojmë për dikë.

Dhe mos harro! Nuk janë thjesht gjëra për t'u bërë, punë për t'u bërë, por është Perëndia duke i bërë nëpërmjet teje.

Për T'u Menduar

- A e kishe dëgjuar më parë këtë koncept për punën? __ Po __ Jo
- A mund të shkruash pesë gjëra që ka bërë Perëndia nëpërmjet teje këto dy-tre ditë?
- A ndryshon kjo me mënyrën sesi e ke parë punën deri më sot?
- A je gati ta shikosh veten çdo ditë, në çdo gjë që bën, sikur Perëndia po e bën atë nëpërmjet teje? __ Po __ Akoma jo

Vazhdon tek dita tjetër: Ato gjëra që syri nuk i ka parë dhe veshi nuk i ka dëgjuar dhe nuk kanë hyrë në zemër të njeriut, janë ato që Perëndia ka përgatitur për ata që e duan Atë.⁴



**“Mendja është si
një fushëbetejë
dhe betejat e jetës
sate gjithmonë janë
fituar ose humbur
në mendje.”**

– CRAIG GROESCHEL

DITA 22

MENDJA

Kjo Arenë e Madhe.

Sa shumë gjëra ndodhin në mendjen tonë! Aty fillojnë të gjithë të mirat dhe të këqijat. Aty fitohen ose humben të gjitha betejat. Si të merrem me mendimet që hyjnë në kokën time? Katër arsye pse janë të rëndësishme mendimet që më vijnë ose kam në kokë:

1. Sepse mendimet e kontrollojnë jetën. Çdo veprim që bën, fillon si mendim. Ruaje zemrën tënde me shumë kujdes, sepse nga ajo dalin burimet e jetës.¹ Nganjëherë e neglizhojmë ose nuk e kemi idenë sa fuqi kanë mendimet tona për mirë ose për keq. I japim më shumë rëndësi ndjenjave sesa mendimeve. Megjithatë, nuk janë ndjenjat ato që e formojnë jetën, por bindjet, ato gjërat që dëgjon dhe beson. Kur ke qenë i vogël, të janë thënë gjëra që nuk ishin të vërteta, por i besove dhe ke vepruar sipas tyre. Prandaj transformimi fillon kur i kontrolloj gjërat që mendoj, sepse janë ato që e ndryshojnë jetën time.

Duhet t'i jap rëndësinë e duhur sepse...

a. Aty është arena e mëkatit. Të gjithë tundimet ndodhin në mendje dhe kur bie pre e tundimit ndodh mëkati, së pari në mendjen tonë. Ka shumë mëkate që ndodhin vetëm në mendje, p.sh. krenaria, epshi, lakmia, hidhërimi, zemërimi, shqetësimi... ndodhin vetëm në kokën tonë. Ja si thuhet për këtë tensionin që ndodh në mendjen tonë. Në fakt unë gjej kënaqësi në ligjin e Perëndisë sipas njeriut të brendshëm, por shoh një ligj tjetër në gjymtyrët e mia, që lufton kundër ligjit të mendjes sime dhe që më bën skllav të ligjit të mëkatit që është në gjymtyrët e mia.² Dua ta bëj vullnetin e Perëndisë, por ka luftë, betejë në arenën e

mendjes sime. Disa herë e kuptojmë këtë lloj beteje, disa herë jo. Por është një luftë e vazhdueshme; e di pse? Sepse mendja jote, truri yt është burimi kryesor, është vendi që Satani, djalli dëshiron ta kontrollojë. Pse? Sepse ajo që ta tërheq vëmendjen, të bën për vete dhe të merr me vete. Pra, është si arenë e madhe lufte, si fushëbetejë, kush fiton më shumë hapësirë.

b. Aty gjendet çelësi i qetësisë dhe lumturisë time. Shumë njerëz nuk e kanë idenë se mund t'i kontrollojnë mendimet e tyre; në fakt ti je i vetmi që mundesh, askush tjetër nuk mundet. Satani nuk mund ta kontrollojë mendjen tënde; ai do të donte shumë në fakt, por ai vetëm të jep sugjerime. Vetëm ti mund ta kontrollosh. As Perëndia nuk e kontrollon mendjen tënde pa dëshirën tënde; nëse nuk e lejon, Ai nuk e bën me forcë. Është zgjedhja jote. Tjetra është...

2. E ushqej mendjen me të vërtetën. Bibla është burimi më i saktë dhe më i besueshëm. Nëse do që jeta jote të jetë the best dhe vendimet e tua të jenë the best, atëherë duhet të mbështetesh tek Bibla që ka informacionin e duhur për jetën dhe përëndishmërinë. Jezusi tha: Njeriu nuk rron vetëm me bukë, por me çdo fjalë që del nga goja e Perëndisë.³ Bibla është ushqimi ynë shpirtëror. Por, kur duhet të ushqehem me të? Gjithë kohën! Mbreti David e lidhte Biblën me çdo pjesë të ditës. Unë zgjohem para agimit ... unë kam shpresë te fjala Jote.⁴ Ai libër është plot me shpresë, ka mbi 7.000 premtime. Nëse ndodh që po ndihesh i pashpresë, është shenjë që s'po kalon shumë kohë duke lexuar premtimet e Perëndisë. Oh, sa shumë e dua ligjin Tënd! Ai është përsiatja ime gjithë ditën.⁵ Davidi thotë "herët në mëngjes dhe gjatë ditës, jam duke menduar për Fjalën e Perëndisë." Kjo e bëri atë të quhej njeriu sipas zemrës së Zotit.

3. I largoj mendimet dëmtuese. Ka gjëra në mendjen tënde që duhen larguar, mendja jonë ka nevojë të jetë e lirë, e çliruar. Sepse disa herë ngelesh i burgosur për shkak të mendimeve të tua. Të largosh mendimet dëmtuese nuk është e lehtë sepse ke tre armiq që nuk duan që mendja jote të jetë e çliruar nga mendime negative dhe dënuese.

Natyra e vjetër është armiku i parë. A e gjen veten duke bërë gjëra që nuk dëshiron t'i bësh? Dëshirën e ke të mirë, por nuk po e bën dot. Kjo është betejë e brendshme, mes natyrës së re dhe natyrës së vjetër dhe natyra e vjetër na dëmton.

Satani, djalli, i ligu është armiku i dytë. Ai do që të kontrollojë mendjen tënde. Ai nuk mundet, por ama nuk heq dorë, përpiket. Hedh lloj-lloj idesh dhe mendimesh në kokën tënde. Satani nuk të detyron dot të bësh gjë, nëse ti je i krishterë dhe Fryma e Shenjtë është në ty, ai nuk të detyron dot. Sepse Ai që është brenda teje është më i madh se ai që është kundër teje. Por ama të jep sugjerime dhe sugjerimet e tij janë tunduese. Ai përdor njerëzit, disa herë TV, rrethanat, mediat sociale për këto sugjerimet e tij të sheqerosura ...

Martin Luteri thotë: Nuk mund t'i ndalosh zogjtë të fluturojnë mbi kokën tënde, por mund t'i ndalosh të bëjnë fole aty. Djalli do të të bezdis; nëse nuk po të bezdis, duhet parë se mos po ecën në të njëjtin drejtim me të.

Mendimet që të hedh djalli në kokë quhen tundime. Mendimet që të hedh Perëndia në kokë quhen frymëzime.

Që të mos na mposhtë Satanai, sepse ne i dimë qëllimet e tij.⁶

Cili është armiku i tretë? Vlerat që ka kjo botë, gjërat që vlerëson kjo botë. Bota, situatat rreth e qark teje, a të ndihmojnë që të

bëhesh më i perëndishëm? A ka ndonjë gjë në këtë qytet që të nxit të jesh më i perëndishëm? Me shumë gjasa, janë pak! Bota rreth e qark teje të nxit të mendosh vetëm për vete; një reklamë thotë: bindju etjes tënde; çfarë do të thotë kjo? Shfrenohu, veç shuaj etjen, veç plotësoja tekat vetes. Gjithçka që është në botë, lakmia e mishit, lakmia e syve dhe krenaria e jetës, nuk vjen nga Ati, por nga bota.⁷

Lakmia e mishit është seksi/qejfi. Lakmia e syve janë paratë/gjërat. Krenaria e jetës janë suksesi, pushteti, të jesh dikushi. Pas këtyre tre gjërave është lëshuar e gjithë bota, pas parave, seksit/qejfit dhe pushtetit. Çdo gjë rreth e qark teje të inkurajon që edhe ti këto duhet të synosh; pa këto të tria, s'bën jeta. Pra, nuk të ndihmojnë të jetosh një jetë të perëndishme, por të nxisin për krahun tjetër.

Pse të luftosh dhe të fitosh në këtë arenë? Paske natyrën e vjetër brenda vetes, ke djallin që të sulmon në mendime dhe ke botën që të rrethon. Si bëhet kjo luftë ndaj këtyre gjërave? Sepse, edhe pse ecim në mish, nuk luftojmë sipas mishit, sepse armët e luftës sonë nuk janë prej mishi, por të fuqishme në Perëndinë për të shkatërruar fortesat, që të hedhim poshtë mendimet dhe çdo lartësi që ngrihet kundër njohjes së Perëndisë dhe t'ia nënshtrojmë çdo mendim dëgjësës së Krishtit.⁸ Ky varg tregon qartë betejën që ekziston në mendje apo jo?! Çfarë është fortesa? Fortesë është një gënjeshtër që e besoj për të vërtetë! Nëse i beson gënjeshttrat dhe ia përsërit vetes, bëhen fortesa të çimentuara në mendje. Nënshtroje, testoje në bazë të asaj që ka thënë Krishti.

Si vjen mashtrimi nga i ligu? Së pari vjen dëshira (nga natyra e vjetër, nga bota përreth, nga i ligu). Pastaj vjen dyshimi (A ka

thënë me të vërtetë Perëndia...? Përderisa Perëndia më do, pse s'me lë të bëj çdo gjë që unë mendoj se më sjell kënaqësi?) Së treti, mashtrimi. Djalli në këtë moment zëvendëson të vërtetat e Perëndisë me gënjeshtat e tij. Perëndia i tha Adamit dhe Evës, dy njerëzve të parë: Nëse hani nga ky fryt ju do të vdisni. Djalli u tha: Ju nuk do të vdisni nëse e hani këtë fryt, përkundrazi, do të bëheni më seksi, ashtu më të mençur.

Perëndia u tha: “Hani çdo gjë nga ky kopsht; te ky plantacion i ke të gjitha llojet, përveç këtij frytit. Ke mijëra opsione për të zgjedhur, përveç një peme.” Po ku shkojnë ata? Si kalamajtë e vegjël, kur u thua mos, do të shkojnë të bëjnë atë për të cilën u the mos. Djalli na peshkon! Kur shkon për peshk, ti vendos diçka në grep për ta joshur, për ta tërhequr, për ta mashtruar peshkun. Peshku, peshku, hajde këtu, se të kam sjellë drekën. Kafshoje drekën; po e hëngre këtë ti do bëhesh sa një peshkaqen i madh. A kapet peshku nëse e hedh gripin në ujë pa asgjë? Jo. Pyetje: Çfarë ka vendosur Satani në “grep” për të të joshur ty, për të të tërhequr drejt mëkatit? A e kupton kur djalli po të josh, kur ai do që të biesh në grep? Cila është ajo gjë që të josh më shumë dhe ti bie në atë grep, herë pas here, pas here? Çfarë është?

Fillon si dëshirë, pastaj dyshim, pastaj mashtrim, pastaj mosbindje. Ajo që fillon si një dëshirë në mendjen tonë, kthehet në veprim. Ti je i lirë të zgjedhësh të bësh ç'të duash në jetë. Por nuk je më i lirë pasi ke zgjedhur, sepse do të korrësh bekimet ose pasojat e asaj që zgjodhe. Koha më e mirë për të fituar ndaj tundimit është kur sapo vjen si ide tek mendja jote.

4. E fokusoj mendjen te gjërat e duhura. Mbye mendjen së pari te Jezusi, çfarë kaloi Ai. Kujtoni, pra, Atë (Jezusin) që duroi një kundërshtim të tillë nga ana e mëkatarëve kundër Tij, që të mos

lodheni dhe të ligështoheni në shpirtin tuaj. ⁹ Kur të vjen të dorëzohesh, kujto Jezusin. Ai duroi, nuk hoqi dorë, nuk u dorëzua.

Mendo për të tjerët. Të mos mendojë secili për interesin e vet, por edhe atë të të tjerëve. ¹⁰ Shiko sesi ky varg bie në kundërshtim me kulturën e sotme. Sepse çdo gjë në këtë botë të nxit të mendosh vetëm për vete. Sa herë në ditë e dëgjon këtë shprehje: Unë do të bëj atë që është më e mira për mua. Kurse Jezusi e fillon ndryshe: Mos mendo vetëm për vete.” Bota nuk rrotullohet rreth teje. Ti je krijuar nga Perëndia dhe për Perëndinë. Mendo për përjetësinë. Kjo do të sjellë ndryshim në shëndetin mendor. Kjo jetë ka më shumë sesa kjo që shikojmë. Nuk mbaron me kaq. Jeta është e përjetshme, është e pafundme me Perëndinë. Kjo e ndryshon dhe e qetëson të menduarit tonë. Kini në mendje gjërat që janë atje lart (ne qiell), jo ato që janë mbi tokë. ¹¹ Si do të jetë atje lart, në qiell? Ato gjëra që syri nuk i ka parë dhe veshi nuk i ka dëgjuar dhe nuk kanë hyrë në zemër të njeriut, janë ato që Perëndia ka përgatitur për ata që e duan Atë. ¹²

Ushqeje mendjen me të vërtetën e Perëndisë çdo ditë. Largoji mendimet dëmtuese. Fokusohu te gjërat e duhura. Perëndia na ka dhënë një dhuratë të madhe, mendjen tonë; kuptoje se ajo është si arenë e madhe, si fushëbetejë mes natyrës së vjetër, Satanit dhe botës. Por do t’ia nënshtrojmë çdo mendim fjalës së Krishtit, asaj që thotë Ai, sepse duam të fitojmë çdo betejë, së pari aty.

Për T'u Menduar

- E sigurt se për mendjen ka shumë për të folur, por nga 1 deri në 10, sa e rëndësishme të duket ty kjo gjë: a kanë rëndësi mendimet që lejon të hyjnë në mendjen tënde?
- Cilën nga këto e kishe dëgjuar më parë; cila ishte e re?
- Çfarë është diçka, që ti tani e di se është gënjeshtër, por për shumë vite e ke besuar si të vërtetë?
- A ka ndonjë gjë nga media sociale që ti e di se nuk po të ndihmon, madje po të dëmton: video që poston X person, account në TikTok, Instagram ose platforma të tjera?
- Ndoshta nuk është aq e lehtë, por nga do e filloje, cilën nga këto do të zbatoje më parë?

Vazhdon tek dita tjetër: Të lumtë, shërbëtor i mirë dhe besnik; ti u tregove besnik në gjëra të vogla, Unë do të të vë mbi shumë gjëra; hyr në gëzimin e Zotit tënd. ¹³



**“Jepni duart për
të shërbyer dhe
zemrat për të
dashur.”**

– NËNË TEREZA

DITA 23

SHËRBESA

Dua Të Bëj Diçka ...

Dua të bëj diçka, dua të shërbej diku, të bëj diçka për dikë, t'ia lehtësoj jetën dikujt. Ja çfarë thotë Bibla për këtë: Ne në fakt jemi vepra e Tij, e krijuar në Krishtin Jezus për veprat e mira që Perëndia përgatiti që më parë, që ne të ecim në to. ¹ Së pari, ta dish se ti je vepra e Tij, je kryevepra e Perëndisë, je bërë me duart e Tij, por për të bërë diçka, jo vetëm për të marrë. Perëndia të krijoj që të sjellësh ndikim, ndryshim me dhuntitë, me pasionin, me aftësitë, personalitetin dhe përvojat e jetës sate. Këto të pesta përdor Perëndia për të na formuar që t'i shërbejmë Atij dhe pastaj thotë: Gjithsecili le ta vërë në shërbim të tjetrit dhuntinë që ka marrë...² Përse na i ka dhënë Perëndia dhuntitë? Që t'i shërbejmë njëri-tjetrit, të përfitojnë të tjerët diçka përmes asaj që ti je dhe ke.

Ka njerëz që duan t'i shërbejnë Perëndisë por nuk duan t'u shërbejnë të tjerëve. Por nuk e bën dot këtë gjë. E vetmja mënyrë sesi mund t'i shërbesh Perëndisë është duke u shërbyer të tjerëve. Perëndia nuk ka trup fizik, nuk ka nevoja fizike; Perëndia adhurohet, Atij i lutemi dhe kërkojmë prej Tij, i japim falenderime dhe lëvdime me fjalë e me këngë, por kur thua “dua t'i shërbej Perëndisë”, çfarë kuptimi ka përveçse, t'u shërbej njerëzve në emër të Tij? U tregoj atyre sesa shumë i do Perëndia nëpërmjet fjalëve ose gjërave që bëj për ta. Prandaj nuk ka kuptim kur thua: dua t'i shërbej Perëndisë, por jo njerëzve.

Sa herë që ti përdor dhuntitë, talentet, përvojën tënde për të ndihmuar dikë quhet shërbim ose shërbesë! Lajmi i mirë është ky: Perëndia jo vetëm që na krijoj për të shërbyer, por për ta lehtësuar

punën, Ai na dha modelin. Ai vetë erdhi në tokë dhe tha: Ja si duhet të shërbeni. Më shikoni Mua dhe bëni ashtu siç do të bëj Unë. Këtë gjë bëri Jezusi; Ai tha: Biri i njeriut nuk erdhi që t'i shërbejnë, por për të shërbyer. ³ Le të shikojmë disa mënyra; të shërbes si Jezusi do të thotë...

1. Të jesh i gatshëm. Jezusi po ecte rrugës për Jeriko dhe disa burra të verbër filluan t'i thërrisnin me të madhe. Dy të verbër ... filluan të bërtasin: 'Ki mëshirë për ne' ... Jezusi ndaloi, i thirri dhe tha: 'Çfarë doni të bëj për ju?' ⁴ Jezusi ndaloi! Nëse do që t'i shërbes Perëndisë, duhet të jesh i gatshëm për ta ndaluar atë që po bën, të jesh i gatshëm të ndërpritesh. Shumica e shërbesës së Jezusit ishte në momente ndërprerje. Ai shëroi: burrat e verbër, një të çalë, njerëzit e sëmurë, të paralizuarit, një fëmijë të vdekur të cilin e ringjalli... të gjitha ndodhën kur Jezusin e ndërprejnë nga ajo që po bënte. Mrekullia e parë, e ndërprente ndërsa ishte në dasmë. Çohu dhe hajde se kam një muhabet. - i tha e ëma. - Nuk ka verë dhe marketi i lagjes është mbyllur; si do t'ia bëjmë? Jezusi bëri mrekulli, ktheu ujin në verë. Dhe kjo më lart, shërimi i të verbërve, është mrekullia e dytë në radhë, Jezusi po ecte rrugës për në Galile dhe e ndërprente rrugës. Si thotë vargu? Jezusi Ndaloj.

Jezusi ishte i gatshëm të ndërpritej nga dikush, ishte i gatshëm për të ndaluar. Bibla thotë: Mos i thuaj të afërmit tënd 'Shko dhe kthehu; do të të jap nesër', kur e ke me vete (tani) gjënë e nevojshme. ⁵ Ka shumë njerëz të lënduar, ka njerëz me nevoja të ndryshme rreth e qark teje. Çfarë po të pengon që të bësh diçka për ta? Ne themi se duam të shërbejmë, duam që Perëndia të na përdorë. Ka shumë gjasa që shërbesat më të mëdha janë rreth e qark teje, ndaj njerëzve që të rrethojnë në një ditë të zakonshme.

2. Të jesh falënderues. Atë që e bën, e bën me mirënjohje, me qëndrim falenderues. Te ungjilli i Gjonit, kapitulli 11, Jezusi shërbeu në një mënyrë të tillë. Shoku i tij Llazari kishte vdekur dhe Jezusi shkoi te shtëpia e tij; njerëzit menduan se kishte shkuar për funeral, për të bërë qokën, por Jezusi kishte diçka tjetër në mendje. Ai ishte aty për të shërbyer, për ta ringjallur Lllazarin nga vdekja. Dhe mund të kishte shkuar aty, të thoshte dy fjalë dhe Llazari do të ringjallej. Por jo, Ai vendosi të lutej me zë të lartë që ne ta lexojmë edhe sot lutjen e Tij, dhe ja se çfarë u lut: Jezusi i ngriti sytë lart dhe tha: ‘O Atë, të falënderoj që më ke dëgjuar. Unë e dija mirë se Ti gjithnjë më dëgjon, por i kam thënë këto për turmën që është përreth...’⁶

O Atë, të falënderoj. Ai e filloi me mirënjohje. Këtë lloj qëndrimi kishte Jezusi. Apostulli Pal ishte falenderues gjithashtu. Ai tha: Falënderoj Jezus Krishtin që më besoi këtë shërbesë që po bëj. Bibla flet shpesh për qëndrimin falenderues kur shërben. I shërbeni Zotit me gaz, ejani para Tij me këngë gëzimi.⁷

Përse t’i shërbej Perëndisë me falenderim? Për çfarë duhet të jem mirënjohës? Sepse Ai na ka dhënë jetë me anë të Jezus Krishtit, na ka shpëtuar. Sikur vetëm kaq të kishte bërë, do të mjaftonte për të qenë falenderues për gjithë jetën. (Perëndia) Na shpëtoi dhe na thirri me një thirrje të shenjtë, jo sipas veprave tona, por sipas qëllimit të Tij...⁸ Ai na shpëtoi dhe për t’ia kthyer me mirënjohje dhe falenderim ne i shërbejmë Atij, duke bërë diçka për njerëzit e Tij.

Mund të shërbesh, të bësh gjëra për arsye të gabuara dhe çelësi është mirënjohja. Kur harron të falenderosh Perëndinë për mundësinë që të dha për të shërbyer, kur nuk falenderon njerëzit me të cilët po shërben, kjo është shenjë që po të ngatërrohen motivet. Ndoshta s’e

kupton direkt se cili është motivi i gabuar, por shenja është dhënë, dhe është kur harron të jesh falenderues. Le të kemi motivin e duhur pse i shërbejmë Perëndisë dhe të shërbejmë me gatishmëri dhe mirënjohje ndaj çdo personi që sjell Ai në rrugën tonë.

3. Të jesh besnik. Çfarë do të thotë? Do të thotë “mos u dorëzo, por vazhdo të ndihmosh dhe të bësh diçka për dikë.” Kur je në shkollë, ti s’e lë provimin përgjysëm. Kur je në punë, nuk e lë ditën e punës përgjysëm. Jezusi nuk e la përgjysmë shërbesën që nisi. Në ditët e fundit të jetës së Tij në tokë, Jezusi tha: Unë të kam përlëvdur mbi tokë; Unë e kam kryer veprën që më ke dhënë të bëj.⁹ Do të doja që secili prej nesh ta thoshte këtë kur të jetë para Perëndisë. Perëndi, unë e kreu punën që më dhe. Jezusi ishte besnik në shërbesën e Tij. Ai nuk u dorëzua. Nuk hoqi dorë, nuk u tërhoq. Ai këmbënguli deri në fund. Nëse edhe ti do që të jesh si Jezusi, do të thotë se do të shërbesh derisa të jesh gjallë. Kur plakesh del në pension, por me shërbesën asnjëherë nuk del në pension. Sepse Perëndia do që të shërbesh sa je gjallë.

E tjetra që kërkohet nga administratorët është që secili të gjendet besnik.¹⁰ Çfarë na motivon të qëndrojmë besnikë ndaj Perëndisë për afat të gjatë? Dijenja se Ai shikon dhe do të na shpërblejë për çdo mundim tonin. Qëndroni të fortë e të patundur duke tepruar përherë në veprën e Zotit, duke e ditur se mundi juaj nuk është i kotë në Zotin.¹¹ Nuk është i kotë asnjë lloj mundi; asgjë nuk është e kotë kur e bën për Perëndinë.

Tregohej një histori: Para shumë vitesh në Amerikë, dy adoleshentë u nisën për të shkuar në kishë, por atë ditë kisha ishte rrafsh dhe nuk kishte vend për t’u ulur dhe ata u nisën për të ikur. Por një nga personat te mikpritja u tha: Pse po ikni, ja t’jua gjej unë një vend menjëherë. Dhe diku aty nga mesi, u gjeti një vend. Atë natë të dy

këto çuna i besuan Jezusit për herë të parë. Një nga këta ishte Billy Graham, ungjilltari i madh që ndërroi jetë para pak vitesh. Gjatë jetës së tij ka ndihmuar miliona njerëz të vijnë te Jezus Krishti. A ke menduar ndonjëherë kjo që po bëj unë është gjë e vogël? Nganjëherë nuk e kemi idenë sesa vlerë dhe sa të rëndësishme janë gjërat e vogla që bëhen me dashuri të madhe.

Nuk ka rëndësi nëse po bën diçka në skenë, pas skene, në kishë, jashtë kishë, e pa njeri, s'e pa njeri atë që bëre. Por Ati Perëndi shikon, dhe përsa kohë Ai shikon, çdo gjë ka rëndësi.

Perëndia do që të bëjë gjëra të reja dhe të bukura nëpërmjet teje. Ka biznese dhe organizata që japin vlerësime për 10 vite punë me besnikëri. Imagjino sa shumë do të vlerësohesh në qiell? Të lumtë, shërbëtor i mirë dhe besnik; ti u tregove besnik në gjëra të vogla, Unë do të të vë mbi shumë gjëra; hyr në gëzimin e Zotit Tënd.¹² Unë dua që këtë të thotë Perëndia për mua dhe për ty një ditë: Të lumtë! Ti bëre atë për të cilën të vura në tokë. Hyr dhe kënaqu me Mua në përjetësi, shijo shpërblimet që kam përgatitur për ty. Dua shumë që këtë të thotë Perëndia për secilin prej nesh.

Kështu që nëse po shërben, bëje me gatishmëri, me mirënjohje, me besnikëri. Vazhdo dhe falenderoje Perëndinë për çdo mundësi shërbimi.

Për T'u Menduar

- T'i shërbesh Perëndisë do të thotë t'u shërbesh njerëzve; a e kishe menduar ndonjëherë kështu? __ Po __ Jo
- Cila nga këto të duket më e lehta? Po më e vështira?
- A do të radhitësh pengesa të tjera që të vijnë në mendje, që të pengojnë të shërbesh me gatishmëri, me mirënjohje dhe me besnikëri?
- A ke dëshirë që të bësh diçka që sot, por s'di nga t'ia fillosh? Nëse ke dëshirë, thjesht ndiq këtë QR më poshtë dhe dikush nga stafi i ICF Tirana do të të kontaktojë personalisht për të të sugjeruar sesi mund të përfshihesh në gjërat që po bëjmë ose për të të dhënë ide të reja.



Vazhdon tek dita tjetër: Edhe sikur të ecja në luginën e hijes së vdekjes, nuk do të kisha frikë nga asgjë e keqe, sepse Ti je me mua.



**“Dyshimi vret
shumë më shumë
ëndrra sa ç’vret
dështimi.”**

– SUZY KASSEM

DITA 24

DYSHIMET DHE BESIMI

Kam Shumë Dyshime, A Është Normale?

Tani, ti e fillove udhëtimin shpirtëror të kësaj jete të re, me Zotin Jezus si të parin e saj. E pranove që Perëndia të do pa kushte, zgjodhe me vullnet të lirë të besosh që Jezusi me vdekjen e Tij në kryq të pajtoi dhe të bashkoi me Perëndinë dhe çdo gjë bëhet e re. E shkuara jote pastrohet, e sotmja merr kuptim, e ardhmja sigurohet. Dhe lutesh, kërkon në emrin Jezus dhe Zoti përgjigjet siç të ka premtuar. Por si rritet besimi yt nga këtu e më tej? Po kur lutesh dhe Perëndia nuk të përgjigjet, madje të duket i largët? Po kur ndodhin gjëra jo të mira? Mund të të ndodhin ty, ndodh diçka në familjen tënde, rreth e qark teje ose në botë? I ligu do që të luajë me mendimet e tua kur kalon sfida dhe një nga pyetjet e shpeshta që do të të bëjë është: “Po ku është Perëndia, pse të ndodhi kjo gjë ty? Ky është Zoti yt?”

Në këtë fazë të jetës, ajo që të rrit më shumë nuk janë vetëm gjërat që bën Zoti për ty, por janë zgjedhjet që po bën ti përditë për ta nderuar Atë, edhe kur s’i kupton gjërat që ndodhin rreth e qark teje, edhe kur nuk e ndjen praninë e Perëndisë aq fort. Sepse Bibla e thotë: do të kalosh sprova ¹ dhe ato sprova Perëndia do t’i përdorë për të të forcuar ty; do të bëjë që në çdo lloj rrethane gjërat të bashkëveprojnë për mirë për ty. ²

Siç ndodh rritja fizike, ashtu ndodh dhe rritja dhe forcimi shpirtëror. Kur je bebe, gjërat i merr gati, të ushqejnë prindërit dhe ti ke tri gjëra për të bërë: për të ngrënë, për të mbushur pampersat dhe për të fjetur gjumë, kaq. Por ndërsa rritesh, fillon dhe merr përgjegjësi, guxon dhe ecën vetë, hedh hapa, pastaj flet dhe kërkon atë që ke nevojë. Ndërsa rritesh, shkon vetë për ta

marrë ushqimin; pastaj ndërsa rritesh më shumë, e gatuan dhe e përgatit vetë. Kur arrin në moshë madhore, duhet të punosh që ta fitosh, ta përgatitësh dhe pastaj të ushqehesh vetë; pak më tej, të sigurosh për të ushqyer edhe familjen. A e dyshon një fëmijë kujdesin e prindit ndërsa rritet? Jo, e konsideron pjesë të jetës, pjesë të rritjes.

Edhe në rritjen frymërore, kur je foshnjë nga ana frymërore, ti merr çdo gjë gati nga ai/ajo që të foli, që kujdeset, që lutet për ty, nga ai/ajo që të nxit të vish në kishë, në familje për t'u ushqyer bashkë në gostinë që shtrohet aty. Por ndërsa rritesh, ke nevojë të ushqehesh vetë, ta lexosh Biblën vetë; ndërsa rritesh, arrin të kuptosh edhe se çdo gjë e mirë, e keqe, e bukur, e shëmtuar, fitore ose humbje... të gjitha shkrihen në planin e Perëndisë për jetën tënde, të Perëndisë që është në kontroll.

Krahasimi që dua të bëj me sfidat dhe rritjen është me një pemë. Nëse një pemë e rrit në një vazo të madhe, e rrit me të gjitha kushtet, por një ditë e nxjerr jashtë dhe do t'i duhet të përballet me erën, me të ftohtët, me të nxehtin, me shiun, me të gjitha. Nëse ajo nuk është gati, dëmtohet dhe thahet, sepse është mësuar t'i marrë gjërat gati; nuk i kanë ardhur gradualisht sfidat, por të gjitha njëherësh dhe nuk ka forcë për t'i përballuar. Kurse pema e mbjellë jashtë, në majë të një kodre, duhet të përballet me erën, kështu që rrit rrënjët për të përballuar presionin e erës, i hedh të thella sepse duhet edhe të kërkojë ujë ose zona me lagështirë për t'u rritur. Ndërsa kalojnë ditët, një me diell, një me shi, një me erë, një me borë, një me breshër, ajo fuqizohet më shumë.

E njëjta vlen për secilin prej nesh: do të ndodhesh para dy zgjedhjeve kur të fillojnë sfidat e jetës:

A. Do të mendosh si foshnjë: Pse po më ndodh kjo gjë mua, pse nuk e kam këtë, atë, pse të tjerët i kanë ato gjëra e unë jo; pse Zoti nuk po më përgjigjet siç e prisja unë të përgjigjej? Nëse mbushesh dhe i lejon këto dyshime në mendjen tënde, do të të shtohet pasiguria dhe do të ngelesh i brishtë, me frikëra, me pasiguri: A më do Perëndia; a po i bëj gjërat siç duhet; mos po më dënon sepse thashë këtë, bëra atë, s'bëra atë tjetrën?

B. Do të mendosh si i rritur: “Kjo është jeta. Jezusi tha: ‘Në botë do të keni mundime, por merrni zemër, Unë e munda botën.’”³ Mua më mjafton prania e Tij, më mjafton që kam Biblën për t’u ushqyer, më mjafton që kam Frymën e Shenjtë, më mjafton që kam kishën time, komunitetin që më mbështet dhe lutet për mua. Sfidat e jetës do t’i kaloj një e nga një, sepse e di që këto sfida do të më forcojnë më shumë. Kur kaloj gjërat të bukura, do të festoj, do të lavdëroj Perëndinë, do ta ndaj me të tjerët gëzimin. Kur kaloj sfida, s’do të heq dorë, do të qëndroj fort sepse e di përfitimin që vjen pas tyre.” Kam parë dy grupe besimtarësh – këtë qershor bëra 30 vite që ndjek Jezusin, sigurisht që kam parë dhe kam takuar shumë dhe lloj-lloj personash. Ka njerëz që janë larguar nga besimi, madje nuk po ecin me Zotin sepse jeta u vështirësua dhe Perëndia nuk po përgjigjet siç prisnin ata. Por kam takuar dhe shuumë të tjerë që janë afruar më fort me Zotin dhe i kanë kaluar sfidat një e nga një me Të.

Ja të bëj një lidhje të fundit me tre ushqime: veza, karota dhe kafeja. Këto të treja, kur kalojnë në ujë të nxehtë, reagojnë ndryshe. Në këtë rast, uji i nxehtë, simbolizon sfidat e jetës. Veza është e lëngët, por kur kalon në ujë të nxehtë bëhet e fortë. Te karota shohim të kundërtën: kur kalon në ujë të nxehtë, qullet,

zbutet. Kurse kafeja, kur kalon në ujë të nxehtë, lëshon aromë dhe bëhet super.

Ka njerëz që si veza, e kanë zemrën të butë ndaj Perëndisë dhe të çiltër, por sa kalojnë sfida e ngurtësojnë atë. Ka njerëz si karota, e kishin zemrën të fortë, por sfidat ua zbutën zemrën ndaj Perëndisë; duan të dinë më shumë për Të. Ka edhe njerëz si kafeja, që kur kalojnë sfida, lëshojnë aromë të mirë, e nderojnë emrin e Zotit në çdo kohë dhe të tjerët e ndjejnë aromën e mirë që lëshojnë në kohë sfidash.

Unë i kam kaluar pothuajse të tre modelet këto tridhjetë vite me Zotin. Ka patur raste që kam dyshuar praninë e Perëndisë dhe jam ngurtësuar. Ka patur raste që kam qenë i ftohtë dhe i ngurtësuar dhe Ai ma ka zbutur zemrën. Ka patur edhe raste që e kam nderuar Atë pavarësisht çdo rrethane.

Vetëm në tetë vitet e fundit kemi patur shumë sfida si familje:

Vjehrra ime e mrekullueshme, njeri me një zemër fantastike dhe të dashur, sëmuret me një sëmundje të rrallë dhe ndërron jetë brenda një viti. Mami im – imagjino si janë çunat pas mamave, unë isha herë dhjetë pas simes – sëmuret dhe brenda njëzet e katër orësh ndërron jetë. Pastaj motrës sime të dytë i kthehet sëmundja që kishte patur pesë vite më parë dhe vuan njëzet e tre muaj me operime, ilaçe, rreze, kimio etj etj. Ndërkohë babi aksidentohet dhe brenda pak ditësh ndërron jetë. Pas pesë muajsh, motra që ishte semurë ndërron jetë. Para pak kohësh, djali i madh pati tre aksidente brenda vitit. E ç'të them tjetër? Nuk po përmend gjërat e tjera, sfidat me njerëzit, kritika, sulme nga kundërshtarë dhe keqdashës.

Si familje ishim para dy sfidave: ta dyshojmë praninë e Perëndisë, mbrojtjen e Tij, ta mohojmë Atë dhe të vazhdojmë jetën pa Të sepse Ai nuk bëri gjërat siç ia kërkuam ne dhe nuk i bëri gjërat kur mendonim ne se na duheshin. Apo do të themi si Davidi:

Edhe sikur të ecja në luginën e hijes së vdekjes, nuk do të kisha frikë nga asgjë e keqe, sepse Ti je me mua.⁴ Bëmë të dytën. Kur luteshim, kaq thoshim: “Zot, ne e dimë se Ti je me ne ndërsa po kalojmë në luginën e hijes së vdekjes mes kaq shumë sfidash, dhe neve kaq na mjafton të dimë. Sigurisht, kishim familjen ICF Tirana, që lutej dha na mbështeste në shumë forma, kishim fuqinë e Frymës dhe premtimet e Shkrimit.

Por shiko se nuk na kanë ndodhur vetëm ato gjëra këto vite. Këto tetë vitet e fundit kanë qenë vite kur kanë ndodhur shumë e shumë gjëra të bukura. Gjërat që po bënim ne, kisha ICF Tirana, qendra e fëmijëve me nevoja të posaçme, rrjeti i kishëmbjelljes etj etj pësuan një vrull, një rritje të madhe në mes të sfidave. Zoti na ka dhënë favor, në të njëjtët tetë vite, mundësi të reja dhe bekime që nuk na e priste mendja.

Por më e veçanta ka qenë sesi Perëndia na ka dhënë dashuri dhe përkujdesje nga familja ICF Tirana, sa shumë miq janë lutur për ne, janë kujdesur, na kanë ndihmuar në forma të ndryshme. Mbaj mend një mëngjes të veçantë, super të veçantë. Isha në një konferencë në Zyrih dhe atë mëngjes, para se të shkoja te konferenca, ndjeja boshllëkun e vdekjes së mamit dhe një farë dyshimi: Mos nuk e pranoi Jezusin; mos e bëri lutjen e shpëtimit për të më bërë qejfin mua; a do të jetë mami im në qiell?” Se përse duhet t’i kisha ato mendime atë ditë, nuk e di. Por dhimbja kështu është, si dallgët; vjen të trazon, pastaj tërhiqet për ca kohë,

kthehet përsëri. Atë ditë kishte dallgë; mami kishte 4 muaj që kishte ndërruar jetë. Dhe sapo filloi sesioni i parë, folësi, që unë s'e kam takuar asnjëherë personalisht, u drejtua nga ana ku isha ulur unë dhe tha: Dua të lutemi për dikë që ka humbur një person të dashur dhe ka dyshime nëse ajo është me Zotin apo jo. Nëse je ti ky person, ngri dorën. Unë pashë një herë vërdallë, nuk e ngriti njeri, dhe dukej se ishte mesazh për mua. Ngrita dorën. Dhe ai tha: Kam një mesazh nga Perëndia. Ai të thotë 'personi që ti do shumë është këtu me Mua. Ai person dhe Unë të duam shumë.' Dhe u kërkoi atyre që ishin rreth e qark meje të luteshin për mua. Uaaa ishte një super ndjesi; m'u largua gjithë boshllëku, dyshimi, m'u mbush zemra plot me dashurinë dhe praninë e Perëndisë. Edhe sot pas 6 vitesh më mbushen sytë me lot kur e kujtoj. Ky ishte përjetim shumë i fortë. Perëndia ka përdorur secilin prej miqve dhe njerëz që nuk i njihnim për të na ngushëlluar dhe për të forcuar zemrën tonë.

Unë lutem dhe uroj që jeta jote të jetë e lehtë, veç me bekime dhe me favor nga Perëndia, vetëm me gjëra të mira; kalofsh nga e mira në gjëra akoma më të mira. Por kur lexon Psalmet në Bibël, nuk duket ashtu. Psalmet janë në mes të Biblës dhe unë të nxis shumë që t'i lexosh, të pakën një ose dy në ditë. Gjithë përmbledhja e njëqind e pesëdhjetë kapitujve është: Jeta është e vështirë, e padrejtë, por Zoti është i mirë.

Zoti është i mirë, është aty me ty; ka premtuar se do të jetë me ty, madje më afër teje kur kalon situata që ta thyejnë zemrën. Ai e mban fjalën; e ndjejmë ose jo, është aty me ne. Dhe do të jetë duke na mbrojtur, duke na mbajtur, duke na fuqizuar, duke na bekuar, duke na dhënë favor, duke hapur dyer që s'e dinim që ekzistonin. Dhe ne, ti, unë, të gjithë bashkë, le të na gjejë duke i

dhënë lavdi, duke u varur tek Ai, duke lëshuar aromë të mirë si kafeja ndaj atyre që kemi përreth.

Nëse ka një moment që Zoti është më afër teje, është kur e ke zemrën të thyer⁵ sepse e ka premtuar që do të jetë afër në ato ditë. Tregohu i mençur, mos bjer pre e ideve që mund të hedhë i ligu në mendjen tënde, por kapu pas premtimeve të Perëndisë në ditë të mira dhe në ditë të vështira, dhe procesi i rritjes do të vijë shumë i natyrshëm dhe shumë më i lehtë. Dhe t'i vazhdon të rritesh në masën e Krishtit, në ngjasim me Të, rritesh në njohjen dhe në përjetime me Të.”³ Edhe një ditë dhe udhëtimit tonë po i vjen fundi. Si ndihesh, si ka qenë ky udhëtim për ty deri më tani?

Për T'u Menduar

- A ke kërkuar, a je lutur në emrin Jezus, çfarë ka bërë Ai për ty? A do të ndalosh një moment dhe t'i numërosh?
- Në cilën fazë të jetës je: gjërat po shkojnë shumë mirë, je mes një sfide apo sapo e ke kaluar një furtunë?
- Si e ke zemrën, çfarë qëndrimi ke, po të forcohet, po të zbutet apo je duke lëshuar aromë të mirë?
- A do të ndalosh tani dhe të sjellësh para Perëndisë një sfidë që po kalon; nëse s'ke sfida, a do të ndalesh për ta falenderuar Perëndinë për një minutë, vetëm me fjalë falenderimi?

Vazhdon tek dita tjetër: Perëndia përdor njerëz të zakonshëm për të bërë gjëra të jashtëzakonshme.

**“Të gjithë njerëzit
e Perëndisë janë
të zakonshëm,
por bëhen të
jashtëzakonshëm
nga qëllimi që Ai
u jep atyre.”**

– OSWALD CHAMBERS

BONUS

DITA 25

TI JE I JASHTËZAKONSHËM

Kë përdor Perëndia për të ndikuar dhe ndryshuar botën?

Nuk jam rritur në kishë, as nuk kishim të krishterë në familjen tonë; jam rritur në luginën e Shëngjergjit të Tiranës, mes maleve, në një familje të varfër me pesë motra. Por ama, që kur zgjodha t'i besoj Jezusit në qershor '93, e kuptova se Perëndia mund të më përdorte mua, pikërisht mua. Afërsisht një muaj pasi u ktheva nga ushtria, Perëndia filloi të më përdorte për të shkuar nëpër fshatrat e zonës, për t'u mësuar fëmijëve dhe të rinjve Lajmin e Mirë të Jezus Krishtit, për të filluar grupe, projekte dhe kisha të reja nëpër fshatra.

Sa drojë, turp që kisha në fillim kur ndaja Lajmin e Mirë! Mba mend kur po ndaja me disa të rinj në një fshat që quhet Vërri dhe në fund u thashë: A doni t'i besoni Jezusit që tani? Ata thanë: Po, çfarë duhet të bëjmë? Ngriva, nuk e prisja, sepse unë po flisja gjithë drojë, po më mbahej goja, mek-mek; e sigurt që nuk ua shpjegova Lajmin e Mirë ashtu si do të doja, por ata thanë: Po, duam t'i besojmë Jezusit.

Në moment u luta bashkë me ta dhe ata përsëritën me mua atë që quhet "lutja e shpëtimit". Zoti i ndryshoi ata çuna, por më ndryshoi edhe mua. Pashë se Perëndia mund të më përdorte me gjithë mend dhe që në atë moshë, njëzet vjeç, vetëm një gjë doja: të ndaj Lajmin e Mirë dhe t'i shërbej Perëndisë në këtë mënyrë. Edhe pse kisha turp të flisja para njerëzve, ndjeva shtysën nga Perëndia: prediko, mësoji, shpjegojua Lajmin e Mirë me fjalë sa më të thjeshta. Dhe këtë kam bërë për tridhjetë vite të jetës sime.

Por kishte momente, sidomos në fillim, kur moshatarët, komshinjtë, të afërmit thoshin: “Ti po na flet neve për Jezusin, por a nuk pinim dhe deheshim bashkë kur ishim në shkollë? Komshiu thoshte: “Po a nuk ishte ti ai që vidhte perimet te bahçja ime?” Tjetri thoshte: “Po a nuk ishte ti ai që theu xhamat e shkollës dhe mbushi muret me fjalë të pista? Një tjetër: “Po nga dole ti, ti je çuni i filanit, ne e njohim babin tënd.” Një tjetër akoma: “Po ti nga katundi je; si mund të fillosh kishë në kryeqytet? Ti je kështu, ti je ashtu, ti s’ke, ti s’je, ti s’di, ti s’mundesh...”

Është e njëjta histori me të gjithë ata që ka përdorur Perëndia. Edhe ata që sot njihen si heronjtë e besimit, listën me emrat e të cilëve e gjen tek libri i Hebrenjve kapitulli 11.

Ata ishin njerëz të zakonshëm, njerëz të thjeshtë, madje edhe me vese; asnjëri nuk ishte i përsosur sipas asaj që mendojmë ne sot. Ja t’i radhis disa nga ata: Abrahami ishte shumë i vjetër dhe gënjeu dy herë. Sara, gruaja e tij, qeshi kur dëgjoi premtimin e Perëndisë dhe pastaj e mohoi që qeshi. Jakobi gënjeu, mashtroi, por edhe e mashtruan. Noeu u deh dhe i vuri të tjerët në siklet. Jozefin e abuzuan dhe e shitën. Moisiut i mbahej goja, madje vrau një egjiptas. Samsoni shkonte pas grave. Gideoni ishte frikacak. Rahabi ishte prostitutë. Elia kaloi në depresion. Davidi kreu tradhti bashkëshortore dhe ishte bashkëpunëtor në një vrasje. Jona iku larg Zotit. Jeremia ishte shumë i ri. Naomi ishte e ve. Gruaja samaritane kishte patur shumë divorce. Dishepujt e Jezusit i zuri gjumi duke u lutur në një natë shumë kritike. Pjetri ishte impulsiv dhe e mohoi Jezusin. Marta shqetësohej shumë. Sauli (Pali) ishte terrorist, persekutonte dhe burgoste të krishterët e parë. Dhe të gjithë këta dhe shumë si këta, Perëndia i përdori fuqishëm. Po ti çfarë justifikimi ke, pse nuk mund të të përdorë Perëndia ty?

Le të shikojmë nga jeta e Noeut katër karakteristikat e personit që përdor Perëndia. Dhe tani Zoti pa që ligësia e njerëzve ishte e madhe mbi tokë dhe që tërë synimet e mendimeve të zemrës së tyre nuk ishin gjë tjetër, veçse e keqja në çdo kohë. Dhe Zoti u pendua që kishte krijuar njeriun mbi tokë dhe u brengos për këtë në zemër të Vet. Kështu Zoti tha: ‘Unë do të shfaros nga faqja e dheut njeriun që kam krijuar, duke filluar nga njeriu deri te kafshët, te rrëshqanorët, te zogjtë e qiellit, sepse pendohej që i kam bërë.’ Por Noeu gjeti hir në sytë e Zotit. Noeu ishte një njeri i drejtë dhe i patëmetë midis bashkëkohësve të tij. Noeu eci me Perëndinë.¹ Perëndia pa në tokë dhe gjeti një njeri që mund ta përdorte. Po përse Noeun?

1. Noeu ishte i gatshëm për t’iu bindur Perëndisë. Mes mijëra a miliona njerëzish, Perëndia mundi të gjente vetëm një person të gatshëm. A je ti i gatshëm? A i ke thënë Perëndisë “unë jam gati të bëj çfarëdo që të më kërkosh, kudo që të duash Ti? Unë jam gati!” Apo e ke mendjen te mangësitë e tua, turpi, frika, pasiguritë, problemet që mund të dalin rrugës, “po sikur kështu, po sikur ashtu?”

2. Noeu guxoi të ishte ndryshe. Noeu ishte një njeri i drejtë dhe i patëmetë midis bashkëkohësve të tij, Noeu eci me Perëndinë.² Noeu s’e kishte problem të ishte ndryshe nga të tjerët, kur të tjerët e tregonin me gisht. Nuk kishte frikë kur vetëm ai bënte gjënë e duhur. Nuk e vriste mendjen çfarë mendonin të tjerët. Ai nuk priste të merrte miratimin e të tjerëve.

Në këtë moment në historinë e botës, shoqëria ishte zero nga ana morale, kishte korrupsion, dhunë, imoralitet, ishte llum i gjallë. Por Noeu nuk ndikohej fare nga këto gjëra. Megjithëse ai jetonte në një shoqëri të tmerrshme, ai ishte i patëmetë midis njerëzve të kohës së

tij. Dhe nuk e kishte problem që ishte vetëm ai i tillë. Frika e njeriut është si një lak.³ Kjo do të thotë, nëse ti shqetësohesh çfarë thonë të tjerët, nuk mund të jetosh jetën që do Perëndia prej teje. Çfarë i dha forcë Noeut që të ishte ndryshe nga të tjerët për shumë vite? Ai eci me Perëndinë.⁴ Ai kishte miqësi me Perëndinë dhe kjo miqësi i jepte forcë. Nëse po ndien frikë ose presion nga ajo që po thonë të tjerët, kjo është shenjë që miqësia jote me Perëndinë po dobësohet. Ky është personi që mund të përdorë Perëndia.

3. Noeu e ndoqi plotësisht. Noeu veprroi ashtu, bëri pikërisht të gjitha ato që Perëndia i kishte urdhëruar.⁵ Nuk thuhet se Noeu i bëri disa gjëra sipas kokës së vet, disa sipas asaj që i tha Perëndia, por të gjitha. Bindja është thujtë e njëjta fjalë me besimin. Ti thua: Unë kam shumë besim. Sa shumë i bindesh Perëndisë pa bërë pyetje? Sepse kjo kërkon besim. Besim është të ndjekësh udhëzimet edhe kur s'të duken logjike.

Projekti që i dha Perëndia Noeut nuk dukej logjik fare. Deri në kohën e Noeut s'kishte rënë kurrë shi mbi tokë. Toka vaditej me vesë. E gjithë atmosfera ishte ndryshe nga kjo që kemi tani. Ja ku është Noeu duke ndërtuar një arkë në mes të fushës! Ka gjasa që ta kenë pyetur: Çfarë po bën? Noeu: Po ndërtoj një arkë sepse do të bjerë shi. Ata do ta kenë pyetur çfarë ishte shiu. S'e kishin idenë si ishte shiu. Jo vetëm që nuk kishte rënë shi kurrë, por Noeu ishte pothuajse 1.000 km larg Detit Mesdhe. Si do ta çonte ky njeri arkën deri në det? As kjo nuk kishte pikë kuptimi. Por gjëja më e vështirë në botë ishte si do i mblidhte Perëndia të gjitha kafshët. Dukej absurde. Në fakt, vetëm Perëndia mund ta bënte një gjë të tillë. Nëse Perëndia mundi ta krijonte botën, Ai mund t'i mblidhte kafshët që kishte krijuar Vet. Dhe ashtu bëri.

Një nga sprovat e vërteta në jetë është si e ndjek vullnetin e Perëndisë. A e ndjek atë edhe atëherë kur nuk duket logjik? Ne prindërit e kuptojmë këtë gjë, sepse sa herë që i thua fëmijës për të bërë diçka, ai do të dijë pse-në para. Por bindje është kur e bën atë që të kërkohet e pastaj kërkon arsyen. Se nuk ke nevojë për besim nëse di çdo gjë në fillim. Noeu ishte i gatshëm, guxoi të ishte ndryshe nga të tjerët, ai e ndoqi Perëndinë plotësisht. Prandaj Perëndia mundi ta përdorte atë.

4. Noeu nuk u dorëzua. Atij iu desh të priste gjatë, 120 vite që kur e mori porosinë nga Perëndia deri kur ra shiu. Nuk priti kot gjithë ato vjet, por punoi për të ndërtuar arkën. Ai është shembull i madh i durimit, këmbënguljes dhe fokusimit. Një pyetje: Nëse do që të të përdorë Perëndia, a do të ishte entuziast për një projekt të caktuar për një kohë kaq të gjatë, disa javë pareshtur, disa muaj apo disa vite? A mendon se mund të gjeje motivim të mjaftueshëm për të vazhduar?

Sepse do të këtë gjëra që do të nxisin të heqësh dorë. Problemet do të të tundojnë të heqësh dorë nga plani i Perëndisë për jetën tënde. E sigurt që pati probleme pafund ndërsa Noeu po ndërtonte Arkën. Presionet do të të tundojnë të heqësh dorë pa arritur në fund të synimit që ka Perëndia për ty. Me siguri që Noeu ka menduar: Kjo është shumë për mua. Kjo është përgjegjësi e madhe për mua. Gjithë pesha e botës mbi shpatullat e një burri. Shumë përgjegjësi, Perëndi! S'e përballoj dot. Do të shkatërrohem. Do të ngelem i vetëm! Presionet do të të tundojnë të heqësh dorë. Njerëzit do të të tundojnë të heqësh dorë. Do të të zhgënjëjnë. Do të të keqkuptojnë. Do të të kritikojnë. Do të të ulin poshtë, do të tallen. Çdo ditë, Noeu jepte një mesazh. Ai nuk dilte para njerëzve, por predikonte me jetën e tij, sepse ai është mesazhi më i bukur që mund të japë një njeri, jeta

e tij. Çdo ditë, ndërsa ngulte ato gozhdët mbi dërrasa dhe u jepte format që u duheshin atyre dhe i lyente me bitum, ai po i thoshte botës përreth: “Unë I Besoj Fjalës Që Ka Thënë Perëndia.” Kjo e bëri atë të qëndronte fort për 120 vjet. Sigurisht që historitë tona nuk janë histori të mëdha si e Noeut, por Perëndia do të të përdorë ty nëse ti je i gatshëm. A do të përdoresh nga Perëndia? Sepse kjo është gjëja që e mbush, e plotëson jetën tënde. Aty gjendet kënaqësia. Aty gjen fillin e arsyes pse je krijuar nga Perëndia. S’ke ku e gjen diku tjetër. Por, si do të duket; a ka hapa të vegjël dhe praktikë? Filloje ditën duke thënë: Zot, më përdor mua. Kur del nga shtëpia dhe je rrugës për në punë a shkollë thuaj: Zot, më përdor mua. Kur shkon te kafeja, te furra, te marketi, te berberi, te parukierja, tek të afërmit thuaj: Zot, më përdor mua. Kur kthehesh në shtëpi dhe hyn brenda thuaj: Zot, më përdor mua. Dhe do të habitesh sesi do të të përdorë Perëndia. Sepse Ai, në fakt, këtë po bën: po kërkon për njerëz të tillë. Sytë e Zotit vështrojnë mbarë tokën dhe Ai u jep fuqi atyre që i përkushtohen me gjithë zemër Atij...⁶ Nëse e lejon, Ai do të të përdorë ty.

Për T’u Menduar

- Cila duket më e lehta nga këto të katërta?
- Cila nga këto ishte më e vështira?
- A e ke dëshirën për t’u përdorur nga Perëndia; a ke pritje që Ai do të përdorë?
- A do të lutesh me lutjen më të guximshme që ekziston:
Zot, Ja Ku Jam, Më Përdor Mua!

Vazhdon tek faqja tjetër: Perëndia të thotë ty: Të Dua Shumë!

**“Erdha të të bëj të
njohur, sepse ty të
duan shumë...”**

– DANIELI 9:23

Mbyllja

Gëzohem pa masë që arrite deri këtu. Ke bërë një super udhëtim, në mos udhëtimin më të bukur të jetës. Dua të të kujtoj që nuk mbaron këtu; në fakt sapo ka filluar udhëtimi i vërtetë. Vazhdoje udhëtimin, ushqeje besimin tënd të ri, mbushu me qëllim, dashuri, dhe paç një lidhje të pandarë me Zotin Jezus, i cili të do shumë, të njeh shumë mirë dhe ka veç plane të mira për jetën tënde.

Perëndia i tha Danielit nëpërmjet engjëllit Gabriel tre herë Të Dua Shumë!

Erdha të ta bëj të njohur, sepse ty të duan shumë... Danieli 9:23

Daniel, njeri shumë i dashur... Danieli 10:11

O njeri që të duan shumë, mos ki frikë... Danieli 10:19

Nëse ti ke zgjedhur ta vendosësh besimin te Jezusi, Perëndia të thotë ty: Të Dua Shumë!

Ai na ka dhënë jetë në Krishtin Jezus, je i shpëtuar me anë të hirit dhe nëpërmjet besimit... Efesianëve 2:3,5,8

Këto të vërteta janë më të fuqishme sesa zëri i engjëllit Gabriel. Nëse ti ke zgjedhur jetën e re në Krishtin, ty të duan shumë, je njeri shumë i dashur në të gjithë qiellin!

Emri yt është shkruar në Librin e Jetës. Ai të njeh me emër; gjithë qielli të do shumë.

Jetoje jetën çdo ditë me këto të vërteta në mendje!

Indeksi i vargjeve biblike

Dita 1

1. Kolosianëve 1:16

Dita 2

1. Zanafilla 1:1
2. Zanafilla 1:1-25
3. Zanafilla 2:7
4. Zanafilla 2:21-24
5. Romakëve 1:20
6. Psalmet 8:5

Dita 3

1. Zanafilla 1:26-27
2. Psalmet 8:5
3. Mateu 10:19-20

Dita 4

1. Mateu 10:19-20
2. Jeremia 1:5; Psalmet 139:13-18
3. Eksodi 33:12, 17
4. Jeremia 17:9-10; 1 Gjonit 3:20;
1 Mbretërve 8:39;
Psalmet 66:18; Mateu 5:8
5. Psalmet 139:2; Jobi 42:2; 2
Korintasve 10:5
6. Mateu 6:25-34; 1 Pjetrit 5:7
7. Predikuesit 12:14; 2 Korintasve
5:9-10; Psalmet 139:4;
Mateu 12:35
8. Jobi 23:10; Psalmet 23:4;
Fjalët e Urta 16:9;
Psalmet 139:3

9. Psalmet 103:14;

- 2 Korintasve 12:9-10

10. Psalmet 90:12; Jakobi 4:14;

- Hebrenjve 9:27; Psalmet 31:15a

11. Luka 5:8-9

Dita 5

1. Gjoni 3:16
2. Gjoni 10:10
3. Romakëve 3:23
4. Romakëve 6:23
5. Romakëve 5:8
6. 1 Korintasve 15:3, 6
7. Gjoni 14:6
8. Gjoni 1:12
9. Efesianëve 2:8-9
10. Zbulesa 3:20
11. Luka 5:8-9

Dita 6

1. Luka 5:3-4
2. Luka 5:5-7
3. Luka 5:8-9
4. Eksodi 3:6
5. Luka 5:10b
6. Luka 5:11
7. Gjoni 3:16

Dita 7

1. 2 Timoteut 3:16-17
2. 1 Thesalonikasve 2:13
3. Mateu 4:4

4. Mateu 7:24
5. Psalmet 119:9-11

Dita 8

1. Gjoni 15:5-7
2. Gjoni 15:15-16
3. Filipianëve 4:6
4. Filipianëve 4:7
5. Gjoni 16:23-24
6. Jakobi 4:2
7. Psalmi 145:19
8. Mateu 7:9-11
9. Gjoni 14:12
10. Gjoni 14:13-14
11. Psalmet 37:4

Dita 9

1. Marku 1:35
2. Mateu 4:4
3. Psalmi 29:2
4. Zbulesa 4:11 5. Gjoni 4:23
6. Psalmet 25:4
7. Psalmet 37:4
8. Psalmet 16:11
9. Veprat 4:13
10. Luka 22:39
11. Galatasve 6:9

Dita 10

1. Gjoni 14:16
2. Gjoni 14:26
3. Gjoni 16:8
4. Veprat 1:8
5. Romakëve 5:5

6. Galatasve 5:22
7. Gjoni 16:14 8. Veprat 5:3,4

Dita 11

1. Efesianëve 1:5
2. 1 Pjetrit 2:17b
3. 1 Gjoni 4:21
4. 1 Timoteut 3:14-15
5. Efesianëve 2:19
6. Romakëve 12:5
7. Veprat 2:44
8. Fjalët e Urta 27:17
9. 1 Pjetrit 4:9
10. Galatasve 6:2
11. Romakëve 12:15
- 12.1 Korintasve 3:9
13. Efesianëve 4:6
14. Mateu 25:40
15. Romakëve 12:10
- 16.1 Gjoni 3:16
17. Gjoni 13:35
18. Mateu 22:37-38

Dita 12

1. Zbulesa 4:11b
2. Mateu 22:37-38 3. Marku 12:30
4. Psalmet 139:1-3
5. Isaia 26:3
6. 1 Gjoni 4:19
7. Kolosianëve 3:23
8. 2 Korintasve 5:9

Dita 13

1. 1 Mbretërve 10:1

2. Mateu 23:15
3. Romakëve 12:15
4. Romakëve 12:9
5. Efesianëve 4:25

Dita 14

1. 1 Mbretërve 10:2-3
2. Romakëve 15:19

Dita 15

1. 1 Mbretërve 10:4-5
2. Zanafilla 1:25
3. Zanafilla 1:31
4. Luka 15:24

Dita 16

1. 1 Mbretërve 10:4-5
2. Luka 15:24
3. Gjoni 13:35

Dita 17

1. 1 Mbretërve 18:8
2. Filipianëve 2:10-11
3. 1 Thesalonikasve 5:18
4. Romakëve 8:28
5. Psalmet 37:4

Dita 18

1. 1 Mbretërve 10:13
2. Psalmet 37:4
3. Zanafilla 12:2
4. Luka 18:29-30
5. Luka 6:38
6. Efesianëve 5:15-16

Dita 19

1. Gjoni 17:18
2. Veprat 1:8
3. Luka 8:39
4. 1 Korintasve 9:22
5. Jakobi 1:27
6. Mateu 25:35-36
7. Mateu 25:40
8. Marku 16:15
9. Psalmet 67:2
10. Gjoni 1:41-42a

Dita 20

1. Gjoni 1:41-42a
2. Luka 15:6, 9, 23b-24
3. Gjoni 1:12
4. Zanafilla 39:3, 23b

Dita 21

1. Zanafilla 39:3, 23b
2. Eksodi 20:8
3. Mateu 25:40
4. 1 Korintasve 2:9

Dita 22

1. Fjalët e Urta 4:23
2. Romakëve 7:22-23
3. Mateu 4:4
4. Psalmet 119:147
5. Psalmet 119:97
6. 2 Korintasve 2:11
7. 1 Gjoni 2:16
8. 2 Korintasve 10:3-5
9. Hebrenjve 12:3

- 10.Filipianëve 2:4
- 11.Kolosianëve 3:2
- 12.1 Korintasve 2:9
- 13.Mateu 25:11

Dita 23

- 1. Efesianëve 2:10
- 2. 1 Pjetrit 4:10
- 3. Mateu 20:28
- 4. Mateu 20:30-32
- 5. Fjalët e Urta 3:28
- 6. Gjoni 11:41-42
- 7. Psalmi 100:2
- 8. 2 Timoteut 1:9
- 9. Gjoni 17:4
- 10.1 Korintasve 4:2
- 11.1 Korintasve 15:58
- 12.Mateu 25:11
- 13.Psalmet 23:3

Dita 24

- 1. Jakobit 1:2-4
- 2. Romakëve 8:28
- 3. Gjoni 16:33
- 4. Psalmet 23:3
- 5. Psalmet 34:18

Bonus, Dita 25

- 1. Zanafilla 6:5-9
- 2. Zanafilla 6:9
- 3. Fjalët e Urta 29:25
- 4. Zanafilla 6:9
- 5. Zanafilla 6:22
- 6. 2 Kronikave 16:9



Altin Kita është themeluesi i kishës ungjillore ICF Tirana. Ai gjithashtu bashkë—drejton Rrjetin e Kishëmbjelljes 20/20 dhe Precept Ministries Albania. Shkruan rregullisht në web-in e tij për krijeshmërinë, lidërshtipin, shërbesën dhe grimca shprese.

Ai dhe bashkëshortja e tij Oreada kanë dy djem, Martin dhe Rubin, dhe ndajnë të njëjtin pasion për ta treguar dashurinë e Perëndisë në mënyra sa më praktike.

Ka shumë pasion të ndihmojë dhe të përfshijë të rinjtë në nisma të reja, shërbesa, kishëmbjellje dhe projekte. Këshillon dhe udhëzon rregullisht lidera të rinj në fusha të ndryshme.

Ndihi i lirë për t'i shkruar atij në lidhje me pyetje të ndryshme për besimin, ide dhe mendime. Mund ta kontaktosh përmes emailit, mediave sociale ose web-it.

Email: altinkita@gmail.com

Facebook: <https://www.facebook.com/akita1/>

Instagram: <https://www.instagram.com/altinkita/>

Web: <https://altinkita.com>

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Kita, Altin

Ai të njeh! : udhëtim për të gjetur versionin origjinal që Perëndia ka për ty / Altin Kita ; red. Albert Hysa, Anxhela Nikolli.

- Tiranë : Vision Printing, 2023.

238 f. : 13,5 x 19,5 cm

ISBN 978-9928-374-44-8

1. Feja kristiane 2.Kisha Protestante 3.Besimi
278-184.3